Kompania Rajonale e Mbeturinave
Regionalna Kompanija za Uklanjanje Otpada
"PASTRIMI" SH.A. / d.d.
Nr. 02/01/14 Shtojcë
Dt. 09-01-2025 2

REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më:
Primljeno: 10.01.2025

Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-352/01-1791		

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KOMPANIA REGJIONALE PASTRIMI

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Më datë:____.01.2025

E lidhur në mes:

Komunës së Lipjanit më tej 'Komuna', me adresë në Rrugën " Shqipëria", nr. 28 në Lipjan, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës – z.Imri Ahmeti

dhe

Kompanisë Rajonale për Mbeturina "Pastrimi" SH.A , më tej "Kompania" me adresë në rrugën "Tahir Zajmi" Nr.5 në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Kryeshefi Ekzekutiv, z.Petrit Reçica

Neni 1
Qëllimi i Marrëveshjes

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi në mes Komunës së Lipjanit dhe Kompanisë Rajonale "Pastrimi" SH.A, është ofrimi i ndihmës për participim –subvencionim në pagesën e 6 (gjashtë) punëtorëve sezonal të Kompanisë për periudhën prej 3 muajve.
2. (Prej datës 10.01.2025 deri me 10.04.2025) për kryerjen e punëve në menaxhimin e mbeturinave, si në vijim:

   2.1.Largimin e deponive ilegale;
   2.2.Largimin e mbeturinave voluminoze;
   2.3.Pastrimin e sipërfaqeve publike;
   2.4.Punët tjera,varësishtë nga nevoja në terren,për të ndihmuar Njësinë e Kompanisë në Lipjan në grumbullimin e mbeturinave.

Neni 2
Vlera e financimit

1. Vlera e përgjithshme për pagesën e punëtorëve sezonal,sipas nenit 1 të kësaj marrëveshje është në shumë prej 8.100.00 €.

2. Në pagesën –subvencionimin e punëtorëve sezonal, Komuna e Lipjanit do të participoj – subvencionoj me mjete financiare në shumë prej 4.050.00 €.
3. Në pagesën e punëtorëve sezonal, Kompania Rajonale e Mbeturinave 'Pastrimi' SH.A, do të participoj me mjete financiare në shumë prej 4.050.00 €
4. Paga mujore për 6 punëtorët sezonal sipas kësaj marrëveshje caktohet në shumë prej 450 € në muaj për secilin punëtor për periudhën 3 mujore ashtu që 50% e pagës paguhet nga Kompania dhe 50% subvencionohet nga Komuna.

Neni 3
Obligimet e Komunës

1. Komuna e Lipjanit obligohet që për pagesën e punëtorëve sezonal ,sipas kësaj marrëveshje të siguroj mjete financiare në shumë prej 4.050.00 €.nga buxheti i Komunës.
2. Të caktoj një përfaqësues nga Komuna e Lipjanit në cilësinë e mbikëqyrësit të realizimit të punëve në terren sipas kësaj marrëveshjeje.
3. Komuna e Lipjanit mjetet financiare në shumë prej 4.050.00 €, do t'i transferoj në llogaritë bankare të secilit punëtor sezonal në baza mujore.

Neni 4
Obligimet e Kompanisë

1. Kompania Rajonale e Mbeturinave 'Pastrimi' SH.A , obligohet që për pagesën e 6 punëtorëve sezonal të siguroj mjete financiare në shumë prej 4.050.00 €.për ngritjen e kualitetit të grumbullimit të mbeturinave për interesin e përgjithshëm të qytetarëve.
2. Kompania Rajonale e Mbeturinave 'Pastrimi' SH.A – Njësia në Lipjan, në bashkëpunim me Komunën e Lipjanit monitoron mbarëvajtjen e menaxhimit të mbeturinave dhe punëve tjera mjedisore në funksion të pastrimit të hapësirave publike në terren.
3. Kompania Rajonale e Mbeturinave 'Pastrimi' SH.A, duhet t'i dorëzoj raport me shkrim Komunës së Lipjanit për realizimin e punëve në terren si dhe për shpenzimin e mjeteve të destinuara sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5
Zbatimi

Kjo Marrëveshje është e zbatushme dhe e vlefshme deri në përmbushjen e obligimeve nga të dyja palët.

Neni 6
Mosmarrëveshjet

Mosmarrëveshjet e krijuara nga Marrëveshja e Bashkëpunimit duhet të zgjidhen përmes bisedimeve midis palëve. Nëse dështojnë bisedimet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve palët do t'i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Neni 7
Numri i kopjeve

Marrëveshja e Bashkëpunimit është përpiluar në kopje identike dhe të mjaftueshme për secilen palë.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Marrëveshja e Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga të dy palët nënshkruese.

Nënshkruar më datë: _____01.2025

KRM "Pastrimi" SH.A

Petrit Reçica

Kryetari i Komunës

Imri Ahmeti

DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 454-705/46
Data Datum Date 22.01.2025

KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN
Pranuar me: Primljeno: 22.01.2025
Njësia Jednica | Numri Broj | Shtojca Dodatak
01-454/01-4062

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

HELVETAS KOSOVO

Prishtinë, 2024

Në mbështetje të nenit 8, 9, 10, 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 8 paragrafi 1.4, të Rregullores (QRK) - Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 08/l-103 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë, si dhe Ligjin Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, si dhe duke u bazuar në Raportin vlerësues për Grantin e Performancës Komunale për vitin 2023, periudha e alokimit 2025, të aprovuar nga Komisioni i Grantit për Performancë Komunale, me dt. 31.12.2024, arrihet kjo:

MARRËVESHJE PËR NDARJEN E GRANTIT PËR PERFORMANCË KOMUNALE PËR VITIN 2025

Ndërmjet:

1. Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësuar nga z.Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së (në tekstin e mëtejmë MAPL),

2. Helvetas Swiss Intercooperation, përfaqësuar nga z. Ertan Munoglu, Menaxheri i Projektit DEMOS (në tekstin e mëtejmë DEMOS) dhe,

3. Komunës së Lipjanit, përfaqësuar nga z. Imri Ahmeti, Kryetari i Komunës (në tekstin e mëtejmë Komuna).

Neni 1

Qëllimi

MAPL dhe HELVETAS pajtohen për ndarjen e mjeteve nga skema e grantit për performancë komunale për vitin 2025.

Neni 2

Financimi

1. Vlera e ndarë e grantit për vitin 2025 për komunën Lipjan është 1,041,380.61 Euro.

2. Shuma nga pika 1, e këtij neni financohet nga fondet e MAPL-së dhe HELVETAS, proporcionalisht me kontributin e tyre në GPK.

3. Pagesat lidhur me fondet e MAPL-së, bëhen nga MAPL, tek operatorët ekonomik, bazuar në realizimin e punimeve sipas kontratës për implementim të projekteve.

4. Mjetet e HELVETAS, transferohen në buxhetin e komunës përmes Thesarit/MFPT-ës, pas nënshkrimit të marrëveshjeve individuale.

Neni 3

Shfrytëzimi i grantit

Palët nënshkruese të kësaj marrëveshje, do të nënshkruajnë marrëveshje të veçantë tre palëshe për financim të projekteve në komunë, përmes së cilës do të përcaktohen obligimet, detyrat dhe përgjegjësitë për secilën palë.

Neni 4

Hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga MAPL, DEMOS dhe Komuna.

Palët Nënshkruese

për

Elbert Krasniqi	Ertan Munoglu	Imri Ahmeti
Ministër i MAPL-së	Menaxheri i projektit DEMOS	Kryetar, Komuna e Lipjanit

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: Primljeno:	19.02.2025	
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-016/01-7947		

HELVETAS

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

Projektit për Decentralizim dhe Mbështetje Komunave (DEMOS), i zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation i përfaqësuar nga Menaxheri i projektit (në vijim të referuar si "Projekti DEMOS"),

dhe

Komunës së Lipjanit, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës (në vijim të referuar si "Komuna"),

Qëllimi dhe fushëveprimi

Ky Memorandum Bashkëpunimi (Memorandum) ndërmjet Projektit DEMOS dhe Komunës së Lipjanit është lidhur me qëllim të bashkëpunimit për përmirësim të qeverisjes pjesëmarrëse dhe të sigurimit të angazhimit kuptimplotë të qytetarëve në procesin e planifikimit të hershëm buxhetor komunal.

Fusha e veprimit të këtij Memorandumi përfshin sigurimin e mbështetjes teknike dhe fuqizimin e kapaciteteve nga Projekti DEMOS për të mbështetur Komunën në arritjen e këtyre objektivave, së bashku me angazhimet e Komunës për të zbatuar masat specifike të përshkruara në këtë Memorandum.

Rolet dhe përgjegjësitë

Përgjegjësitë e Projektit DEMOS

- Mbështetja e Komunës në analizimin dhe paraqitjen transparente të buxheteve të disponueshme për konsultim me qytetarët,
- Lehtësimi i përgatitjes së materialeve dhe prezantimeve për dëgjimet buxhetore rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) dhe atyre për planifikim buxhetor vjetor.
- Ofrimi i trajnimeve dhe fuqizimi i kapaciteteve të përshtatura për anëtarët e grupit punues përgjegjës për organizimin e dëgjimeve buxhetore, me theks në:
    - Përcaktimin e qartë të roleve dhe përgjegjësive të tyre,
    - Evidentimin dhe raportimin adekuat të të gjithë procesit të konsultimit publik me qytetarët,
    - Vlerësimin, prioritizimin dhe kategorizimin e kërkesave të qytetarëve,

- Sigurimin e përputhshmërisë së planifikimit buxhetor me prioritetet komunale, kufizimet buxhetore dhe përputhjen me Udhëzimin Administrativ (UA) për Administratë të Hapur[1].

- Mbështetja e Komunës në përdorimin e platformës së konsultimeve publike si mjet për plasimin transparent të informacionit buxhetor dhe marrjes së kontributit të qyteterëve, dhe
- Mbështetja e Komunës në shfrytëzimin e bazave të të dhënave të grupeve të interesit për të rritur pjesëmarrjen qytetare në dëgjime buxhetore, me theks të veçantë në përfshirjen e grave, personave me aftësi të kufizuara, rinisë, banorëve nga viset rurale, dhe komuniteteve jo-shumicë.

Përgjegjësitë e Komunës

- Planifikimi i hershëm buxhetor duke aplikuar Udhëzuesin[2] e zhvilluar nga Projekti DEMOS,
- Të përmbajturit me komponentë të tjerë të Udhëzuesit që synojnë përmirësimin e planifikimit, përfshirjes dhe përgjegjshmërisë së përgjithshme të dëgjimeve buxhetore,
- Nxjerrja dhe miratimi i vendimit për themelimin e grupit punues përgjegjës për dëgjime buxhetore,
- Përcaktimi i qartë i roleve dhe përgjegjësive të secilit anëtar të grupit punues, duke përfshirë drejtoritë apo njësitë që përfaqësojnë dhe funksionet që ushtrojnë,
- Sigurimi i zbatimit të dispozitave të UA-së për Administratë të hapur, veçanërisht lidhur me kompetencat vendimmarrëse të anëtarëve të grupit të punës gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore, si dhe evidentimit, shqyrtimit dhe përgjigjes ndaj kërkesave të qytetarëve që pranohen gjatë dëgjimeve buxhetore dhe procese të tjera konsultative, dhe
- Caktimi i një pike kontakti në kuadër të komunës për të trajtuar të gjitha çështjet që lidhen me këtë Memorandum, duke përfshirë raportimin dhe komunikimin me Projektin DEMOS dhe kërkesat që mund të dalin nga ky bashkëpunim.

[1] Udhëzim Administrativ (MAPL) NR. 04/2023 për administratë të hapura në Komuna
[2] Udhëzues për Planifikimin, Organizimin, Fasilitimin dhe Veprimet Përcjellëse të Dëgjimeve Buxhetore në Komuna, Maj 2024, Projekti DEMOS, Helvetas

HELVETAS

Përgjegjësitë e përbashkëta

Të dyja palët bien dakord që të:

- Respektojnë parimet e transparencës, përgjegjshmërisë dhe përfshirjes në zbatimin e të gjitha aktiviteteve sipas këtij Memorandumi,
- Veprojnë me mirëbesim për të arritur qëllimet e këtij Memorandumi, dhe
- Rishikojnë në baza të rregullta progresin e arritur dhe adresojnë çdo sfidë që mund të paraqitet gjatë zbatimit.

Kohëzgjatja

Ky Memorandum Bashkëpunimi është i vlefshëm nga data e nënshkrimit deri më 31.12.2025, përveç nëse përfundohet më herët me marrëveshje të përbashkët. Secila palë mund ta përfundojë këtë Memorandum me një njoftim paraprak me shkrim në një afat prej 30 ditësh.

Nënshkrimet

Duke nënshkruar më poshtë, palët pranojnë kuptimin dhe pajtimin e tyre me kushtet e këtij Memorandumi.

Për Projektin DEMOS

Ertan Mynoglu

Drilon Shala

Data
18.02.2025

Për Komunën

Kryetar i Komunës

Data

Co-funded by the European Union

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Sweden
Sverige

Telekomi i Kosovës SH. A.
Kosovo Telecom J. S. C.
Telekom Kosova D. D.
Nr./No./br. 01-1411/25
Data/Date/Datum 07-03-25
PRISHTINË,PRISTINA,PRIŠTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Primljeno: 10.03 2025		
Njësia Jedinica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-344/01-10845		

REPUBLIKA E KOSOVËS

TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.

KOMUNA E LIPJANIT

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.

DHE

KOMUNA E LIPJANIT

Preambula

Telekomi i Kosovës dhe Komuna e Lipjanit në vijim quhen *"Palë"*.

Telekomi i Kosovës ka filluar projektin e madh të shtirjes se rrjetave telekomunikuese optike për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese fikse brezgjerë (Internet, TV, telefon fiks) në tërë vendin, për secilën familje dhe biznes.

Ky projekt ka rëndësi kombëtare, sepse ofron shërbime të sigurta të internetit brezgjerë përmes fijeve optike, për secilën familje dhe biznes.

Qasja në internet përmes teknologjisë optike ka rëndësi vitale për të ardhmen dhe rritjen ekonomike të vendit.

Telekomi i Kosovës është pronë e popullit të Kosovës.

Rrjetat optike ndikojnë në zvogëlimin e kostove të gjithmbarshme mujore për shërbimet e internetit, si për qytetarët e Komunës së Lipjanit, po ashtu edhe për Telekomin e Kosovës në mirëmbajtjen e rrjetit.

Palët angazhohen të sigurojnë standarde të larta në shërbimet e internetit brezgjerë dhe t'i plotësojnë nevojat e qytetarëve për këto shërbime.

Roli i komunës për të garantuar suksesin e projektit është vendimtar.

Duke u mbështetur në rregulloret e Palëve dhe ligjet në fuqi,

Palët kanë rënë dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi, në vijim i quajtur "Memorandumi".

Neni 1
Qëllimi

1. Marrja e pëlqimit dhe lejes për lejimin e punimeve në hapësirat publike në tërë territorin e komunës së Lipjanit, për Telekomin e Kosovës.
2. Mirëkuptimi dhe bashkëpunimi i plotë dhe i ndërsjellë, me qëllimin e vetëm që projekti i shtrirjes së rrjetave optike në komunën e Lipjanit të ekzekutohet dhe të përfundojë me sukses të plotë.

Neni 2
Roli dhe përgjegjësitë e Palëve

1. Bashkëpunimi sipas këtij Memorandumi realizohet si vijon:
    a. Telekomi i Kosovës Sh.A:
        i. Propozon listën e aktiviteteve që do të përfshihen në modernizimin dhe zhvillimin e rrjetave optike;
        ii. Harton listën e rrugëve ku duhet të zhvillohet infrastruktura kabllore optike, duke përfshirë shtrirjen e gypave nëntokësorë dhe ndërtimin e pusetave;

95

iii. Cakton një person kontakti në cilësinë e koordinatorit, i cili do të përgatisë njoftimin dhe raportimin e aktiviteteve që do të ndërmerren në kuadër të modernizimit dhe zhvillimit të rrjetave optike në secilën rruge apo lagje;
iv. Sigurohet që punët ndërtimore të kryhen sipas standardeve;
v. Rikthen infrastrukturën e komunës në gjendjen e mëparshme, pas çdo ndërhyrjeje të mundshme në të.

b. Komuna e Lipjanit:
i. Shqyrton listën e rrugëve ku duhet të zhvillohet infrastruktura kabllore nëntokësore;
ii. Lëshon një pëlqim parimor për tërë projektin, për zhvillimin e punimeve për lokacionet e caktuara ku është e nevojshme ndërhyrja në infrastrukturën e komunës (p.sh. gropimi për shtrirjen e gypit, ndërtimi i pusetave, etj);
iii. Cakton një person kontakti, i cili do të bashkëpunojë me personin kontaktues të Telekomit të Kosovës.

2. Palët marrin përsipër të kryejnë bashkërisht:
a. Caktimin e modelit për certifikimin e punëve ndërtimore.

Neni 3
Forma e bashkëpunimit

1. Për të siguruar efikasitet në kohë, njoftimet mes Palëve dhe çdo komunikim tjetër do të realizohen nëpërmjet postës elektronike.
2. Telekomi i Kosovës njofton, nëpërmjet koordinatorit të caktuar, personin përgjegjës të Komunës së Lipjanit, lidhur me fillimin e aktivitetit për zhvillimin e punëve ndërtimore në rrugë apo lagje, jo më vonë se 10 ditë nga data e fillimit të aktiviteteve.
3. Personi përgjegjës i Komunës së Lipjanit, mban kontakte të rregullta lidhur me:
a. Listën e punëve ndërtimore që duhet të kryhen;
b. Afatin kohor të kryerjes së punëve ndërtimore;
c. Çdo aktivitet që lidhet me ekzekutimin e punëve ndërtimore.
4. Koordinatori i Telekomit të Kosovës i dërgon personit përgjegjës të Komunës së Lipjanit skicën (vizatimet) e trasesë ku do të ekzekutohen punët ndërtimore, jo më vonë se 5 ditë nga data e fillimit të aktivitetit.

Neni 4
Vlerësimi i zbatimit të Memorandumit

1. Palët marrin përsipër të vlerësojnë bashkërisht zbatimin e Memorandumit, nëpërmjet hartimit dhe paraqitjes së një raporti periodik me shkrim, në përfundim të çdo viti kalendarik.
2. Raporti përmban, krahas të dhënave për ecurinë e zhvillimeve të aktiviteteve të kryerjes së punëve ndërtimore gjatë një viti kalendarik, edhe rekomandimet konkrete për adresimin e problematikave të evidentuara.

Neni 5
Komunikimi ndërmjet palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të bëhet në

YS

formë elektronike. Në çdo rast të paraqitjes se një kërkese, palët angazhohen të japin përgjigje brenda 5 ditëve.

2. Palët angazhohen të jenë të disponueshëm në çdo kohë për komunikim dhe koordinim me njëri-tjetrin, me qëllim të dakordimit të veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti.

Neni 6
Ndryshimi i Memorandumit

1. Secila palë mund të propozojë plotësimin dhe ndryshimin e këtij Memorandumi.
2. Çdo plotësim dhe ndryshim i këtij Memorandumi do të bëhet me shkrim dhe me pëlqimin paraprak të palëve nënshkruese të marrëveshjes.

Neni 7
Kohëzgjatja e Memorandumit

Ky Memorandum është i vlefshëm për periudhën 1 janar 2025 – 31 dhjetor 2027.

Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve.

Neni 9
Hyrja në Fuqi

Memorandumi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga palët.

Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në dy (2) ekzemplarë, një për Telekomin e Kosovës dhe një për Komunën e Lipjanit.

Nënshkruar në Lipjan, 07 / 03 / 2025

Telekomi i Kosovës Sh.A.

Burbuqe Hana
Kryeshefe Ekzekutive

Komuna e Lipjanit

Imri Ahmeti
Kryetar i Komunës së Lipjanit

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: Primljeno: 14.03 2025		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-016/01-11664		

KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE D.D.
PRISHTINA
PRISHTINË
Nr. 1084 Dt. 14-03-2025

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur në Lipjan me datë 13.03 2025, ndërmjet :

Komunës së Lipjanit , përfaqësuar nga z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit (në vazhdim të tekstit: Komuna) dhe

Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" Sh.A., rr."Hazir Shala" nr.4, përfaqësuar nga Kryeshefi Ekzekutiv z. Arsim Fetahu (në vazhdim të tekstit: Kompania)

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së kësaj Marrëveshje të Mirëkuptimit është bashkëfinancimi i përbashkët për realizimin e punimeve për zbatimin e Projektit "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Babush i Muhaxherëve"i cili projekt do të zhvillohet në dy lokacione të Komunës, përkatësisht në fshatin Babush i Muhaxherëve dhe Gllavicë.

Neni 2
Vlera e përbashkët e bashkëfinancimit të projektit

Vlera e përbashkët e bashkëfinancimit për realizimin e projektit është gjithsej 83.000,00 € (tetëdhjetë e tre mijë euro).

Neni 3
Obligimet e Komunës

1. Komuna me anë të kësaj Marrëveshje obligohet të participojë-bashkëfinancojë me 33,000,00 € (tridhjetë e tre mijë euro).
2.Komuna e jep pëlqim paraprak për fillimin e punimeve në rrugë komunale.

Neni 4
Obligimet e Kompanisë

Me anë të kësaj Marrëveshje, Kompania merr obligim që të bashkëfinancojë punimet e kryera në kuadër të projektit "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Babush i Muhaxherëve" në vlerë prej 50,000,00 € (pesëdhjetë mijë euro).

Neni 5
Zhvillimi i procedurave të prokurimit

Procedurat e prokurimit do të zhvillohen dhe do të udhëhiqen nga Kompania në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Neni 6
Mënyra e ekzekutimit të pagesave

1. Mënyra e ekzekutimit të pagesës nga ana e palëve nënshkruese të kësaj Marrëveshje do të bëhet në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.
2. Ekzekutimi i pagesave fillimisht do të realizohet nga shuma e mjeteve të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" të precizuar në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje.
3. Komuna do të bëjë ekzekutimin e pagesës për punët e kryera konform faturave të pranuara nga Menaxheri i Kontratës.

Neni 7
Mbikëqyrja e punimeve

Mbikëqyrja e kontratës do të kryhet nga të dy palët e këtij Marrëveshje, ku secila palë do të caktojë nga një person për mbikëqyrje të punimeve .

Neni 8
Ndryshimi dhe Përfundimi

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi mund te ndryshohet vetëm me shkrim nga të dy palët.
2. Në rast të çfarëdo paqartësie (kontesti) të kësaj Marrëveshjeje të Bashkëpunimit, secila palë obligohet të njoftoj palën tjetër me shkrim 30 (tridhjetë) ditë përpara.

Neni 9
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do të përpiqen të zgjidhin në mënyrën me të përshtatshme çdo mosmarrëveshje që buron nga kjo Marrëveshje Bashkëpunimi. Nëse mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim, atëherë pala mundë të adresojë çështjen në gjykatën kompetente.

Neni 10
Hyrja në fuqi

1. Marrëveshja hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët .
2. Kjo Marrëveshje është hartuar në dy (2) kopje identike origjinale dhe secila nga palët marrin nga një (1) kopje.

z. Imri Ahmeti
Kryetar i Komunës së Lipjanit

z. Arsim Fetahu
Kryeshef Ekzekutiv i i KRU "Prishtina"sh.a

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN
Pranuar me: 26.03 2025
Primljeno:
Njësia Jednica | Numri Broj | Shtojca Dodatak
01-300/01-13360

WOMEN FOR WOMEN
KOSOVA

Memorandum Mirëkuptimi

në mes

Kosova – Women 4 Women

dhe

Komuna e Lipjanit

Ky Memorandum Mirëkuptimi (në tekstin e mëtejmë i referuar si 'Memorandumi') ka për synim krijimin e partneritetit mes Kosova -Women 4 Women (në vazhdim i referuar si 'KW4W') dhe Komunës së Lipjanit (ne vazhdim i referuar si 'Komuna').

Ky dokument nuk paraqet marrëveshje që i lidh palët ligjërisht në implementim të aktiviteteteve të ndryshme për synime të përbashkëta, mirëpo i elaboron kushtet në bazë të të cilave do të funksionojë ky bashkëpunim si dhe rolet dhe përgjegjësitë e secilës palë.

I. Objektivat e bashkëpunimit

Qëllimi i Memorandumit është që të ofrojë kornizën e bashkëpunimit dhe koordinimit në mes palëve me qëllim të fuqizimit ekonomik dhe social të grave të kësaj komune dhe rritjes së pjesëmarrjes së grave në procese të ndryshme vendimmarrëse dhe afariste.

II. Rolet dhe përgjegjësitë

Duke e nënshkruar këtë memorandum, palët pajtohen t'i përmbushin rolet dhe përgjegjësitë në vazhdim:

a. KW4W do të ketë përgjegjësi:

- Të bëjë mobilizimin e grave dhe burrave për pjesëmarrje në aktivitete dhe programe,
- Te bëjë organizimin e trajnimeve,
- T'i koordinoj aktivitetet me zyrtarë/et komunalë

b. Komuna do të ketë përgjegjësi:

- Të emëroj një zyrtar/e si person kontaktues për koordinim të aktiviteteve,
- Të bashkëpunojë në mobilizimin e grave për pjesëmarrje në aktivitete dhe programe,
- Aty ku është e mundur të ofroj hapësira për nevoja të aktiviteteve dhe projekteve
- Komuna e Lipjanit nuk ka asnjë obligim financiar në këtë memorandum,
- Në varësi të mundësive buxhetore dhe me aneks marrëveshjeje, do të bashkëfinancoj projektet specifike përkrahëse të K-W4W për përfitueset e Komunës së Lipjanit.

III. Konfidencialiteti

Të dyja palët pajtohen që të dhënat dhe informatat që merren/grumbullohen përgjatë këtij bashkëpunimi do të trajtohen me konfidencialitet dhe sipas ligjeve të Kosovës. Edhe pas përfundimit të projektit informatat personale të rasteve mund të përdoren vetëm me miratimin me shkrim të tyre.

IV. Kohëzgjatja e Memorandumit të Mirëkuptimit

Ky memorandum hyn në fuqi me datën e nënshkrimit dhe do te mbes ne fuqi deri me 31 dhjetor 2029.

Në rast se ndonjëra palë dëshiron ta ndërpresë marrëveshjen, duhet të bëhet njoftim me shkrim një (1) muaj përpara se marrëveshja të konsiderohet e ndërprerë.

Palët munden, me marrëveshje të dyanshme me shkrim, të ndryshojnë apo plotësojnë këtë marrëveshje.

V. Autorizimi

Duke e nënshkruar këtë memorandum, të dyja palët pajtohen që t'i përmbushin termet e saj në mirëbesim. Edhe pse kjo marrëveshje nuk është obligative ligjërisht për ta implementuar, ajo është dëshmi e përkushtimit për t'i zbatuar rolet dhe përgjegjësitë e paracaktuara në këtë marrëveshje.

Kosova - Women 4 Women

Emri: Iliriana Gashi

Titulli: Drejtore

Adresa: Arbëria III, Rruga Kosturi, nr. 69

10000 Prishtina

Data: 26.3.2025

Komuna e Lipjanit

Emri: Imri Ahmeti

Titulli: Kryetar i Komunës

Adresa: rr.Shqiperia nr.28

14000 Lipjan

Data: 26/03/2025

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN
Pranuar me: 26.03.2025
Primljeno:
Njësia Jedinica | Numri Broj | Shtojca Dodatak
01-300/01-13366

WOMEN FOR WOMEN
KOSOVA

Aneks i Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të Kosova - Women 4 Women dhe Komunës së Lipjanit

Komuna e Lipjanit dhe OJQ Kosova Women 4 Women pajtohen që të bashkëfinancojnë trajnimin e grave në Hortikulturë, i cili zhvillohet në kuadër të projektit "Mundësitë e përmirësuara të vetëpunësimit dhe punësimit," i cili financohet nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA). Projekti ka për qëllim përmirësimin e pozitës së gruas në ekonomi dhe në tregun e punës, me fokus tek gratë e margjinalizuara dhe pjesërisht burrat.

II. Rolet dhe Përgjegjësitë

- Palët pajtohen të bashkëpunojnë në formimin e grupit dhe trajnimin e deri 20 grave të Komunës së Lipjanit në Hortikulturë. Në fund të trajnimit, gratë do të përfitojnë një grant prej 450.00 euro në formë të mjeteve të punës.
- Granti do të bashkëfinancohet nga K-W4W dhe Komuna e Lipjanit varësisht nga shprehja e interesit në total shuma e këtij projekti është deri në 9000 euro, bashkëfinancimi do të bëhet në proporcion 240.00 euro nga K-W4W gjithsejt deri në 4800 euro, ndërsa 210.00 euro nga Komuna e Lipjanit gjithsejt deri në 4200 euro,
- Komuna e Lipjanit do të sigurojë vendin e mbajtjes së trajnimit, ndërsa K-W4W do të sigurojë trajnerin dhe do të mbulojë të gjitha shpenzimet tjera të trajnimit (trajnerin, shpenzimet e udhëtimit për pjesëmarrësët, pijet, etj.).
- Trajnimi do të organizohet gjatë muajve prill dhe maj 2025.
- Shpallja do të publikohet në rrjetet e publikimit të Komunës, si dhe të K-W4W.
- Përzgjedhja e grave pjesëmarrëse do të bëhet nga ana e K-W4W në bazë të kritereve të projektit.
- Komuna e Lipjanit vlerën prej 4200 euro do të transferojë në xhirollogarinë e K-W4W, ndërsa blerjet do të bëhen nga ana e K-W4W.
- Komuna e Lipjanit do të caktojë një person monitorues të të gjithë procesit.

Kosova - Women 4 Women

Emri: Iliriana Gashi

Titulli: Drejtore

Adresa: Arbëria III, Rruga Kosturi, nr. 69

10000 Prishtina

Data: 26.3.2025

Komuna e Lipjanit

Emri: Imri Ahmeti

Titulli: Kryetar i Komunës

Adresa: rr.Shqiperia nr.28

14000 Lipjan

Data: 26/03/2025

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA - PLAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Primljeno:	28. 04	20 25
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-16/1-	21402	

Komuna e Lipjanit

Islamic Relief Kosova

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide – Zyra në Kosovë (IRW)

Memorandum of Understanding (MoU) between the Municipality of Lipjan and Islamic Relief Worldwide - Office in Kosovo (IRW)

E lidhur me datë ___ /___/2025, ndërmjet Komunës së Lipjanit me adresë Rr. "Shqiperia" nr.28 14000, Lipjan, Kosovë, përfaqësuar nga kryetari i saj, z. Imri Ahmeti,

dhe

Organizatës bamirëse Islamic Relief Kosova me adresë Bajram Kelmendi, nr 10/a, përfaqësuar nga drejtori i saj, z. Mohamed Soliman.

Neni 1 – Qëllimi i marrëveshjes

1.1 Kjo marrëveshje lidhet me qëllim të bashkëpunimit mes Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide – Zyra në Kosovë, lidhur me zbatimin e projektit "Projekt i integruar për mbështetje në Shëndetësi, Arsim dhe Ekonomi Rurale në Kosovë", projekt ky i cili implementohet nga Islamic Relief Kosova.

1.2 Përfitues direkt nga ky donacion do të jenë te rinjet nga komuna e Lipjanit. Këto kategori do të përfitojnë grante per nisje te ideve biznesore.

Neni 2 – Detyrimet e palëve

2.1 **Vlera totale** e këtij projekti është në vlerë **20,000.00 €** (njëzet mijë euro), nga e cila:

2.2 **Komuna e Lipjanit** merr përsipër që me vullnetin e saj dhe pa asnjë pretendim të mëtejshëm në lidhje me këtë marrëveshje, të kontribuojë në shumën prej **10,000.00** € (dhjetë mijë euro) lidhur me zbatimin e këtij projekti.

2.3 **Islamic Relief Kosova** merr përsipër që me vullnetin e saj dhe pa asnjë pretendim të mëtejshëm në lidhje me këtë marrëveshje, të kontribuojë në shumën prej **10,000.00** € (dhjetë mijë euro) lidhur me zbatimin e këtij projekti.

Bound on ___ /___/2025 between the Municipality of Lipjan with the address St. "Shqiperia" nr.28 14000, Lipjan, Kosovë, represented by its Mayor, Mr. Imri Ahmeti

and

The charitable organization Islamic Relief Kosovo with address Bajram Kelmendi, no. 10/a, represented by its Director, Mr. Mohamed Soliman.

Article 1 - Purpose of the agreement

1.1 This agreement is related to the purpose of cooperation between the Municipality of Lipjan and Islamic Relief Worldwide - Office in Kosovo, regarding the implementation of the project " Integrated project for support in Health, Education and Rural Economy in Kosova ", project which is implemented by Islamic Relief Kosovo.

1.2 The direct beneficiaries of this donation will be the youth of Lipjan municipality. These categories will benefit from grants of startup business ideas.

Article 2 - Obligations of the parties

2.1 **The total value** of this project is **€20,000.00** (twenty thousand euros), of which:

2.2 **The Municipality of Lipjan** undertakes, of its own free will and without any further claims regarding this agreement, to contribute the amount of **€10,000.00** (ten thousand euros) related to the implementation of this project.

2.3 **Islamic Relief Kosovo** undertakes, of its own free will and without any further claims regarding this agreement, to contribute the amount of **€10,000.00** (ten thousand euros) related to the implementation of this project.

2.4 **Numri total i granteve për nisje të biznesit,** të shpërndara nga ky projekt do të jetë **4** (katër).	2.4 **The total number of grants for startup business,** from this project will be **4** (four).
2.5 Përfituesit do të përzgjedhen nga komisioni i Islamic Relief, në bazë të ideve që do të prezentojnë para tyre.	2.5 The beneficiaries will be selected by the Islamic Relief committee, based on the ideas they will present to them.
Neni 3 – Afati i pageses	**Article 3 – Payment deadline**
3.1 Komuna e Lipjanit do t'i dorëzoj shumën prej 10,000.00 € (dhjetë mijë euro) Shuma e lartcekur do të procedohet për pagesë në momentin e shpërndarjes së granteve, konform dispozitave ligjore në fuqi dhe kritereve të përcaktuara në thirrjen për ndarje të granteve.	3.1 The Municipality of Lipjan will hand over the amount of €10,000.00 (ten thousand euros) The aforementioned amount shall be processed for payment at the time of the grant disbursement, in accordance with the applicable legal provisions and the criteria set forth in the call for grant allocation.
Neni 4 – Mënyra e dorëzimit	**Article 4 - Method of delivery**
4.1 Komuna e Lipjanit do t'i dorëzoj shumën prej 10,000.00 € (dhjetë mijë euro) organizatës Islamic Relief Kosova përmes transaksionit bankar. Shuma e lartëcekur do të deponohet në xhirollogarinë bankare të organizatës Islamic Relief Kosova: NLB Prishtina 1708200008014285, në momentin e shpërndarjes së granteve.	4.1 The Municipality of Lipjan will hand over the amount of €10,000.00 (ten thousand euros) to the Islamic Relief Kosovo organization through a bank transaction. The aforementioned amount will be deposited in the bank account of the organization Islamic Relief Kosovo: NLB Prishtina 1708200008014285, at the time of the grant disbursement
Neni 5 – Përgjegjësitë e palëve	**Article 5 - Responsibilities of the parties**
5.1 Është e kuptueshme nga të dyja palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje që çdo palë duhet të jetë e aftë për të përmbushur përgjegjësitë sipas kësaj marrëveshjeje. Nëse në çdo kohë komuna nuk është në gjendje të kryejë funksionet e saj sipas Marrëveshjes, menjëherë do të njoftojë IRW - Koordinatoren e Programit si dhe e kundërta.	5.1 It is understood by both signatory parties to this agreement that each party must be capable of fulfilling its responsibilities under this agreement. If at any time the municipality is unable to perform its functions according to the Agreement, it will immediately notify the IRW - Program Coordinator and vice versa.
Neni – Kohëzgjatja e marrëveshjes	**Article 6 - Duration of the agreement**
6.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit të Drejtorit për Kosovë të Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë, dhe Kryetarit të Komunës së Lipjanit, dhe do të vazhdojë deri më 31 Korrik 2025 kur pritet edhe të përfundojë realizimi dhe faza e monitorimit të projektit	6.1 This agreement enters into force after the signature of the Director for Kosovo of Islamic Relief Worldwide office in Kosovo, and the Mayor of the Municipality of Lipjan, and will continue until 31 July 2025 when the implementation and monitoring phase of the campaign is also expected to be completed.

Islamic Relief Worldwide – Kosova Office

Dr. Mohamed Soliman

Country Director Islamic Relief Kosova

Data/Date: _____

Komuna e Lipjanit / Municipality of Lipjan

Z. Imri Ahmeti

Kryetar / Mayor

Data/Date: _____

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA - PLAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN
Pranuar me/ Primljeno: 05.05.2025
Njësia Jednica | Numri Broj | Shtojca Dodatak
01-660/03-22555

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ipkofoundation
St: "Enver Gjerqeku" ob-30 no.20
10000 Prishtinë, Kosova

T +383 (0)49 196 655
info@ipkofoundation.org • ipkofoundation.org

Memorandum Bashkëpunimi

Ky Memorandum Bashkëpunimi (më tutje referuar si "**Memorandum**") lidhet në mes të:

1. **IPKO Foundation,** me seli në rr. Enver Gjerqeku, OB-30, nr.20, 10 000 Prishtinë, me numër të regjistrit 5116845-3, përfaqësuar nga znj. Abetare Gojani, drejtoreshë ekzekutive (tutje referuar si "IPKO Foundation", ose "IF"), në njërën anë,

2. **Komuna e Lipjanit**, me seli në Komunën e Lipjanit, përfaqësuar nga z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit.

Së bashku referuar si "Palët"

Hyrje:

IPKO Foundation është një organizatë joqeveritare dhe jo-fitimprurëse që nga viti 2000, e cila mbështet të rinjtë e Kosovës në përgatitjen për të ardhmen digjitale përmes edukimit joformal.

Komuna e Lipjanit ka shprehur gatishmërinë për të bashkëpunuar me IPKO Foundation (tashmë me emër The Foundation House) në funksion të **organizimit dhe mbështetjes institucionale të HUB-it Rinor**, si dhe për realizimin e aktiviteteve edukative në të gjitha institucionet edukativo-arsimore publike të nivelit fillor dhe të mesëm të Komunës së Lipjanit.

Në bazë të diskutimeve të mëparshme, në shprehje të vullnetit të tyre të lirë, e në pajtim me kompetencat e Palëve, Palët si më poshtë dakordohen që të lidhin këtë Memorandum sipas termeve dhe kushteve në vijim:

Neni 1
Palët dhe pëlqimi i vullnetit

1. Ky memorandum i bashkëpunimit lidhet ndërmjet Komunës së Lipjanit të përfaqësuar nga Kryetari Z. Imri Ahmeti dhe IPKO Foudation (tashmë me emër të ri The Foundation House) me seli në rr. "Enver Gjerqeku", ob-30, nr.20, Prishtinë, përfaqësuar nga znj. Abetare Gojani, drejtore ekzekutive.

2. Komuna e Lipjanit dhe IPKO Foundation (tashmë me emër të ri The Foundation House) janë pajtuar për zhvillimin e aktiviteteve rinore dhe përdorimin e hapësirës së Hub-it Rinor.

Neni 2
Qëllimi i memorandumit të bashkëpunimit

1. IPKO Foundation është një Fondacion që vepron në Kosovë që nga viti 2000, qëllimi i të cilit është të mbështesë të rinjtë e të gjitha grupeve të cilët kanë një vizion digjital për Kosovën. IPKO Foundation investon drejtpërdrejtë në zhvillimin profesional të të rinjve dhe të rejave të Kosovës duke nxitur edukimin e të rinjve/rejave, promovimin e edukimit jo formal dhe theksimin e rritjen e aktiviteteve që synojnë edukimin jo formal si dhe zhvillimin e gjeneratave të reja lidere në teknologji dhe inovacion.

2. Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është të përcaktojë modalitetet e bashkëpunimit ndërmjet palëve për menaxhimin e HUB-it, i cili është themeluar dhe menaxhuar deri më tani nga Organizata si pjesë e një projekti të UNICEF-it, duke siguruar vazhdimësinë e shërbimeve dhe aktiviteteve të tij në dobi të komunitetit rinor të Komunës së Lipjanit. Në këtë kuadër, palët angazhohen për të arritur objektivat e përbashkëta, duke fuqizuar të rinjtë dhe të rejat në fushat e edukimit jo formal dhe inovacionit, të cilat IPKO Foundation i implementon në këtë komunë.

Neni 3
Objektivat dhe fushëveprimi i bashkëpunimit

1. Objektivat kryersore të këtij Memorandumi janë:

   1.1. Të krijohet një platformë funksionale për bashkëpunim ndërmjet Komunës së Lipjanit dhe IPKO Foundation,
   1.2. Të mundësohet ofrimi i trajnimeve dhe aktiviteteve që përforcojnë aftësitë e buta, kapacitetet digjitale dhe vetëdijen qytetare te të rinjtë,

1.3.Të sigurohet një qasje e barabartë për të gjithë nxënësit e nivelit të mesëm dhe nivelit të ulët për të marrë pjesë në aktivitetet e HUB-it,

1.4.Të përkrahen iniciativat e të rinjve që rezultojnë nga programet përmes mentorimit dhe rrjeteve mbështetëse.

2. Fushëveprimi i bashkëpunimit përfshin, por nuk kufizohet në:

2.1.Ofrimin e qasjes në shkolla për informim, promovim dhe përfshirje të nxënësve,

2.2.Organizimin e sesioneve edukative brenda dhe jashtë hapësirës së HUB-it;,

2.3.Bashkërendimin e burimeve për të përmbushur objektivat e përbashkëta,

2.4.Ndërveprimin me aktorë të tjerë të komunitetit për të rritur ndikimin e iniciativave të përbashkëta.

Neni 4
Detyrimet e Komunës së Lipjanit

1. **Komuna e Lipjanit merr përsipër që:**

1.1.Të sigurojë një hapësirë të përshtatshme për funksionimin e HUB-it, e cila do të jetë në pronësi ose administrim të Komunës së Lipjanit dhe në menagjim të IPKO Foundation e cila do të jetë në dispozicion për të gjitha aktivitetet edukative, rinore dhe komunitare që do të organizohen nga IPKO Foundation në kuadër të programeve për të rinjtë.

1.2.Të mbulojë të gjitha shpenzimet komunale që lidhen me mirëmbajtjen e hapësirës, përfshirë furnizimin me energji elektrike, ngrohje, ujë, pastrim dhe mbështetje teknike në rast nevoje.

1.3.Të garantojë qasje dhe bashkëpunim të plotë me institucionet edukativo-arsimore në territorin e Komunës së Lipjanit, me qëllim që të mundësohet implementimi i punëtorive, trajnimeve dhe aktiviteteve për të rinjtë.

1.4.Të përfshihet në promovimin institucional të aktiviteteve të HUB-it, përmes kanaleve të veta zyrtare si faqja e internetit e Komunës, rrjetet sociale dhe komunikimi me drejtorët e shkollave.

1.5.Të lehtësojë komunikimin dhe bashkëpunimin me institucionet tjera publike apo partnere lokale, që mund të jenë relevante për forcimin e efekteve të HUB-it dhe programeve të tij;

1.6.Të jetë palë aktive në takimet e koordinimit dhe mbikëqyrjes, të cilat do të organizohen për vlerësimin e implementimit të këtij Memorandumi.

Neni 5
Detyrimet e IPKO Foundation

1. IPKO Foundation merr përsipër që:

   1.1. Të zhvillojë dhe menaxhojë komponentën programatike të HUB-it, përfshirë planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve si: punëtori, trajnime, sesione informuese, fushata vetëdijësuese, evente rinore dhe të tjera.

   1.2. Të organizojë punëtori për të rinjtë gjatë periudhës së bashkëpunimit.

   1.3. Të ofrojë të gjitha pajisjet dhe materialet didaktike të nevojshme për realizimin e aktiviteteve (si laptopë, projektorë, mjete pune kreative, formularë, broshura informuese etj.);

   1.4. Të dorëzojë raporte të cilat përfshijnë përshkrimin e aktiviteteve të realizuara, pjesëmarrësit, rezultatet dhe impaktin përfundimtar, si dhe të paraqesë një raport përmbledhës në fund të periudhës së bashkëpunimit;

   1.5. Të sigurojë që të gjitha aktivitetet të zbatohen në përputhje me parimet e barazisë, gjithëpërfshirjes, mbrojtjes së të dhënave dhe transparencës, duke përfshirë edhe respektimin e legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës për mbrojtjen e të miturve dhe edukimin.

Neni 6
Modalitetet financiare dhe logjistike

1. Komuna e Lipjanit do të mbulojë vetëm shpenzimet e hapësirës, dhe ato të përcaktuara në nenin 4 të këtij Memorandumi dhe nuk do të ketë asnjë obligim financiar për aktivitetet e HUB-it.

2. IPKO Foundation do të sigurojë fondet për zbatimin e drejtpërdrejtë të aktiviteteve, përmes burimeve të veta ose përmes mbështetjes së donatorëve ndërkombëtarë, dhe do të mbulojë

3. Çdo përfshirje e palëve të treta (donatorë apo organizata partnere) në bashkë-menaxhimin apo bashkë-financimin e aktiviteteve duhet të koordinohet dhe të marrë pëlqimin paraprak të palës tjetër.

Neni 7
Kohëzgjatja dhe përfundimi i marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët dhe mbetet në fuqi për një periudhë prej dy (2) vitesh, me mundësi vazhdmi me marrëveshje të ndërsjellë.

2. Marrëveshja mund të përfundojë para afatit nga secila palë me një njoftim me shkrim të paktën një (1) muaj më përpara.

3. Në rast të mosrespektimit të kushteve të marrëveshjes nga ndonjëra palë, pala tjetër ka të drejtë të kërkojë rishikimin ose përfundimin e saj.

Neni 8
Ndryshimet dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo ndryshim në këtë marrëveshje do të bëhet vetëm me pajtimn e të dyja palëve dhe do të formalizohet me anë të një ankesi të nënshkruar nga të dy palët nënshkruese.

2. Palët do të bëjnë përpjekje për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje në mënyrë miqësore. Nëse nuk arrihet pajtueshmëri, çështja mund të zgjidhet përmes mekanizmave ligjorë të aplikueshëm në Republikën e Kosovës pranë gjykatës kompetente.

Neni 9
Komunikimi dhe takimet informuese

1. Palët janë pajtuar që të caktojnë nga një person kontaktues e që përgjegjësi e tyre do të jetë realizimi i plotë i këtij Memorandumi, me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave të jetë i shpejtë, konkret dhe efikas.

2. Për IF-në, si person kontaktues për komunikim është Adelina Qarri Hoxha ndërsa për Komunën e Lipjanit është z. Liridon Duhlaku.

3. Kur është e nevojshme, palët bashkëpunojnë në përgatitjen dhe ofrimin e takimeve informuese. Takimet ndërmjet palëve mbahen sipas nevojës dhe organizohen nga njëra palë sipas kërkesës.

Neni 10
Hyrja në fuqi

1. Ky Memorandum hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit nga të dy palët.

2. Ky Memorandum është i shkruar në gjuhën shqipe, në dy (2) kopje identike, nga një për secilën palë.

Lipjan,
Me datë: 2.05.2015

Abetare Gojani
Drejtore Ekzekutive

IPKO Foundation

ipkofoundation prishtinë

Imri Ahmeti
Kryetar i Komunës

Komuna e Lipjanit

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E LIPJANIT

Komuna e Lipjanit

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Primljeno: 26.05.2025		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-550/01-26019		

Humanity First
Serving Mankind

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

lidhur ndërmjet

Komunës së Lipjanit

dhe

Humanity First

Për shpërndarjen e produkteve të mishit për **50 familje** në nevojë të Komunës së Lipjanit në prag të festës së Kurban Bajramit

Lipjan, Qershor 2025

Qëllimi

1. Qëllimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Komunës së Lipjanit dhe Humanity First është furnizimi me produkte të mishit të cilat do t'u shpërndahen familjeve në nevojë dhe që jetojnë me asistencë sociale në Komunën e Lipjanit.

Lloji i donacionit

1. Gjithsej do të shpërndahen **50 pako**. Për çdo familje do të shpërndahet një pako me produkte të mishit. Një pako peshon **5kg** dhe përmban: 2kg mish tul, 1kg qebapa, 1kg qyfte dhe 1kg suxhuk. 1 Pako ka vlerë rreth **35 euro**.

Orari i implementimit të donacionit

1. Në pajtim me të dyja palët e lidhjes së këtij memorandumi mirëkuptimi është caktuar që shpërndarja e pakove me produkte të mishit të bëhet **ditën** _____ **më datë: ___.06.2025, në orën __:__**.

Komuna e Lipjanit zotohet për të ofruar mundësitë e mëposhtme:

1. Për komisionin prej tre anëtarësh që do të bëjnë përgatitjen e listës së **50 familjeve** në nevojë që janë pranuese të donacionit, do të caktojë një anëtar. Anëtari i caktuar

është: _____.

2. Të jenë të përpiktë në respektim të orarit dhe datës së caktuar të shpërndarjes së pakove ushqimore;
3. Angazhon së paku një zyrtar social për të ndihmuar shpërndarjen e pakove në terren;
4. Monitoron shpërndarjen e pakove me produkte mishi dhe kujdeset të regjistrojë emrin dhe mbiemrin e përfituesit, numrin e anëtarëve të shtëpisë së përfituesit, numrin personal të përfituesit, vendbanimin dhe nënshkrimin e përfituesit.

Humanity First zotohet për të siguruar mundësitë e mëposhtme:

1. Për komisionin prej tre anëtarësh që do të bëjnë përgatitjen e listës së **50 familjeve** pranuese të donacionit që janë në nevojë dhe me asistencë sociale, do të caktojë një anëtar. Anëtari i caktuar është:
    1. Besmir Yvejsi.
2. Përmes ndërmarrjes private ETC siguron produktet e mishit;
3. Përmes ndërmarrjes private ETC siguron transportimin e produkteve të mishit me automjet frigodhomë që i mban të freskëta produktet e mishit gjatë transportimit dhe shpërndarjes;
4. Të jenë të përpiktë në respektim të orarit dhe datës së caktuar të shpërndarjes së pakove me produkte të mishit;
5. I përmbahet të gjitha zotimeve të marra përsipër në këtë marrëveshje.

Dispozita përfundimtare

1. Ky memorandum është nënshkruar në katër (4) kopje origjinale, në gjuhën shqipe.

Hyrja në fuqi

Memorandumi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët, ndërkohë zbatimi i saj fillon me datë __.06.2025, ora __:__.

Vendtakimi i fillimit të shpërndarjes së pakove me produkte të mishit është: _____, **Lipjan.**

Lipjan

Datë: 26.05.2025

Komuna e Lipjanit

Humanity First

Humanity First
Serving Mankind

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA LIPJAN
OPŠTINA LIPJANE
MUNCIPALITY OF LIPJAN

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPJAN

Pranuar më:
Primljeno: 19-05-2025

Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-510/02-	24936	

AQH Accessible Quality Healthcare

SDC project implemented by Swiss TPH

Memorandum of Understanding

between

MUNICIPALITY OF LIPJAN

represented by Mr. Imri Ahmeti

AND

ACCESSIBLE QUALITY HEALTH CARE PROJECT (AQH)

represented by Mr. Nicu Fota

Memorandum Mirëkuptimi

ndërmjet

KOMUNA E LIPJANIT

përfaqësuar nga z. Imri Ahmet

DHE

PROJEKTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR TË QASSHËM DHE CILËSOR (AQH)

përfaqësuar nga z. Nicu Fota

Background

This Memorandum of Understanding (hereinafter referred to as the 'Memorandum') aims to establish a partnership between the Accessible Quality Health Care Project AQH (hereinafter referred to as 'AQH') and the Municipality of Lipjan (hereinafter referred to as 'Municipality').

This document presents an agreement that legally binds the parties in the implementation of various activities for common goals and elaborates the conditions under which this cooperation will function as well as the roles and responsibilities of each party.

Article 1
Purpose

The purpose of this Memorandum is to co-finance purchase of an Ultrasound machine for the purpose of improving quality of PHC services through provision of ultrasonography services in MFMC in Lipjan to the community it serves.

The parties, Municipality and AQH, understand to promote good governance through participation and transparency in planning and decision-making towards a smooth fulfilment of the present Memorandum objectives.

Sfondi

Ky Memorandum Mirëkuptimi (në tekstin e mëtejmë i referuar si 'Memorandumi') synon të krijojë një partneritet ndërmjet Projektit të Kujdesit shëndetësor të qasshëm dhe cilësor AQH (në tekstin e mëtejmë 'AQH') dhe Komunës së Lipjanit (në tekstin e mëtejmë 'Komuna')

Ky dokument paraqet një marrëveshje që lidh ligjërisht palët në zbatimin e aktiviteteve të ndryshme për qëllime të përbashkëta dhe elaboron kushtet në të cilat do të funksionojë ky bashkëpunim si dhe rolet dhe përgjegjësitë e secilës palë.

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi është të bashkëfinancojë blerjen e nje aparati ultrasonografik me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të KPSh-së përmes ofrimit të shërbimeve ultrasonografike në QKMF në Lipjan për popullatën komunës.

Palët, Komuna dhe AQH, do të bashkëpunojnë për të promovuar qeverisjen e mirë nëpërmjet pjesëmarrjes dhe transparencës në planifikim dhe vendimmarrje, me qëllim të përmbushjes pa probleme të objektivave të Memorandumit aktual.

Article 2
Obligations of the Municipality

1. Through this Memorandum, the Municipality commits to participate and to co-finance the purchase of an ultrasound machine in amount of 20% of the total price which is estimated to be up to 20,000.00 Euros (twenty thousand euros)

2. The amount mentioned at para.1 of this article will be allocated from the Municipality of Lipjan budget, the economic category "fund for co-financing with donors".

3. The municipality commits to appoint the contact person responsible for the implementation of the present MoU, who will cooperate and communicate with AQH.

4. Necessary space and maintenance of the machine, as well as, trained staff for the provision of ultrasonography services should be provided by the Municipality of Lipjan.

Article 3
Obligations of the AQH

1. Through this Memorandum, AQH undertakes to participate and to co-finance the purchase of ultrasound machine with the necessary funds in amount of 80% of the total price which is estimated to be about 20,000.00 Euros (twenty thousand euros)

2. Through its procurement department, AQH will call for applications, select the supplier, contract and monitor delivery, mounting and putting into function the machine, and training of the staff for its use, in accordance with the Swiss and international procurement standards and in cooperation with the Municipality.

3. Through its procurement department, and based on the project submitted by the MFMC and DHSW, AQH will elaborate the technical specifications for the ultrasound machine, in cooperation with the Municipality.

4. AQH commits to appoint the contact person responsible for the implementation of the present MoU, who will cooperate and communicate with Municipality.

Neni 2
Detyrimet e Komunës

1. Përmes këtij Memorandumi, Komuna zotohet të marrë pjesë dhe të bashkëfinancojë blerjen e aparatit ultrasonografik në vlerë prej 20% të shumës totale e cila vlerësohet të jetë deri në 20,000.00 Euro (njëzet mijë Euro).

2. Shuma e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni do të ndahet nga buxheti i Komunës së Lipjanit, kategoria ekonomike "kodi për bashkëfinancim me donatorë".

3. Komuna angazhohet të caktojë personin kontaktues përgjegjës për zbatimin e këtij MM, i cili do të bashkëpunojë dhe komunikojë me AQH-në.

4. Hapësirat e nevojshme dhe mirëmabajten e aparatit, si dhe stafin e trajnuar për ofrimin e shërbimeve ultrasonografike, duhet të sigurohen nga Komuna e Lipjanit.

Neni 3
Detyrimet e AQH

1. Nëpërmjet këtij Memorandumi, AQH merr përsipër të marrë pjesë dhe të bashkëfinancojë blerjen e aparatit ultrasonografik me fonde te nevojshme në vlerë prej 80% të shumës totale e cila vlerësohet të jetë rreth 20,000.00 Euro (njëzet mijë Euro).

2. Nëpërmjet departamentit të saj të prokurimit, AQH do të bëjë thirrje për aplikime, do të përzgjedhë furnitorin, do të kontraktojë dhe do të monitorojë furnizimin, montimin dhe funksionalizimin e aparatit, si dhe trajnimin e stafit për përdorimin e tij, në përputhje me standardet zvicerane dhe ndërkombëtare të prokurimit dhe në bashkëpunim me Komunën.

3. Nëpërmjet departamentit të saj të prokurimit, dhe bazuar në projektin e dorëzuar nga QKMF dhe DShMS, AQH do të elaborojë specifikimet teknike për aparatin ultrasonografik, në bashkëpunim me Komunën.

4. AQH zotohet të caktojë personin kontaktues përgjegjës për zbatimin e këtij MM, i cili do të bashkëpunojë dhe komunikojë me Komunën.

Article 4
Contracting the supplier

1. The parties, AQH and Municipality, will take part in contracting arrangements with the supplying company.
2. The payment to the supplying company will be done in accordance with the payment procedures stipulated in the contract, in accordance with the AQH procurement regulations for good and services. The invoices will be paid separately as follows: AQH Project will cover 80% of the total amount of invoice, whereas the Municipality of Lipjan will cover the remaining 20%.

Article 5
Change and termination

1. This Memorandum may be amended by the parties only in writing.
2. This Memorandum may be terminated by either party provided it notifies the other party in writing 60 (sixty) days in advance.

Article 6
Dispute resolution

1. The Parties shall endeavor to settle in the most appropriate manner any dispute arising out of this Memorandum of Understanding.

Article 7
Entry into force

1. The Memorandum enters into force on the day of signing by the parties.
2. This Memorandum is drafted in two (2) identical originals and each of the parties receives one (1) copy.

Signed today 19/05/25 date

Accessible Quality Healthcare Project AQH

Name: Nicu Fota
Title: Team Leader
Address: Tirana Str
10000 Prishtina

Projekti Kujdesi Shëndetësor i qasshëm dhe cilësor AQH

Emri: Nicu Fota
Titulli: Drejtues ekipi
Adresa: Rr. Tirana
10000 Prishtinë

Swiss TPH
INGO 5300563-2
KOSOVO

Neni 4
Kontraktimi i furnitorit

1. Palët, AQH dhe Komuna, do të marrin pjesë në marrëveshjet kontraktuese me kompaninë furnizuese.
2. Pagesa për kompaninë furnizuese do të bëhet në përputhje me procedurat e pagesës të përcaktuara në kontratë, në përputhje me rregullat e AQH-së për prokurim të mallrave dhe shërbimeve. Faturat do të paguhen ndaras si vijon: Projekti AQH do të mbulojë 80% të shumës totale te fatures, ndërsa Komuna e Lipjanit do të mbulojë 20% të mbetur.

Neni 5
Ndryshimi dhe ndërprerja

1. Ky Memorandum mund të ndryshohet nga palët vetëm me shkrim.
2. Ky memorandum mund të ndërpritet nga secila palë me kusht që të njoftojë palën tjetër me shkrim 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara.

Neni 6
Zgjidhjen e kontesteve

1. Palët do të përpiqen të zgjidhin në mënyrën më të përshtatshme çdo mosmarrëveshje që lind nga ky Memorandum Mirëkuptimi.

Neni 7
Hyrja në fuqi

1. Memorandumi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.
2. Ky Memorandum është hartuar në dy (2) kopje origjinale identike dhe secila nga palët merr nga një (1) kopje.

Nënshkruar sot 19/05/25 data

Municipality of Lipjan

Name: Imri Ahmeti
Title: Municipal Mayor
Adresa: Rr. Shqipëria nr28.
14000 Lipjan

Komuna e Lipjanit

Emri: Imri Ahmeti
Titulli: Kryetar i Komunës
Adresa: Rr. Shqipëria nr28.
14000 Lipjan

REPUBLIKA E KOSOVËS · KUVENDI KOMUNAL · OPŠTINA LIPJAN · REPUBLIKA KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
Njësia org.
Org.Jedinica
Org.Unit 02
Nr.i Faqeve
Br.Stranica
No.Pages 04
Nr.i Prot.
Broj Prot.
Prot.No. 4472
Data:
Datum:
Date 14.05.25
PRISHTINË / A
No.2

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN
01 Nr.Br. 401/01-24951
Data/Datum 19.05.2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Lipjanit
Municipality of Lipjan
Opstina Lipljan

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE INFRASTRUKTURORE

MINISTRIA E MJEDISIT PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS

DHE

KOMUNA E LIPJANIT

Prishtinë, Maj 2025

Neni 1
Palët Nënshkruese

1. **MINISTRIA E MJEDISIT PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS,** e përfaqësuar nga Zv. Ministri i MMPHI-së, (në tekstin e mëtejmë MMPHI),

dhe

2. **KOMUNA E LIPJANIT**, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, (në tekstin e mëtejmë Komuna).

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi është financimi i projekteve infrastrukturore të cekura më poshtë si dhe përcaktimi i obligimeve të MMPHI-së dhe Komunës për realizimin e projekteve:

1. **Ndërtimi i rrugëve në fshatrat Sllovi, Gadime, Smalluzhë, Gomnasellë, Llugaxhi dhe Babush, faza II,** kodi i projektit nr.16065 në vlerë prej **515,664 €.**

   - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës e financon projektin me 515,664 €, ndarjet buxhetore për vitin 2025 janë 300,000 €, ndërsa për vitin 2026 mjetet buxhetore të parashikuara janë 215,664 €;

Neni 3
Obligimet e MMPHI-së

1. MMPHI-ja i siguron mjetet për projektet nga neni 2, paragrafi 1 i këtij Memorandumi dhe nga një kopje i dërgon Komunës.

2. Ç'do tejkalim i vlerës së planifikuar për projektin nga neni 2, paragrafi 1 i këtij Memorandumi do të mbulohet nga Komuna.

3. Pagesat për financim të projekteve nga MMPHI-ja do të bëhen në pajtim me realizimin e punimeve/furnizimeve sipas kushteve të kontratës. Pagesat bëhen nga MMPHI-ja deri në vlerën e financimit sipas nenit 2, paragrafit 1 dhe 2 të këtij Memorandumi.

4. MMPHI-ja cakton një zyrtar për mbikqyrjen e realizimit të projekteve nga fillimi deri në përfundim të kontratës. MMPHI-ja me vendim do të caktoj detyrat, përgjrgjësitë dhe autorizimet e zyrtarit për mbikqyrje.

Neni 4
Obligimet e Komunës

1. Komuna siguron deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve në tërësinë e vlerës së projektit dhe një kopje e dërgon në MI.

2. Komuna obligohet ti krijoj kushtet e nevojshme për realizimin e projekteve për operatoret ekonomik, të ndërmerr te gjitha masat që kontraktuesi pa pengesë të filloj në implementimin e projekteve me kohë si dhe të siguroj specifikacionet teknike.

3. Komuna obligohet që projektet të zhvilloj në pajtim me Ligjin mbi prokurimin publik dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive si dhe aktet nënligjore për zbatimin e këtyre ligjeve.

4. Komuna e kryen procesin e tenderimit dhe cakton komisionin për hapjen e ofertave dhe vlerësim të tenderit.

5. Komuna emëron projekt menaxherin/organin mbikëqyrës për realizimin e projekteve, si dhe komisionin për inspektimin final të punimeve/pranimin teknik, në të cilin komision duhet të jetë një anëtar nga MMPHI-ja.

6. Projekt menaxheri/organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë vërteton sasinë dhe kualitetin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagesen e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të kushteve të kontratës.

7. Komuna obligohet që të njofton MI-në për çdo propozim ndryshim eventual të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projekteve dhe për këtë të kërkojë pëlqimin nga MMPHI-ja.

7.1. Komuna obligohet që në vend punishte të vendose tabelën informues (Pano) me shënimet për projektin, investitorët dhe operatorin ekonomik.

8. Komuna obligohet që për të realizuar pagesat për punët/furnizimet e kryera në nivel të financimit nga MMPHI-ja të kompletoj këto dokumente:

8.1. Procesverbalin e hapjes së tenderit dhe raportin e vlerësimit të tenderit (si dhe në rastet e korrigjimit të çmimeve të dorëzohen dokumentet e korrigjuara);

8.2. Kopjen e Kontratës të nënshkruar me operatorin ekonomik, së bashku me ofertën financiare, të vertetuara në bazë të origjinalit nga menaxheri i prokurimit të Komunës;

8.3. Vendimi mbi emërimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës dhe komisionin e pranimit nga ana e Komunës;

8.4. Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionit të pranimit mbi punët/furnizimet e kryera dhe të aprovuara (situacionet e aprovuara);

8.5. Faturën origjinale nga operatori ekonomik deri në lartësinë e shumës së financuar nga MMPHI-ja dhe

8.6. Kopjen e certifikatës së biznesit, llogarinë bankare dhe letërnjoftimin e pronarit të operatorit ekonomik (nëse nuk është i regjistruar në SMIFK-Departamenti i Thesarit-Ministria e Financave dhe Transfereve).

9. Komuna duhet të ndërmarr të gjitha masat që projektet të përfundoj në përputhje me ndarjet buxhetore sipas viteve për projektin e tillë. Pas këtij afati të gjitha obligimet kalojnë në përgjegjësi të Komunës.

10. Komuna është e obliguar të njoftoj MI-në për rrjedhat e realizimit të projektit sipas një plani dy javor deri në përfundim të projektit.

11. Komuna obligohet të ndërmarrë dhe kryej çdo lloj shpronësimi të nevojshëm për zbatimin e projekteve përfshirë procedurat dhe kompenzimin.

Neni 5
Ndryshimet dhe ndërprerja e Memorandumit të Mirëkuptimit

1. Me pëlqimin paraprak të Ministrit të MMPHI-së dhe Kryetarit të Komunës, ky Memorandum mund të ndryshohet dhe plotësohet.

2. MMPHI-ja mbanë të drejtën e ndërprerjës së shfrytëzimit të buxhetit për këtë destinim në rast se konstaton se Komuna nuk i përmbush obligimet e veta të dala nga ky Memorandum.

Neni 6
Zgjidhja e kontesteve

Palët janë pajtuar në mes veti që ky Memorandum të zgjidhet me mirëkuptim.

Neni 7
Numri i Kopjeve

Memorandumi i Mirëkuptimit është nënshkruar në katër (2) kopje, nga një (1) kopje për secilën palë nënshkruese.

Neni 8
Pronësia e Projektit

1. Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga operatori ekonomik, ky investim (projekt) do të kaloje në pronësi të Komunës.
2. Ky investim regjistrohet në pronësi të Komunës në mënyrë elektronike dhe fizike në sistemin e pasurisë në Ministrin e Financave dhe Transfereve (SMIFK).

Neni 9
Hyrja ne fuqi

Palët nënshkruese janë pajtuar që ky Memorandum i Mirëkuptimit të fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

Zv. Ministri i MMPHI-së

Hysen DURMISHI

Kryetari Komunës

Imri AHMETI

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Primljeno: 23.05.2025		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-352/01-25795		

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

FONDACIONI AMANETI, me numër regjistrimi 5200533-7 dhe numër fiskal 602460280, me seli në Prishtinë, Rruga Kerem Levton, kompleksi banesor Troja Residence, hyrja 2, kati 1 nr. 104 – Mati 1, i përfaqësuar nga z. Blerim Arifi,
dhe
Komuna e Lipjanit, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z. Imri Ahmeti

bien dakord për realizimin e projektit në vijim:

Neni 1

Fondacioni Amaneti do të financojë dhe organizojë **hapjen e një pusi për ujë të pijshëm** për **shkollën fillore në fshatin Ribar i Madh**, Komuna e Lipjanit. Projekti ka për qëllim përmirësimin e kushteve higjienike dhe infrastrukturore për nxënësit dhe stafin mësimor.

Neni 2

Komuna e Lipjanit do të sigurojë mbështetjen institucionale, përfshirë:

- Ndihmën në identifikimin e lokacionit më të përshtatshëm për pusin,
- Mbikëqyrjen e punimeve në koordinim me Fondacionin,
- Ndihmë në çështjet teknike dhe logjistike gjatë fazës së implementimit.

Neni 3

Punimet për hapjen e pusit do të fillojnë më së largu **në muajin maj 2025**, në përputhje me marrëveshjen teknike mes palëve.

Neni 4

Fondacioni Amaneti do të mbulojë shpenzimet e punimeve për hapjen e pusit, përfshirë pajisjet dhe punën e kontraktuesve, në përputhje me standardet për siguri dhe cilësi.

Neni 5

Kjo marrëveshje është përpiluar në **dy (2)** kopje, të dyja me fuqi të njëjtë ligjore, nga një për secilën palë.

Neni 6

Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga të dyja palët.

Nënshkruar më
Data: _____

Vërtetojnë:

Fondacioni Amaneti
z. Blerim Arifi

FONDACIONI "AMANETI" KOSOVË

Kryetari i komunës së Lipjanit
z. Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS · KOMUNA LIPJAN · OPŠTINA LIPLJAN · REPUBLIKA KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Primljeno:	02.06 2025	
Njësia Jedinica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-020/08-27293		

KRYEQYTETI PRISHTINA | KOMUNA PODUJEVË | KOMUNA LIPJAN | KOMUNA FUSHË KOSOVË | KOMUNA GRAÇANICË | KOMUNA OBILIQ

Me qëllim bashkëpunimi, si dhe synimit të shndërrimit të rajonit në një zonë funksionale metropolitane, në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit Nr.04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal të Republikës së Kosovës, ne të poshtëshënuarit pajtohemi për të nënshkruar këtë:

MARRËVESHJE-KORNIZË E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL SHUMËFUNKSIONAL

NDËRMJET:

1. **Kryeqyteti i Kosovës, Prishtina** (tani e tutje, **Kryeqyteti),** i përfaqësuar nga Kryetari i Kryeqytetit;
2. **Komuna e Podujevës,** e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës;
3. **Komuna e Lipjanit,** e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës;
4. **Komuna e Fushë Kosovës,** e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës;
5. **Komuna e Graçanicës,** e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës;
6. **Komuna e Obiliqit,** e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës.

Neni 1

QËLLIMI I MARRËVESHJES

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje të Bashkëpunimit është bashkërendimi i aktiviteteve në mes të Kryeqytetit dhe pesë (5) komunave fqinje, në fusha të ndryshme, me interes të përgjithshëm me të cilin do të krijohen lehtësira për mirëqenien e qytetarëve të Kryeqytetit dhe këtyre komunave në sfera të ndryshme të jetës.

Neni 2
FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

1. FUSHA E MIRËQENIES SOCIALE

Palët nënshkruese pajtohen:

1. Të bashkëpunojnë në ofrimin e strehimit të përkohshëm për personat në nevojë, nënat të cilat i nënshtrohen dhunës në familje, nënave vetushqyese, fëmijëve pa përkujdesje prindërore, të miturve pa përkujdesje, etj.;
2. Që Kryeqyteti dhe secila komunë të mbajë përgjegjësinë për krijimin e hapësirave për trajtim, kujdesie, edukim dhe argëtim të fëmijëve në situata rruge (lëmoshë-kërkuesve), të cilët janë banorë të komunave;
3. Në rrethana të caktuara, në veçanti në mungesë të hapësirës/kushteve në njërën nga komunat të cilat janë nënshkruese të marrëveshjes, të gjithë të bashkëpunojnë në mënyrë që asnjë fëmijë të mos mbetet në rrugë;
4. Të krijojnë kushte banimi për rastet sociale.

2. FUSHA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Palët nënshkruese pajtohen:

1. Të ndërtojnë një plan të përbashkët mobiliteti, i cili do të përfshinte të gjitha çështjet e ndërlidhura me trafikun dhe shtigjet për biçikleta, si:

1.1 Zhvillimi i një vizioni dhe strategjie të re të transportit;
1.2 Transporti publik;
1.3 Modalitetet e udhëtimit aktiv;
1.4 Sistemi rrugor dhe parkimi;
1.5 Menaxhimi i trafikut dhe siguria rrugore;
1.6 Planifikimi për mobilitetin e qëndrueshëm urban;
1.7 Investimet dhe financimi i Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU);
1.8 Struktura institucionale e PMQU-së;
1.9 Bashkëpunim në transportin e udhëtareve dhe funksionalizim i linjave:

- Prishtinë - Fushë Kosovë;
- Prishtinë - Obiliq; dhe
- Graçanicë – Prishtinë; me fshatrat e Kryeqytetit që kalojnë përmes territorit të Graçanicës, përfshirë linjat:
  - Prishtinë - Mramur;
  - Prishtinë - Shashkovc;
  - Prishtinë - Kishnicë;
  - Prishtinë - Qendra Tregtare Prishtina Mall; dhe
  - Prishtinë – Janjevë;

1.10 Sistemin e sigurisë rrugore në afërsi të institucioneve shkollore;
1.11 Rregullimin e sistemit të trafikut rrugor;

1.12 Zhvillimin e planit/veprimit ndër-komunal mbi menaxhimin e mbeturinave;
1.13 Implementimin e rrjetit të shtigjeve të biçikletave; dhe
1.14 Marrëveshja për implementimin e masave të parapara në PMQU.

2. Ndërtimin e një impianti të përbashkët për ujërat e zeza;
3. Menaxhimin e përbashkët të mbeturinave - deponitë e mbeturinave;
4. Përmirësimin e cilësisë së ajrit, në mënyrë që të përmbushen standardet e BE-së, si dhe rregullimin e ambientit, përfshirë lumenjtë dhe ruajtjen e pyjeve, duke ndërmarrë aktivitete të përbashkëta, si:

4.1 Hartimin e planit të strategjisë për identifikimin e ndotësve të ajrit dhe projekteve të përbashkëta, të cilat mund të zbatohen së bashku;
4.2 Identifikimi i sipërfaqeve/zonave të degraduara, të cilat kanë nevojë për trajtim dhe mbjellje të drunjëve;
4.3 Përcaktimi dhe specifikimi i llojeve të drunjëve halorë ose atyre gjethe-gjerë që kanë mundësi më të madhe absorbimi, përreth kufirit Prishtinë – Obiliq, si dhe krijimi i një bufer (tampon) zone për uljen e nivelit të ndotjes së ajrit;
4.4 Vendosja e monitorëve për matjen e ndotjes së ajrit në nivel ndër-komunal me senzorë (matës) të përbashkët;
4.5 Aktivitete të përbashkëta mjedisore, si fushatat vetëdijesuese për mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë ndotjen e ajrit dhe zhurmës, me nxënës të shkollave ndër-komunale (së bashku me zyrën e mjedisit);
4.6 Pyllëzimi i sipërfaqeve të shpyllëzuara (së bashku me Drejtoritë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural);
4.7 Rregullimi i problemit të mbeturinave nga miniera e Kishnicës që shkaktojnë ndotjen e ajrit në mes komunës së Graçanicës dhe komunës së Prishtinës;

5. Bashkëpunimin ndër-komunal, gjatë sezonës së dimrit, në transportin ndër-urban; të konsiderohen mundësitë e organizimit të transport falas në muajt e dimrit, kur ka probleme me kushtet metrologjike, siç janë temperaturat e ulëta dhe krijimi i smogut, të dëmshëm për shëndetin e njeriut, me qëllimin e reduktimit të përdorimit të transportit privat/personal.

3. FUSHA E SPORTIT

Palët nënshkruese pajtohen të bashkëpunojnë për aktivitete sportive, siç janë klubet e qyteteve, si në organizime të përbashkëta ashtu edhe në mundësinë e shfrytëzimit të hapësirave sportive të ndërsjella.

4. FUSHA E KULTURËS

Palët nënshkruese pajtohen të bashkëpunojnë në nisma të ndryshme kulturore me interes të përbashkët, si:

1. Koncerte për të rritur dhe fëmijë;
2. Festivale kombëtare e ndërkombëtare;
3. Mbështetja e artistëve, përkrahja e aktiviteteve të përbashkëta kulturore, si dhe promovimi i njohurive të përbashkëta të ndërsjella në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore; dhe
4. Krijimi i një harte digjitale të kulturës së përbashkët rajonale në mes të komunave.

5. FUSHA E ARSIMIT

Palët nënshkruese pajtohen:

1. Të krijojnë një mekanizëm të përbashkët, në mes të DKA-ve të komunave nënshkruese të kësaj marrëveshjeje, për të komunikuar në rastet e urgjencave që dalin në arsim;
2. Së bashku me drejtoritë kompetente për çështjet e sigurisë, të bashkëpunojnë edhe për çështjen e sigurisë në shkolla, përfshirë shkëmbimin e planeve të veprimit;
3. Të hulumtohen veprimet adekuate, përfshirë elementet financiare, në mënyrë që t'u mundësohet të gjithë nxënësve nga rajoni të regjistrohen në shkollat e mesme sipas zgjedhjes së tyre; dhe
4. Të konsiderohen mundësitë e organizimit të përbashkët, përfshirë pjesën financiare, të transportit për nxënësit e fshatrave që ndodhen afër shkollave të komunave fqinjë.

6. FUSHA E SHËNDETËSISË

Palët nënshkruese pajtohen që në fushën e shëndetësisë të bëhet koordinimi i shërbimeve shëndetësore, përfshirë spitalin e kryeqytetit, si dhe bashkëpunimi në fushën e shëndetësisë primare dhe sekondare.

Fokusi i bashkëpunimit të përqendrohet edhe në nivelin primarë, në këto fusha:

1. Koordinimi i shërbimeve të integruara shëndetësore në kujdesin primarë (shërbimeve të përbashkëta shëndetësore dhe sociale);
2. Të zhvillohet një data-bazë ndër-komunale për kujdes të integruar, e që do të ndihmonte në avancimin e qasjes dhe përmirësimin e shërbimeve të integruara, për kategoritë e pacientëve me sëmundje kronike jo-ngjitëse, si: hipertensioni, diabeti, astma, sëmundjeve tjera fizike, sëmundjeve të shëndetit mental dhe të sjelljes, etj. Data-baza do të mundësonte edhe sigurimin e të dhënave, përgatitjen dhe ofrimin e shërbimeve, si dhe parandalimin e sëmundjeve ngjitëse;
3. Ofrimi i shërbimeve të përbashkëta shëndetësore urgjente;
4. Shkëmbimi i përvojave dhe angazhimi i përbashkët në ngritjen e kapaciteteve të personelit mjekësorë;
5. Bashkëpunim në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për nënat e reja dhe fëmijët deri në moshën tre vjeçare;
6. Bashkëpunim dhe përkrahje në mes të komunave me barna esenciale, siç është ofrimi i oksigjenit në raste të veçanta, si pandemia, etj.;
7. Koordinim në luftimin dhe parandalimin e TBC-së, e cila sëmundje, për shkak të pandemisë, mund të pësoj rritje në vitet në vijim;
8. Bashkëpunim në fushën e diagnostikës dhe shërbimeve laboratorike;
9. Bashkëpunim në gjetjen e formave dhe modaliteteve për motivimin e mjekësisë familjare; motivimi i mjekëve familjarë për të qëndruar në institucionet e kujdesit primarë shëndetësorë dhe për tu specializuar në mjekësi familjare;
10. Bashkëpunim në hartimin, implementimin dhe promovimin e programeve parandaluese për sëmundjet e rënda, si: sëmundjeve kardiovaskulare, kancerit colorectal, kancerit cervikal, etj.

7. FUSHA E BUJQËSISË

Palët nënshkruese pajtohen që në fushën e bujqësisë të bashkëpunojnë me aktivitete dhe projekte të ndryshme, si:

1. Organizimi i panaireve të përbashkëta ndër-komunale të prodhimeve bujqësore si dhe njësive agro-përpunuese;
2. Bashkëpunim ndër-komunal në fushën e turizmit rural;
3. Bashkëpunim në fushën e terreneve të gjuetisë;

4. Takime të rregullta për shkëmbim përvojash dhe ideve për projektet e ndryshme të granteve, subvencioneve dhe mbështetje financiare për fermerët e komunave përkatëse;
5. Takime ndër-komunale për ofrimin e shërbimeve këshillimore në fusha të ndryshme bujqësore për fermerë;
6. Bashkëfinancim ndër-komunal për realizimin (aplikimin) e projekteve në fushat me interes të ndërsjellë.

8.FUSHA E SIGURISE DHE EMERGJENCAVE

Palët nënshkruese pajtohen që në fushën e sigurisë dhe emergjencave të bashkëpunojnë me aktivitete dhe projekte të ndryshme, si:

1. Të koordinohen dhe të reagojnë në mënyrë të përbashkët në raste të emergjencave;
2. Të krijojnë një mekanizëm të përbashkët, në mes të drejtorive relevante të palëve nënshkruese të kësaj marrëveshjeje, për të komunikuar dhe koordinuar në rastet e sigurisë dhe emergjencave;
3. Të ndërtojnë një qasje të përbashkët dhe bashkëpunim të ngushtë për trajtimin e qeneve endacakë, përfshirë masat afatshkurta, afatmesme dhe ato afatgjate, çdoherë në koordinim me pushtetin qendrorë. Në kuadër të masave afatgjata, komunat pajtohen të ndërtojnë një Strehimore Rajonale të Kafshëve, me theks në qentë endacakë, por edhe ata me pronarë. Kryeqyteti, tanimë ka ndarë një parcelë dhjetë-hektarësh për këtë qëllim, derisa me komunat fqinjë do të koordinohemi dhe do të bashkëpunojmë për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e përbashkët të qendrës.

9.TJERA

Të hulumtohen format e përshtatshme për avancimin e bashkëpunimit multi-etnik në mes të Komunës së Graqanicës dhe palëve tjera nënshkruese të kësaj marrëveshje.

Neni 3
PLANET ZBATUESE

1. Kuvendi i Kryeqytetit dhe Kuvendet e pesë Komunave tjera, autorizojnë Kryetarët/et e tyre që, për realizimin e aktiviteteve dhe projekteve nga fushat e bashkëpunimit, të përshkruara në nenin 2 të kësaj marrëveshje, të hartojnë planet e detajuara zbatuese, te cilat pastaj do të aprovohen dhe nënshkruhen nga Kryetarët përkatës të Komunave pjesëmarrëse.
2. Këto plane zbatuese duhet të përfshijnë dhe të plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore të parapara në Ligjin Nr. 04/l-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, përfshirë afatet kohore dhe kushtet për tërheqje nga marrëveshja.

Neni 4
NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I MARRËVESHJES

Në rast nevoje dhe me pëlqimin e palëve, kjo marrëveshje e bashkëpunimit mund të ndryshohet dhe plotësohet në formë të shkruar.

Neni 5
PËLQIMI I PALËVE

Mospajtimet ose interpretimet eventuale të pikave të kësaj marrëveshje do të rregullohen në mënyrë miqësore, me marrëveshje konsensuale.

Neni 6
HYRJA FUQI

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi pas nënshkrimit të kryetarëve dhe aprovimeve në kuvendet relevante, sipas procedurave të parapara në Ligjin nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal.

Neni 7
TË NDRYSHME

1. Komunikimi ndërmjet palëve lidhur me këtë marrëveshje do të bëhet me shkrim.
2. Kjo marrëveshje është përpiluar në 6 (gjashtë) kopje identike dhe në dy gjuhë, me përmbajtje të njëjtë, e të cilat kanë të njëjtin efekt juridik.

KRYEQYTETI PRISHTINA

Përparim Rama

KOMUNA E PODUJEVËS

Shpejtim Bulliqi

KOMUNA E LIPJANIT

Imri Ahmeti

KOMUNA E FUSHË KOSOVËS

Besnik Osmani

KOMUNA E GRAÇANICËSË

Leutrim Ajeti

KOMUNA E OBILIQIT

Xhafer Gashi

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPJAN

Pranuar me: Primljeno:	09.07.2025	
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-300/01-34592		

LIDHJA E BIZNESEVE TË KOSOVËS
BUSINESS LEAGUE OF KOSOVO

Komuna Lipjan
Municipaly of Lipjan

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI DHE BASHKËPUNIMI

në mes të

LIDHJES SE BIZNESEVE TË KOSOVËS

dhe

KOMUNËS SË LIPJANIT

Lipjan
Korrik 2025

Lidhja e Bizneseve të Kosovës dhe Komunës së Lipjanit, me qëllim të vendosjes së bashkëpunimit afatgjatë, firmosin këtë:

Memorandum Mirëkuptimi

Neni 1

Palët , Lidhja e Bizneseve dhe Komunës së Lipjanit, do të zhvillojnë forma e bashkëpunimit në fushëveprimin e vet.

Për këtë ata do të ndërtojnë lidhje të qëndrueshme në shkëmbimin e ekspertizës, përvojës dhe resurseve të përbashketa në të mire të zhvillimit ekonomik Komunës së Lipjanit.

Palët do të mbështesin projektet reciproke, do të ndërmarrin iniciativa të përbashkëta dhe bashkarishtë do të realizojnë projekte nga fusha e këtij Memorandumi, me qëllim të vendosjes dhe zhvillimit të bashkëpunimit në të mirë të zhvillimit ekonimik të komunës.

Neni 2

Marrëveshja parasheh harmonizim të aktiviteteve mes Lidhjes se Bizneseve të Kosovës dhe Komunës së Lipjanit. E tërë kjo bëhet me qëllim të afrohen me njëra tjetrën dhe të inkurajohet bashkëpunimi ekonomike në të mire të komunës dhe sektorit privat.

Neni 3

Ky Memorandum I Mirekuptimit synon rregullimin e marrëdhenieve ndërmjet palëve në procesin e implementimit të qëllimeve të përbashkëta. Pra në bazë të partneritetit do të zhvillojnë bashkëpunimin në realizimin e Promovimit të prodhimeve vendore, Promovimit të bizneseve, investimeve te huaja, propozimeve lidhur me zhvillimin ekonomik local Komunën e Lipjanit.

Neni 4

Do të ofrojne bashkëpunim të mirëfilltë në zhvillimin e projekteve tjera me karakter ekonomik.

Do te mbaj takime të përbashkëta zyrtare, sipas nevojave të palëve ne interest e komunes dhe zhvillimit ekonomik local dhe sektorit privat. Takime të përbashkëta zyrtare , diskutimeve dhe grupeve punues ne planet strategjike zhvillimore, urbanistike qe ndikojne ne zhvillimin ekonomik te komunes, ne interest e sektorit public dhe privat. Takime të përbashkëta zyrtare me Keshillin Publiko Privat ne Lipjan.

Neni 5

Nga ky memorandum, do përfitojnë sektori privat, prodhuesit vendos, turizmi dhe zhvillimi ekonomik i komunes si dhe duke sjelle investitor potencial te huaj ne komunen e Lipjanit.Ky Memorandum shënon një fillim të ri në angazhimet e përbashkëta për përmirësimin e mjedisit ekonomik dhe përkrahjen e bizneseve në Lipjanit .

Neni 6

Komuna do mbeshtet Lidhjen e Bizneseve, sipas ligjeve në fuqi ne aktvitetet te cilat do organizohen ne Komunen e Lipjanit, qe kane te bejne, promovimin dhe mbeshtetjen e sektorit privat dhe zhvillimin ekonomik te komunes se Lipjanit.

Neni 7

Ky Memorandim i Mirëkuptimit do të fillon të *implementohet* me rastin e nënshkrimit nga dy palet e nenshkruar. Ndryshimet ne të, apo nderprerja mund të behët me paralajmerim me shkrim në mës palëve, duke i shqyrtuar të gjitha komponentet për ndryshime apo për nderprerje.

Neni 8

Nënshkruesit të kësaj marrveshje janë nisur nga vullneti dhe marrëdhëniet per zhvillimin e ekonomik te vendit, bizneseve, respektivisht në mes të dy Istitucioneve, dhe rritjes të shkembimëve ne mes veti.

Neni 9

Nisur nga rëndësia që ka ekonomia në forcimin e këtyre marrëdhënieve, me dëshirën për të ofruar një model bashkëpunimi ne fushat perkatese ne interes të zhvillimit ekonomik dhe bizneseve të Komunës se Lipjanit.

Neni 10

Palët zotohen që do të kontribuojnë në fushën ekonomike të vendit, në të mirë të zhvillimit ekonomik të Komunes dhe Republikës së Kosovës.

Neni 11

Memorandumi *është i përpiluar në dy ekzemplarë me përmbajtje të njejtë, prej të cilave, pas nënshkrimit dhe protokolimit, nga një ekzemplar i dorëzohet për secilën palë.*

Neni 12

Kjo marrëveshje është në gjuhen shqipe dhe është e perpiluar në dy kopje identike.
Të gjitha kopjet kanë të njëjtën forcë ligjore dhe janë të vlefshme për të gjitha palët nënshkruese.

Neni 13

Ky Memorandum është lidhur lidhur me 09/07/ 2025, ne pajtim me ligjet ne fuqi të Republikës së Kosovës dhe statutit të dy institucioneve.

Nënshkruar në Lipjan,

Në emër të:
Lidhjes së Bizneseve të Kosovës

Besart Dreshaj-Kryetar

Në emër të:
Komunës së Lipjanit

Imri Ahmeti- Kryetar

Ndërmarrja Publike Qendrore
Posta e Kosovës Sh.A.
PK. SH.A.
Posta e Kosovës SH.A.
Post of Kosovo J.S.C.
Pošta Kosova D.D.
Nr./No./Br. 01-1246/2025
Data/Date/Datum 15-07-25
PRISHTINË-PRIŠTINA-PRIŠTINA

MARRËVESHJE BASHKËPUNIM
PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE POSTARE
(SHPËRNDARJA E DËRGESAVE/GJOBAVE TË TRAFIKUT RAJONAL)

Kjo marrëveshje lidhet në mes të:

1. **POSTA E KOSOVËS Sh.A.** adresa, rruga ''28 Nëntori'', nr.4, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës. Me numër unik identifikues:811285205, e përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor znj. **Nora Rraci** - Kryeshefe Ekzekutive, në tekstin e mëtejmë: Kryesi i Shërbimeve, dhe,

2. **KOMUNA E LIPJANIT** adresa, rruga ''Shqipëria'', 14000, Lipjan, e përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor z. **Imri Ahmeti** - Kryetar i Komunës së Lipjanit, në tekstin e mëposhtëm: Porositësi i Shërbimeve, dhe,

3. **POLICIA E KOSOVËS POLICIA E KOSOVËS** Adresa; Rr. Luan Haradinaj, nr. xx, 10 000, Prishtinë, Republika e Kosovës. E përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor z. Basri Shabani - Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Prishtinës, në tekstin e mëtejmë : Ndërmjetësues i Shërbimeve.

NDËRSA:

Duke marrë parasysh konsideratat dhe kushtet e premtimet reciproke të parashtruara këtu, personi tjetër juridik i identifikuar në faqen e nënshkrimeve të kësaj Marrëveshje kryerjen e shërbimeve Postare i identifikuar si, "Kryesi i Shërbimeve", personi tjetër juridik i identifikuar në faqen e nënshkrimeve të kësaj marrëveshje bashkëpunimi si "Porositësi i Shërbimeve" dhe personi tjetër juridik i identifikuar në faqen e nënshkrimeve të kësaj marrëveshje bashkëpunimi si "Ndërmjetësues i Shërbimeve '' bien dakord që të lidhet marrëveshje si vijon:

Marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e shërbimeve postare – PRANIM / PËRPUNIM *(Ndërmjetësues i Shërbimeve)* - **SHPËRNDARJA E DËRGESAVE / GJOBAVE TË TRAFIKUT RRUGOR NË ADRESË TË GJOBITURËVE** *(Kryesi i Shërbimeve),* sipas marrëveshjes me *(Porositësi i Shërbimeve).*

1. PËRKUFIZIME

Në këtë marrëveshje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtme kanë kuptimet e dhëna më poshtë:

MARRËVESHJE : do të thotë kjo marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e shërbimit postar. Marëveshje: Posta e Kosovës- Policia E Kosovës – Komuna e Lipjanit

AFAT : ka kuptimin e dhënë në Nenin 2.

KRYESI I SHËRBIMEVE : do të thotë : Posta e Kosovës Sh.A.

POROSITËSI I SHËRBIMEVE : do të thotë: Komuna e Lipjanit

NDËRMJETSUESI I SHËRBIMEVE : do të thotë: Policia e Kosovës

OPERATOR PUBLIK POSTAR : person juridik (Posta e Kosovës Sh.A) i licencuar për ofrimin e shërbimeve universale postare.

SHËRBIM POSTAR : Shërbimet e kryera me pagesë për dërgimin e dërgesave të postës së letrave, pakove, urdhërpagesave si dhe shërbimet e kryera me pagesë të cilat sigurohen nëpërmjet mjeteve për pranimin dhe dërgimin e dërgesave postare.

SHËRBIM UNIVERSAL POSTAR : Një minimum të përcaktuar shërbimesh, të një cilësie të caktuar, me çmime të përballueshme, i mundshëm përherë, në të gjitha pikat, për të gjithë shfrytëzuesit në territorin e Republikës e Kosovës;

SHËRBIM I VEÇANTË POSTAR : shërbimet me të cilat dërguesi kërkon mënyrë të veçantë të dërgimit, bartjes dhe dorëzimit të dërgesës, ndryshe quhen dërgesat të regjistruara, (dërgesë e porositur "R", dërgesë me lajmërim marrje "LM", dërgesë me kundërpagesë, shërbimi i shpejtë postar "EMS", etj).

GJOBAT TË TRAFIKUT RRUGOR : do të thotë, gjobat të shqiptuara pronarëve të veturave nga Policia e Kosovës për kundërvajtje në trafikun rrugor, brenda komunës përkatëse.

ZYRË POSTARE : hapësirën punuese në të cilën operatori postar ofron shërbime postare dhe

shërbimet e IFjB/pagesat.
TARIFA POSTARE : ka kuptimin e çmimorës në fuqi së shërbimeve postare, të aprovuar nga rregullatori ARKEP.

PERSONAT KONTAKTUES : ka kuptimin e personit me te cilin bëhen kontaktet në lidhje me zbatimin e mirëfilltë të kësaj kontrate.

2. AFATI I BASHKËPUNIMIT

2.1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi fillon në datën e nënshkrimit të saj, dhe vlenë me nënshkrimin e të tre (3) palëve kontraktuese dhe është e vlefshme për një periudhë kohore (3) vjeçare, deri me **31/12/2027** me mundësi vazhdimi, përveç rastit kur është fjala për zgjidhje të parakohshme të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, sipas marrëveshjes së palëve bashkëpunuese.

2.2. Zgjidhja e marrëveshjes së bashkëpunimit është e mundur edhe nëse dispozitat ligjore mbi shërbimet postare e parashohin një mundësi të tillë.

2.3. Nga Porositësi i Shërbimeve, kontaktet do të bëhen nga Drejtoria e Administratës.

2.4. Nga Kryesi i Shërbimeve znj. **Vlora .Thaqi@postakosoves.com,** zyrtare përgjegjëse për përcjelljen, kujdesin dhe menaxhimin e zbatimi të kontratës nr. tel; +38344587875, apo edhe nga **Shitja - PK. Sh.A,** nr. tel; 038534478 .

2.5. Nga Ndërmjetësuesi i Shërbimeve kontaktet do të bëhen nga Zyra Ligjore, Divizioni i Trafikut Rrugor dhe Drejtoria për buxhet dhe Financa.

3. DETYRIMET E PALËVE

3.1. Palët e kësaj marrëveshje bashkëpunimi janë pajtuar që lënda e marrëveshjes të jetë: **Pranim/Përpunimi i e-Tiketave (gjobave) dhe Shpërndarja përmes shërbimit postar të veçantë me Lajmërim Marrje (LM), më përmbajtje gjoba nga trafiku rrugor të shqiptuara nga Policia e Kosovës për shkeljen e rregullave të komunikacionit rrugor në territorin administrativ të Komunës së Lipjanit, duke i dorëzuar ato në adresat e marrësve/në adresën sipas shënimit në zarfin nga Policia e Kosovës.**

3.2. Kryesi i Shërbimit do të bëjë tërheqjen e dërgesave/gjobave tek ndërmjetësuesi i shërbimit në pikat e përcaktuara nga Policia e Kosovës, sipas listës së përpiluar nga ndërmjetësi i shërbimit (Policia) dhe pëlqimit të Porositësit të shërbimit (Komuna Lipjanit) për shpërndarje dhe dorëzim nga ana e kryesit të shërbimit (Posta).

3.3. Kryesi i shërbimit do të bëjë edhe sigurimin e plikove (zarfeve) me logon e ndërmjetësit

(Policisë së Kosovës) në çdo kohë dhe sipas nevojës pa ndonjë kosto.

3.4. Ndërmjetësi i shërbimit dhe kryesi i shërbimeve obligohen të bëjnë pranimin-dorëzimin e dërgesave postare nëpërmjet formularit të ndërmjetësit apo edhe me Librit të pranimit (formular i kryesit te shërbimit).

3.5. Porositësi i shërbimit përmes Postës së Kosovës në mënyre alternative mund të siguroj çdo ngarkesë edhe online përmes web faqes www.postakosoves.com, në rubrikën KLIENTËT (regjistrimi i dërgesave), modul i veçantë për institucione.

3.6. Kryesi i shërbimeve obligohet që dërgesat postare t'i dorëzoje në afat në adresën e marrësit, sipas procedurave të parapara ligjore dhe udhëzimeve mbi pranim-dorëzimin e dërgesave postare me shërbim (LM), ndërsa për dërgesat postare të pa dorëzuara, pas afateve për tërheqje dhe ruajtje i kthehen ndërmjetësuesit të shërbimeve të vulosura dhe me arsye të konstatuara për mos dorëzim.

3.7. Kryesi i shërbimeve obligohet që t'i regjistroj dhënat në librin e pranimit (form. P-2) përmes aplikacionit të saj (SASP) me te dhënat e shënuara ne dërgesa (dërgesa postare) nga ndërmjetësuesi i shërbimeve dhe të shënojë taksen për secilën dërgesë. Një (1) kopje i dërgohet Komunës dhe një (1) kopje Policisë në mbarim të çdo muaji.

3.8. Porositësi i shërbimit, përmes ndërmjetësit Policisë së Kosovës dorëzon të gjitha dërgesat postare me përmbajtje gjoba (e-tiketa) nga trafiku kryesit të shërbimit përmes ekipeve mobile në terren të Postës regjioni Lipjanit.

3.9. Ndërmjetësi i shërbimit obligohet që në dërgesat e veta nuk do te vej materie dhe sende bartja e të cilave është e ndaluar sipas Ligjit mbi shërbimet postare.

3.10.Palët bie dakord për të trajtuar të gjitha të dhënat personale të cilat i janë shpalosur atyre në vijim të zbatimit të lëndës së marrëveshjes, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të përdorë ato vetëm për qëllime të zbatimit të kësaj marrëveshje.

4. KUSHTET E PAGESËS

4.1. **Kryesi i shërbimeve** për shërbimet e bëra nga neni paraprak i kësaj marrëveshje bashkëpunimi përmes faturës ja faturon taksën në fund të muajit për muajin paraprak në pajtim me tarifën postare në fuqi të aprovuar nga ARKEP për llojin e shërbimit të kërkuar nga **porositësi i shërbimi**, në këtë rast shërbimi i veçantë me lajmërim marrje (LM) peshë deri 50 gr. (tarifa aktuale në fuqi 1.70 €), dhe për dërgesa të pa dorëzuar (tarifa për çmimin bazë 0.50€). Ndërsa

ndërmjetësuesi nuk paguan asnjë shërbim apo produkt në bazë të kësaj marrëveshje.

4.2. Kryesi i shërbimeve obligohet të siguroj zarfa me logo të Policisë për ndërmjetësin e shërbimeve, të pranoj dërgesat e përpunuara nga ndërmjetësi i shërbimeve në pikat ku përpunohen e-tiketa e gjobave.

4.3. Në rastet ku gjatë afatit të marrëveshjes së bashkëpunimit tre palësh me ndonjë vendim institucional nga rregullatori apo operatori publik kemi ndryshim të tarifave të shërbimeve postare, porositësi i shërbimit obligohet që të paguaj faturat sipas tarifave të ndryshuara.

4.4. Porositësi i shërbimit obligohet që pagesën për taksën postare dhe shërbimin e kryer të bëjë në llogarinë bankare të Postës së Kosovës SH.A. sipas faturës se dorëzuar, në afat ligjor prej 30 ditëve me shenjën për të hyrat e "Posta e Kosovës SH.A"., nëse pagesa nuk kryhet pas afatit ligjor prej 30 ditëve, Kryesi i shërbimeve mund të ua ndërprerje shërbimet postare dhe inicioj procedurat përmbarimore.

4.5. Kryesi i shërbimeve postare kryen shërbimet postare sipas tarifës/çmimorës në fuqi të miratuar nga **ARKEP-i** (Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare), të cilën mund të gjeni në ueb - faqen: www.postakosoves.com.

5. ZGJIDHJA E MARREVESHJES

5.1.Marrëveshja fillon me rastin e nënshkrimit nga të tre (3) palët dhe është e vlefshme në afat prej tre vite, me mundësi vazhdimi.

5.2.Para skadimit të afatit të marrëveshjes 30 ditë përpara duhet të shqyrtojnë mundësinë e vazhdimit të marrëveshjes së bashkëpunimit, me kërkesën paraprake me shkrim për vazhdim nga ana e palëve të marrëveshjes së bashkëpunimit.

5.3. Palët në marrëveshje bashkëpunimi mund të zgjidhin marrëveshjen edhe para përfundimit të afatit në pikën 2.1. duke e njoftuar njëra tjetrën se nuk dëshirojnë të vazhdojnë bashkëpunim, me kërkesën me shkrim 30 ditë përpara.

5.4. Secila palë mund të ndërpresë njëanshëm bashkëpunimin për kryerjen e shërbimeve, brenda afatit të marrëveshjes së bashkëpunimit tre palësh, kurdo qe e ylerësojnë se ka efekte negative afariste, duke njoftuar njëra tjetrën me shkrim brenda afatit prej 30 ditësh.

6. NDRYSHIM STATUSIT

6.1. Kryesi i Shërbimeve rezervon të drejtën e plotë të transferojë këtë marrëveshje në rastin e ndryshimit të pronësisë pasardhësve të tij ose ndonjë subjekti të tij ndaj çdo Kompanie, pa qenë

nevoja të marrë miratimin e Porositësit dhe Ndërmjetësit të Shërbimeve , përveç kur është rasti i privatizimit të PK Sh.A., dhe ky transferim do të bëhet efektiv në datën kur Kryesi i Shërbimeve i jep njoftim Porositësit dhe Ndërmjetësit të Shërbimeve.

6.2. Ndryshimet ndaj kësaj marrëveshje mund të bëhen vetëm me shkrim, me nënshkrime të përfaqësuesve të autorizuar të secilës palë ose pasardhësve të tyre.

6.3. Çdo çështje e pa trajtuar në këtë Marrëveshje do të zgjidhet me pajtimin dhe shqyrtimin e palëve në marrëveshje në përputhje me Ligjin mbi Shërbimet Postaren në fuqi.

7. PËRGJEGJËSIA

7.1. Operatori publik Postar, të gjitha shërbimet nga veprimtaria e tij, do ti trajtoj në përputhje me Ligjin për shërbime Postare Nr. 06/L-038, dhe Rregulloren për Autorizimin e përgjithshëm për Ofrimin e shërbimeve Postare Nr.41 me Nr. protokolli 041/B/19 dhe Rregulloren për Ofrimin e shërbimit Postar Nr.44 me Nr. protokolli 123/B/2019.

7.2. Shërbimi postar ndërkombëtar realizohet në përputhje të plotë me dispozitat e këtij ligji, aktet e Unionit të Përgjithshëm Postar dhe në bazë të standardeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me shërbimet postare.

7.3. Kryesi i Shërbimeve do të jetë përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar mbi pajisjet për shkak të akteve ose mosveprimeve të tij nga pakujdesia keq shfrytëzimi ose keqpërdorimi prej anëtarëve të personelit të tij i natyrës penale, qoftë ky i prekshëm ose i paprekshëm në secilin prej rasteve të lartpërmendura që ndodh gjatë përmbushjes ose në lidhje me përmbushjen e kësaj marrëveshje . Kryesi i Shërbimeve nuk mban përgjegjësi nëse këto janë të natyrës që përshkruhet në Nenin 8 (Forcë Madhore).

7.4. Çdo dërgesë postare që është objekt reklamacioni do të trajtohet sipas ligjeve dhe akteve nënligjore që janë në fuqi në kohen e paraqitjes së reklamacionit.

8. FORCA MADHORE

8.1. Nëse, në çdo kohë, gjatë afatit të kësaj marrëveshje përmbushja plotësisht ose pjesërisht nga secila palë e çdo detyrimi sipas kësaj marrëveshja pengohet ose vonohet për shkak të luftës, luftës civile, armiqësisë, akteve të armikut publik, rebelimit, revolucionit, fuqisë ushtarake ose të uzurpimit, shqetësimeve civile, demonstratave ose kërcënimeve të menjëhershme lidhur me gjithë si më lart, sabotazhit, zjarrit, përmbytjes, shpërthimeve të epidemive dhe pandemive, kufizimeve për shkak të karantinës, shqetësimeve në furnizime nga burime normalisht të besueshme (ku përfshihen por jo vetëm elektricitet, ujë, naftë dhe të ngjashme), greva, përjashtime, vendime qeveritare ose ndonjë ngjarje tjetër jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës në fjalë (këtu e më poshtë

e përmendur si "ndodhia"), atëherë përmbushja e këtyre detyrimeve do të falet në masën që u pengua ose u vonua dhe pala e prekur ka marrë njoftim për këtë ndodhi nga Pala tjetër brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga Marrëveshje: Posta e Kosovës - Policia e Kosovës - Komuna e Lipjanit data e ndodhisë duke pasur parasysh që ngjarja e çdo ndodhie nuk justifikon asnjë detyrim të secilës Palë për të kryer pagesa. Asnjëra Palë, për shkak të ndodhisë, nuk ka të drejtë të zgjidhë këtë marrëveshje ose të ngrejë pretendime për dëme kundër palës tjetër në lidhje me mos-përmbushjen ose vonesën në përmbushje. Përmbushja e detyrimeve të cenuara duhet të rifillojë apo të jetë praktike pas përfundimit ose pushimit të ndodhisë në fjalë. Nëse përmbushja tërësisht ose pjesërisht e ndonjë detyrimi sipas kësaj marrëveshje bashkëpunimi vonohet për shkak të ndonjë ndodhie të tillë për një periudhë që tejkalon tre (3) muaj, Palët do të takohen dhe rishikojnë në mirëbesim dëshirueshmërinë dhe kushtet për zgjidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit tre palësh.

9. MARRËVESHJA E PLOTË

9.1. Palët pohojnë dhe bien dakord se gjithë marrëveshjet dhe mirëkuptimet mes tyre marrin fund që prej datës efektive të kësaj marrëveshje bashkëpunimi: me kusht, që të gjitha shumat që përbëjnë detyrim ndaj secilës Palë sipas marrëveshjes së mëparshme mbeten ende detyrime dhe të pagueshme.

10. LIGJI DHE JURIDIKSIONI

10.1. Kjo marrëveshje qeveriset nga Ligji Kosovar, dhe është nën juridiksionin e Gjykatës kompetente.

10.2. Në rast të çdo mosmarrëveshjeje që lind për shkak ose në lidhje me përmbushjen ose interpretimin e kësaj marrëveshje, Palët bien dakord të takohen dhe të negociojnë në mirëbesim për të arritur një zgjidhje miqësore, në mungesë të së cilës, vendimin për zgjidhje të mosmarrëveshjes do ta marrë gjykata kompetente e Lipjanit.

10.3. Kjo marrëveshje hartohet dhe nënshkruhet në katër (4) kopje origjinale, një (1) për palët kontraktuese, dy (2) për PK Sh.A.

NËNSHKRUHET PËR DHE NË EMËR TË KRYESIT TË SHËRBIMEVE

znj. Nora Rraci - Krye shef Ekzekutiv, PK SH.A.

Datë: 15/07/2025

NËNSHKRUHET PËR DHE NË EMËR TË POROSITËSIT TË SHËRBIMEVE

z. Imri Ahmeti - Kryetar i Komunës së Lipjanit

Datë: 05/06/2025

NËNSHKRUHET PËR DHE NË EMËR TË NDËRMJETËSUESIT TË SHËRBIMEVE

Nënkolonel Basri Shabani - Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prishtinë

Datë: 05/06/2025

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Komuna e Lipjanit

Pranuar me: Primljeno: 22.07 2025		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-016/01-37627		

قطـر الخيرية
QATAR CHARITY
Kosovo

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

إتفاقية تعاون

Më datë 22/07/2025 u arrit marrëveshja mes:	إنه في يوم 2025/ 07/22 تم الاتفاق بين كل من:
Pala e Parë: Organizata "QATAR CHARITY" me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson z.Esam Dabab në cilësinë e drejtorit, tutje referuar si pala e parë.	الطرف الأول: جمعية "قطر الخيرية"، مقرها في بريشتينا، ويمثلها السيد: عصام دباب بصفته المدير، ويُشار إليه فيما بعد بـ"الطرف الأول".
Pala e dytë: Komuna e Lipjanit , të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës, z.Imri Ahmeti , tutje referuar si pala e dytë.	الطرف الثاني: بلدية ليبان ، ويمثلها رئيس البلدية السيد/.Imri Ahmeti، المشار إليه فيما بعد بالطرف الثاني.
Hyrje: Kjo Marrëveshje ka për qëllim të përcaktojë detyrimet e secilit nga palët në lidhje me projektin e furnizimit me inventar në 14 klasa shkollore ne Komunën e Lipjanit, ne shkollën Zenel Hajdini ne Gadime.	التمهيد: تهدف هذه الاتفاقية إلى تحديد التزامات كل طرف من الأطراف فيما يتعلق بمشروع تزويد 14 صفاً دراسياً بالمعدات والتجهيزات اللازمة، في بلدية ليبجان، في مدرسة زينيل حيديني في منطقة غاديمه.
Neni 1: Objekti i Marrëveshjes: Të dyja palët bien dakord të realizojnë projektin për furnizimi me inventar (Banka, karrika dhe tabela per 14 klasa) te shkolles fillore "Zenel Hajdini" në Gadime me financim nga pala e pare, në komunën e Lipjanit, Adresa: Rr. Shqipëria, nr 28, 14000, Lipjan, në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje,	المادة (1): موضوع الاتفاقية: يتفق الطرفان على تنفيذ مشروع تزويد مدرسة "زينيل حيديني"الابتدائية في غاديمي، بالأثاث (مقاعد، كراسي، وألواح لـ 14 صفا دراسيا)، بتمويل من الطرف الأول، في بلدية ليبيان، العنوان: شارع ألبانيا، رقم 28، 14000، ليبيان، وذلك وفقا للشروط والمعايير المحددة في هذه الاتفاقية.
Neni 2: Kohëzgjatja e Marrëveshjes Memorandumi do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga dy palët dhe do të mbetet në fuqi për 6 (muaj), deri në realizimin e projektit për për furnizimi me inventar (Banka, karrika dhe tabela per 14 klasa) te shkolles fillore "Zenel Hajdini" në Gadime, si dhe realizimin e procedurave zyrtare të pranim-dorëzimit tek pala e dytë.	المادة 2 : مدة الاتفاقية: وستدخل المذكرة حيز التنفيذ فور توقيعها من الطرفين الموقعين، وستظل سارية المفعول لمدة (6)أشهر، حتى تنفيذ مشروع تزويد مدرسة "زينيل حيديني" الابتدائية في غاديمي، بالأثاث (مقاعد، كراسي، وألواح لـ 14 صفا دراسيا)، وكذلك إتمام الإجراءات الرسمية لتسليم واستلام المشروع من قبل الطرف الثاني.
Neni 3: Kushtet e veçanta të investimit 1 Kostoja e përgjithshme e projektit, duke përfshirë kostot direkte dhe indirekte, do të jetë: EUR 27,688.00 (me fjalë: Njezetë e shtatë mijë e gjashtë qind e tetëdhjetë e tetë euro). 2 Pala e parë merr pjesë në zbatimin e projektit në shumën prej EUR 27,688.00 (me fjalë: Njezetë e shtatë mijë e gjashtë qind e tetëdhjetë e tetë euro). 3 Pala e dytë ne kete projekt nuk do te jete pjes e participimit financiar. 4 Të gjitha procedurat e nevojshme të tenderimit për zbatimin e projektit zbatohen në përputhje me rregulloret dhe mekanizmat e palës së parë. 5 Pala e parë është e angazhuar të kryejë të gjitha procedurat e tenderimit në emër të palëve pjesëmarrëse në projekt.	المادة (3): الشروط الخاصة بالاستثمار: 1. القيمة الإجمالية للمشروع بما في ذلك التكاليف المباشرة وغير المباشرة ستكون 27,688.00 يورو: (سبعة وعشرون ألفا وستمائة وثمانية وثمانون يورو). 2. يشارك الطرف الأول في تنفيذ المشروع بقيمة 27,688.00 يورو(بالكلمات: سبعة وعشرون ألفا وستمائة وثمانية وثمانون يورو). 3. الطرف الثاني في هذا المشروع لن يكون جزءا من المشاركة المالية. 4. تُطبق جميع إجراءات المناقصة اللازمة لتنفيذ المشروع، وفقا للوائح والآليات المعتمدة من قبل الطرف الأول. 5. يلتزم الطرف الأول بتنفيذ جميع إجراءات المناقصة نيابة عن الأطراف المشاركة في المشروع.

Komuna e Lipjanit

قطـــر الخيرية
QATAR CHARITY
Kosovo

Neni (4) : Obligimet e palës së parë **1. Detyrimet financiare:** • Pala e parë zotohet të marrë pjesë në realizimin e këtij projekti me shumën prej EUR 27,688.00 (me fjalë: Njezetë e shtatë mijë e gjashtë qind e tetëdhjetë e tetë euro) **2. Detyrimet administrative:** • Pala e parë mbikëqyr zbatimin e projektit drejtpërdrejt ose përmes një organi të miratuar nga ajo. • Pala e parë është e angazhuar të organizojë të gjitha tenderat/praktikat me transparencë dhe besueshmëri. • Pala e parë është e detyruar të paguajë të gjitha detyrimet financiare të kontraktorëve/furnitorëve / ofruesve të shërbimeve të ekzekutuesve të projektit, nga vlera totale e financimit të projektit. • Pala e parë merr pjesë në takime me palën e dytë për të diskutuar çdo çështje që ka të bëjë me projektin nëse kërkohet. • Pala e parë i dorëzon palës së dytë një raport mbi projektin. • Pala e parë është e detyruar të dorëzojë të gjithë infrastrukturën (asetet) e realizuara nga punimet në kuadër të këtij projekti tek Pala e Dytë pas përfundimit të projektit. **3. Detyrimet etike:** • Respektimi i të drejtave të fëmijëve, mbrojtja e grupeve të margjinalizuara dhe mos lejimi i shfrytëzimit të tyre apo shkeljes të të drejtave të tyre; • Respektimi i parimit të transparencës dhe rregullave kundër korrupsionit dhe nepotizmit; • Respektimi i rregullave për mbrojtjen e mjedisit në përputhje me ligjet dhe konventat ndërkombëtare; • Respektimi ne përputhje me ligjet dhe rregulloret per luftimin e pastrimit te parave dhe financimin e terrorizmit	المادة (4): التزامات الطرف الأول: 1. التزامات مالية: • يتعهد الطرف الأول بالمشاركة لتنفيذ هذا المشروع بمبلغ 27,688.00يورو (بالكلمات: سبعة وعشرون ألفا وستمائة وثمانية وثمانون يورو) 2. الالتزامات الإدارية: • يُشرف الطرف الأول على تنفيذ المشروع بشكل مباشر أو من خلال جهة معتمدة من قبله. • يلتزم الطرف الأول بطرح كافة المناقصات/الممارسات بكل شفافية ومصداقية. • يلتزم الطرف الأول بدفع كافة الإلتزامات المالية للمقاولين / موردين / مقدموا خدمات المنفذين للمشروع، وذلك من القيمة التمويلية الكلية للمشروع. • يُشارك الطرف الأول في اجتماعات مع الطرف الثاني لمناقشة أي مسائل تتعلق بالمشروع - إن تطلب ذلك - • يُقدم الطرف الأول للطرف الثاني تقرير عن المشروع. • يلتزم الطرف الأول بتسليم جميع البنية التحتية (الأصول) المحققة من الأعمال في إطار هذا المشروع إلى الطرف الثاني بعد الانتهاء من المشروع. 3. التزامات أخلاقية: • يُلتزم الطرف الأول باحترام حقوق الطفل وحماية الفئات المهشمة وعدم السماح لأي طرف باستغلالها أو انتهاك حقوقها. • يُلتزم الطرف الأول بمبدأ الشفافية وقواعد مكافحة الفساد والمحسوبية. • يُلتزم الطرف الأول بقواعد حماية البيئة وفقا للقوانين والمواثيق الدولية. • يُلتزم بالامتثال للقوانين واللوائح المتعلقة بمكافحة غسل الأموال وتمويل الإرهاب.
Neni (5) Obligimet e palës së dytë **1. Detyrimet financiare:** • Pala e dytë nuk ka detyrime financiare ne kete marreveshje **2. Detyrimet administrative:** • Pala e dytë cakton një vend të përshtatshëm për zbatimin e projektit. • Pala e dytë është e detyruar të realizoj te gjitha dokumentet dhe procedurat administrative te nevojshme per zbatimin e projektit ne përputhje me ligjet dhe rregulloret ne fuqe ne republikën e Kosoves.	المادة (5): التزامات الطرف الثاني: 1. التزامات مالية: • لا يتحمل الطرف الثاني أي التزام مالي ضمن هذه الاتفاقية، 2. التزامات إدارية: • يُحدد الطرف الثاني مكانا مناسبا لتنفيذ المشروع. • يلتزم الطرف الثاني بإعداد جميع الوثائق والإجراءات الإدارية اللازمة لتنفيذ المشروع، وذلك وفقا للقوانين واللوائح المعمول بها في جمهورية كوسوفا.

• Pala e dytë është e detyruar të përgatisë vendin e projektit në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike në rast nevoje. • Pala e dytë nuk mund të përfshijë/kontraktojë një palë të tretë në projekt (gjatë fazave të zbatimit të projektit ose pas përfundimit të tij) – pa pëlqimin me shkrim të palës së parë. • Pala e dytë plotëson nevoja të tjera teknike dhe logjistike për zbatimin e projektit në rast nevoje. **3. Detyrimet etike:** • Respektimi i të drejtave të fëmijëve, mbrojtja e grupeve të margjinalizuara dhe mos lejimi i shfrytëzimit të tyre ose shkeljes së të drejtave të tyre; • Respektimi i parimit të transparencës dhe rregullave kundër korrupsionit dhe nepotizmit; • Respektimi i rregullave për mbrojtjen e mjedisit në përputhje me ligjet dhe konventat ndërkombëtare; • Respektimi ne përputhje me ligjet dhe rregulloret per luftimin e pastrimit te parave dhe financimin e terrorizmit	• يلتزم الطرف الثاني بتجهيز موقع المشروع وفقا للمتطلبات والمواصفات الفنية في حالة الحاجة لذلك. • لا يجوز للطرف الثاني ضم أو إشراك طرف ثالث في المشروع (أثناء مراحل تنفيذ المشروع أو بعد الإنتهاء من تنفيذه) – دون موافقة خطية من الطرف الأول. • يُلبي الطرف الثاني الإحتياجات الفنية واللوجستية الأخرى لتنفيذ المشروع في حالة الحاجة لذلك. 3. التزامات أخلاقية: • يُلتزم الطرف الثاني باحترام حقوق الطفل وحماية الفئات المهشمة وعدم السماح لأي طرف باستغلالها أو انتهاك حقوقها. • يُلتزم الطرف الثاني بمبدأ الشفافية وقواعد مكافحة الفساد والمحسوبية. • يُلتزم الطرف الثاني بقواعد حماية البيئة وفقًا للقوانين والمواثيق الدولية. • يُلتزم بالقانون والأنظمة المتعلقة بغسل الأموال وتمويل الإرهاب.
Neni 6: Të drejtat e pales se parë 1. Pala e parë ka të drejtë të bëjë vizita të rregullta në premisat ku do të ndërtohet objekti pas përfundimit të tij. 2. Pala e parë ka të drejtë në fotografim të procesit të realizimit të projektit si dhe pas finalizimit të projektit – përkatësisht pas ndërtimit final dhe funksionalizimit të tij. 3. Pala e parë ka të drejtë të kërkojë raporte nga paka e dyte lidhur me çdo çështje që ndërlidhet me këtë projekt, me qëllim të sigurimit të arritjes së qëllimit të projektit. 4. Pala e parë ka të drejtë të vendosë reklama statike në punishte, me qëllim të informimit të palëve të treta për financuesin dhe bashkë-financuesit e projektit.	**المادة (6) : حقوق الطرف الأول:** 1. يحق للطرف الأول القيام بزيارات منتظمة إلى المبنى التي سيتم فيها إنشاء المشروع، وذلك بعد الانتهاء من تنفيذه. 2. يحق للطرف الأول تصوير عملية تنفيذ المشروع، وكذلك بعد الانتهاء من المشروع، أي بعد اكتمال البناء ووضعه قيد التشغيل 3. يحق للطرف الأول طلب تقارير من الطرف الثاني عن المشروع بعد إستلامه وذلك بهدف ضمان تحقيق الهدف من تنفيذ المشروع. 4. يحق للطرف الأول وضع إعلانات ثابتة في موقع العمل، بهدف إعلام الأطراف الثالثة بالممول والمولين المشاركين في المشروع.
Neni 7: Të drejtat e pales se dyte 1. Pala e dytë ka të drejtë në fotografim të procesit të realizimit të projektit si dhe pas finalizimit të projektit – përkatësisht pas ndërtimit final dhe funksionalizimit të tij.	**المادة (7) : حقوق الطرف الثاني:** 1. يحق للطرف الثاني تصوير عملية تنفيذ المشروع، وكذلك بعد الانتهاء من المشروع، أي بعد اكتمال البناء ووضعه قيد التشغيل.

2. Pala e dytë ka të drejtë të themelojë një komitet që do të jetë përgjegjës për mbikqyrjen dhe ndjekjen e zbatimit të projektit.	2. يحق للطرف الثاني إنشاء لجنة تكون مسؤولة عن الإشراف ومتابعة تنفيذ المشروع.
Neni (8): Specifikimet teknike dhe standardet: 1. Dizajnet teknike ekzekutive për projektin e furnizimit me inventar (Banka, karrika dhe tabela per 14 klasa) te shkolles fillore "Zenel Hajdini" në Gadime janë pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje. 2. Zbatimi i projektit përfshin fazat e furnizimit dhe montimit sipas projektit teknik ekzekutiv. 3. Zbatohet projekti i furnizimit me inventar te shkolles fillore "Zenel Hajdini" në Gadime dhe përfshin detajet vijuese: o 182 Banka për nxënës, o 350 Karrika për nxënës, o 14 Tabela, o 14 Shporta per mbeturina.	المادة (8): المواصفات الفنية والمعايير: 1. التصميمات الفنية التنفيذية لمشروع أثاث مدرسي لمدرسة "زينيل حيديني" الابتدائية في غاديمه بالأثاث (مقاعد، كراسي وطاولات لأربع عشرة صفًا) جزءًا لا يتجزأ من هذه الاتفاقية. 2. يشمل تنفيذ المشروع مرحلتي البناء والتجهيزات الطبية وفقاً للمشروع الفني التنفيذي. 3. يُنفذ مشروع تزويد مدرسة "زينيل حيديني" الابتدائية في غاديمه بالأثاث ،وفقا للتفاصيل التالية : o 182 مقعدا للطلاب ، o 350 كرسيا للطلاب ، o 14 سبورة، o 14 سلة نفايات.
Neni(9) Të përgjithshme **1. Kuadri i zbatimit:** • Nënshkruesit konfirmojnë se kjo Marrëveshje është shprehje e vullnetit të tyre të plotë, pa asnjë mashtrim, detyrim apo dhunë. • Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese. • Kjo marrëveshje konsiderohet si marrëveshja përfundimtare e miratuar midis dy palëve për zbatimin e këtij projekti, kështu që të gjitha mirëkuptimet dhe/ose transmetimet e mëparshme që bien në kundërshtim me këtë marrëveshje konsiderohen të parëndësishme. • Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me shkrim vetëm pas nënshkrimit të një Shtojce Shtesë midis Palëve. • Palët nënshkruese kanë të gjitha të drejtat dhe detyrimet në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. • Palët nënshkruese marrin përsipër të respektojnë detyrimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje duke i përmbushur ato në kohë, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.	المادة (9): أحكام عامة: 1. إطار التنفيذ : • يؤكد الطرفان الموقعان على أن هذه الاتفاقية هي تعبير عن إرادتهما الكاملة، دون أي احتيال أو إكراه أو عنف. • تدخل هذه الاتفاقية حيز التنفيذ في يوم التوقيع من قبل الأطراف الموقعة. • تعتبر هذه الاتفاقية بمثابة الاتفاقية النهائية المعتمدة بين الطرفين لتنفيذ هذا المشروع ،لذلك يعتبر كل ما يتعارض مع هذه الاتفاقية من تفاهمات و/أو مرسلات سابقة لايعتد به. • لا يمكن تعديل هذه الاتفاقية كتابيًا إلا بعد التوقيع على ملحق إضافي بين الطرفين. • للأطراف الموقعة كافة الحقوق والالتزامات وفقا للقانون رقم 04/L-077 شأن علاقات الالتزام والتشريعات المعمول بها في جمهورية كوسوفا. • يلتزم الطرفان الموقعان باحترام الالتزامات المنصوص عليها في هذه الاتفاقية من خلال الوفاء بها في الوقت المحدد، وفقاً للتشريعات السارية بجمهورية كوسوفا.

2. Konfidencialiteti • Të dyja palët janë të përkushtuara për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit në lidhje me këtë marrëveshje, duke përfshirë informacionin financiar, administrativ dhe teknik. • Asnjëra palë nuk mund t'i zbulojë ndonjë informacion konfidencial një pale të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës tjetër. • I gjithë informacioni konfidencial mbetet pronë e palës që e dorëzon atë dhe nuk mund të përdoret për ndonjë qëllim tjetër përveç zbatimit të kësaj Kontrate.	2. سرية المعلومات: • يُلتزم كل من الطرفين بالحفاظ على سرية المعلومات المتعلقة بهذه الاتفاقية، بما في ذلك المعلومات المالية والإدارية والفنية. • لا يجوز لأي طرف الكشف عن أي معلومات سرية لطرف ثالث دون موافقة خطية مسبقة من الطرف الآخر. • تظل جميع المعلومات السرية ملكية الطرف الذي قدمها، ولا يجوز استخدامها لأي غرض آخر غير تنفيذ هذا العقد.
3. Forca madhore • Secila palë është e përjashtuar nga përgjegjësia në rast se është e pamundur të zbatojë detyrimet e saj për shkak të forcës madhore, duke përfshirë fatkeqësitë natyrore, luftërat dhe ngjarjet e paqëndrueshme politike. • Pala e prekur duhet të njoftojë menjëherë palën tjetër për ndodhjen e një ngjarjeje të forcës madhore. • Palët duhet të bashkëpunojnë për të kufizuar efektet e forcës madhore.	3. القوة القاهرة: • يُعفى أياً من الطرفين من المسؤولية في حال تعذر تنفيذ التزاماته بسبب قوه القاهرة، بما في ذلك الكوارث الطبيعية والحروب والأحداث السياسية غير المستقرة. • يجب على الطرف المتضرر إخطار الطرف الآخر بوقوع حالة القوة القاهرة فوراً. • يجب على الطرفين التعاون معًا للحد من آثار حالة القوة القاهرة.
4. Zgjidhja e paqartësive • Nëse lind ndonjë mosmarrëveshje ndërmjet palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e dispozitave të kësaj kontrate, do të bëhet çdo përpjekje për ta zgjidhur atë në mënyrë miqësore përmes negociatave të drejtpërdrejta. • Nëse negociatat miqësore nuk e zgjidhin mosmarrëveshjen brenda (30) ditëve, ajo do t'i referohet gjykatës kompetente në Prishtinë.	4. حل النزاعات: • في حال نشوء أي خلاف بين الطرفين حول تفسير أو تنفيذ أحكام هذا العقد، يُبذل قصارى الجهد لحله وديًا من خلال المفاوضات المباشرة. • إذا فشلت المفاوضات الودية في حل الخلاف خلال (30) يوم، يُحال إلى المحكمة المختصة في بريشتينا.
5. Gjuha Kjo marrëveshje është lidhur në dy gjuhë - arabisht dhe shqip - dhe gjuha shqipe konsiderohet bazë në marrëveshje dhe është nënshkruar në dy kopje origjinale, secila palë ruan një kopje të saj.	5. اللغة: • يُحرر هذا العقد بنسختين أصليتين، باللغة العربية واللغة الألبانية، وتُعتبر النسخة الألبانية هي النسخة المرجعية في حال وجود أي اختلاف بين النصين.

Komuna e Lipjanit

قطر الخيرية
QATAR CHARITY
Kosovo

Nënshkruar nga dhe për Organizatën Qatar Charity Drejtori i Organizatës **Qatar Charity – zyra në Kosovë** Esam Dabab **Nënshkruar nga dhe për Komunën e Lipjanit** Kryetar i Komunës së Lipjanit z.Imri Ahmeti	وقع من قبل وعن جمعية قطر الخيرية مدير مكتب قطر الخيرية. مكتب كوسوفا عصام ضباب وقع من قبل وعن بلدية لبيان رئيس بلدية لبيان السيد Imri Ahmeti.
Nënshkrimi / التوقيع ..... **Data: 22.07.2025**	..... Nënshkrimi / التوقيع **التاريخ : 22.07.2025**

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPLJAN
REPUBLIKA KOSOVO

قطر الخيرية
Qatar Charity
Kosovo Office

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: Primljeno: 22.07 2025		
Njësia Jedinica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-016/01-37429		

Komuna e Lipjanit

قطـــر الخيرية
QATAR CHARITY
Kosovo

Memorandum Bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi
Shpërndarje e granteve për siguri ushqimore

مذكرة التعاون والتمويل المشترك
لتوزيع منح مشاريع الامن الغذائي

Pala e pare: Organizata "QATAR CHARITY" me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson z.Esam Dabab në cilësin e drejtorit, tutje referuar si pala e parë, dhe:	1. الطرف الأول: جمعية "قطر الخيرية" ومقرها في بريشتينا، ممثلة من قبل المدير: عصام ضباب، المشار إليه فيما يلي: " الطرف الأول"، و:
Pala e dytë: Komuna e Lipjanit, të cilën e përfaqëson Kryetari, z. Imri Ahmeti, tutje referuar si Bashkëfinancuesi - pala e dytë.	1. الطرف الثاني: ممثل بلدية ليبيان السيد: Imri Ahmeti المشار إليه فيما يلي: "الممول المشارك - الطرف الثاني"
Ato të dyja quhen veçmas si "Palë" dhe kolektivisht si "Palë" ose "Palë".	يشار إلى كلاهما منفصلين " طرف " ومجتمعين بـ "الطرفين" أو "الطرفان".
Neni 1: Objekti i Memorandumit 1. Objekti i ketij momerandumi ka për qëllim bashkëpunimin ndërmjet Organizatës Qatar Charity dhe Komunës së Lipjanit për realizimin e projekteve për siguri ushqimore, konkretisht serra bujqesore dhe motokultivatore me freze kose, motokultivatore me freze kose dhe rimorkio që synojne fuqizimin ekonomik të familjeve në nevojë, mbështetjen e sektorit bujqësor, në territorin e Komunës së Lipjanit, përmes ndarjes së granteve. 2. Ky projekt parasheh ndërtimin deri në 90 sera bujqësore dhe 27 motokultivatorë me freze dhe kosë me mundesi shtimit edhe 10 projekte. 3. Te motokultivatorët përparsi do të ketë për përfituesit e serrave te viteve te kaluara që janë përzgjedhur në bazë të marrveshjeve me komunen e Lipjanit.	المادة 1: موضوع المذكرة 1. تهدف هذه المذكرة إلى التعاون بين جمعية قطر الخيرية وبلدية ليبيان، في تنفيذ مشاريع امن غذائي تحديدا صوبة زراعية، ومحراث زراعي مع قاطعة اعشاب، محراث زراعي مع مقطورة وقاطعة اعشاب، ترمي هذه المشاريع إلى تعزيز التمكين الاقتصادي للأسر المحتاجة، ودعم القطاع الزراعي في نطاق بلدية ليبيان، وذلك من خلال توزيع المنح. 2. يتضمن هذا المشروع إنشاء ما يصل إلى 90 صوبة زراعية و27 محراثا مع قاطعة اعشاب، مع إمكانية زيادة العدد الى 10 مشاريع إضافية. 3. فيما يخص المحاريث الزراعية ستكون الأفضلية في الاستفادة لمستفيدي مشاريع الصوبات الزراعية في السنوات السابقة، الذين تم اختيارهم بناء على الاتفاقيات الموقعة مع بلدية ليبيان سابقا.
Neni 2: Obligimet e palës së parë 1. Pala e parë Organizata Qatar Charity merr përsipër të mbulojë 80% të vlerës totale të projektit, përfshirë edhe shpenzimet administrative per realizimin e projektit. 2. Përzgjedhja e kompanive për realizimin e granteve. 3. Kontraktimi me kompanitë realizuese të projekteve. 4. dorëzojë projektet përfituesve të tyre.	**المادة 2: التزامات الطرف الأول** 1. الطرف الأول جمعية قطر الخيرية تتولى 80 ٪ من القيمة الإجمالية للمشروع، بما في ذلك المصاريف الإدارية المتعلقة بتنفيذ المشروع. 2. اختيار الشركات لإنجاز المنح. 3. عقد الاتفاق مع الشركات المنفذة للمشاريع. 4. تسليم المشاريع إلى المستفيدين منها.
Neni 3: Obligimet e palës së dytë 1. Pala e dytë Komuna Lipjanit merr përsipër 20% të vlerës totale të projektit, përfshirë edhe shpenzimet administrative per realizimin e projektit 2. Pala e dytë detyrohet që brenda (2) javëve pas nënshkrimit të raportit specifikues me të cilën do të specifikohen numri i granteve, lloji, vlera e tyre, etj. këto mjete t'i transferojë në xhirollogarinë e organizatës	**المادة 3: التزامات الطرف الثاني** 1. الطرف الثاني وهو بلدية ليبيان، يتعهّد بتحمّل نسبة 20 % من القيمة الإجمالية للمشروع، بما في ذلك المصاريف الإدارية الخاصة بتنفيذه. 2. يلزم الطرف الثاني في غضون أسبوعين، من توقيع التقرير التوضيحي الذي من خلاله سيتم تحديد عدد المنح ونوعها وقيمتها...الخ، على تحويل المبلغ الى حساب مصرف جمعية

"Qatar Charity", në Bankën NLB dhe numrin e llogarisë 1701001600054596.	"القطر الخيرية" في بنك NLB على الرقم: 1701001600054596.
3. Pala e dytë, obligohet që participimin sipas paragrafit 1 të këtij neni, ta dëshmojë me anë të fletëdëshmisë së transferimit të këtyre mjeteve, brenda afatit të lartcekur në paragrafin 2 të këtij neni.	3. يلزم الطرف الثاني أن يثبت مشاركته المقررة حسب الفقرة 1 بالأوراق المثبتة على تحويل هذا المبلغ حسب المهلة المذكورة في الفقرة 2 من هذه المادة.
4. Pala e dytë, duhet të sigurojë mjetin transportues për realizimin e vizitave dhe kontaktimit me aplikuesit gjatë vizitës.	4. يلزم الطرف الثاني أن يوفر وسائل المواصلات للقيام بالزيارات واللقاء مع مقدمي الطلب خلال الزيارة.
5. Pala e dytë, ka për obligim dërgimin e listës së aplikuesve për grante të printuar si dhe në formatin Excel tek pala e parë.	5. يلزم الطرف الثاني إرسال قائمة المتقدمين للحصول على المنح، مطبوعة وكذلك بصيغة Excel، إلى الطرف الأول.
Listës duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente për secilin rast të propozuar, si:	يلحق بالقائمة الأوراق التالية لكل حالة مقترحة، مثل:
6. Kopja e letërnjoftimit;	6. نسخة عن الهوية الشخصية
7. Certifikatën nga Gjykata Themelore përkatëse, qe dëshmon se ndaj aplikuesit nuk është duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale.	7. شهادة من قبل المحكمة الابتدائية التي تشهد بأن القائم بالطلب غير مطلوب في أي قضية جنائية.
8. Certifikatën e Bashkësisë Familjare.	8. شهادة قيد العائلة.
9. Konfirmimin e te ardhurave (pasqyra bankare për periudhën kohore 6 muaj të fundit dhe/ose dokument zyrtar nga ana e institucioneve të vendit i cili vërteton se personi në fjalë është i pa-punë).	9. بيان الدخل الشهري: (حساب البنك لمدة 6 أشهر الأخيرة / أو الأوراق الرسمية من قبل المؤسسات المحلية التي تؤكد بأن الشخص المعين عاطل عن العمل).
10. World Check.	10. البحث الاحترازي.
11. Licencat e kërkuara nga agjencitë qeveritare në Kosovë (nëse ka) Pala e dytë është e detyruar të lëshojë licenca për projektet e zbatuara për përfituesit nëse ligji e kërkon marrjen e tyre.	11. التراخيص الازمة من لجهات الحكومية في كوسوفا (إن وجدت).
Të gjitha këto obligime duhet të përfundojnë më së largu 5 ditë pune që nga data e mbylljes së afatit për aplikim.	يلتزم الطرف الثاني باستخراج التراخيص للمشاريع المنفذة للمستفيدين، في حال ألزم القانون استخراجها. جميع هذه الإلتزامات يجب أن تنتهي في أقصى حد بعد 5 أيام عمل من تاريخ اغلاق توقيت تقديم الطلب.
Neni 4: Obligimet e ndërsjella	**المادة 4: التزامات الطرفين**
1. Procedurat dhe kontaktet zyrtare deri në realizimin e projektit janë plotësuese të këtij memorandumi. Procedurat janë si në vijim:	1. الإجراءات والتواصل الرسمي حتى موعد تنفيذ المشروع، تعتبر من مكملات هذه المذكرة.
• Caktimi i personave kontaktues nga te dy palet, dhe të autorizuar për zhvillimin e procedurave të nevojshme me kompanitë apo palët perfituese.	الإجراءات تكون كالتالي:
• Vizitat e të propozuarve prej të dyja palëve (përfaqësuesi i Organizatës dhe përfaqësuesit e Komunës).	• تعيين الأشخاص الممثلين عن الطرفين للتواصل مع الشركات المنفذة، والأطراف المستفيدة وتعيين المفوضين لتطوير الإجراءات اللازمة.
• Përzgjedhja e përfituesve kryhet nga komisioni i vlerësimit, i përbërë nga zyrtarë të Qatar Charity si dhe pjesë e tij do të jenë edhe përfaqësues të Komunës së Lipjanit, në pajtim me Rregulloren e Qatar Charity me të cilën përcaktohen kushtet për përzgjedhjen e përfituesve, duke i përmbushur kriteret kryesore për secilën familje si:	• زيارة المرشحين من قبل الطرفان (ممثل الجمعية وممثل البلدية).
1)Kushtet e rënda ekonomike;	• اختيار الفائزين بالمنح يتم من قبل لجنة التقييم، التي تتكون من مسؤولين من "قطر الخيرية"، وكذلك ضمن هذه اللجنة سوف يكون ممثل من بلدية لبيان، وفقا لنظام قطر الخيرية التي يتم من خلالها تحديد شروط اختيار الفائزين، مع استيفاء المعايير الرئيسية لكل عائلة مثل:

2) Mundësia e realizimit të grantit; 3) Përfituesi i grantit të mos jetë duke u hetuar/i dënuar për vepër penale.	1) الظروف الاقتصادية الصعبة. 2) إمكانية تنفيذ المشاريع. 3) ألا يكون المستفيد من المنحة قيد التحقيق أو محكوم عليه على فعل جنائي.
Neni 5: Afati i përmbushjes 1. Palët nënshkruese pajtohen që pranimi teknik të realizohet prej të dy palëve nënshkruese dhe finalizimi i projektit do të bëhet më së largu deri nje vite nga data e nënshkrimit te kësaj marreveshje.	المادة 5 : مدة الإنجاز 1. إن طرفا التوقيع اتفقا على أن القبول الفني سوف يتم من قبل الطرفان الموقعان، وانتهاء هذا المذكرة سوف يتحقق في تاريخ أقصاه سنة من تاريخ التوقيع على المذكرة.
Neni 6: Të drejtat e ndërsjella 1. Të dy palët mbajnë të drejtën e inspektimit-vizitës pa paralajmërim të përfituesit, fotografimin apo zhvillimin e intervistës me përfituesin, me qëllim që të binden për arritjen e qëllimit të projektit. 2. Ky memorandum nuk detyron asnjërën palë për një detyrim financiar përveçse të ndonjë raporti specifikues të nënshkruar nga të dyja palët	المادة 6: الحقوق المتبادلة 1. يحق للطرفان التدقيق والزيارة دون إعلان مسبق للمستفيد، وكذلك التصوير أو إجراء مقابلة مع المستفيد بقصد التأكد بأن المشروع قد تحقق حسب المتطلبات. 2. هذه المذكرة لاتلزم أي من الطرفين بالتزام مالي، إلا في حدود التقرير التوضيحي الموقع عليه من قبل الطرفين.
Neni 7: *Parimet e përgjithshme mbi të cilat funksionon Qatar Charity me palë të treta* • Palët nënshkruese pajtohen për respektimin e parimeve, por pa u kufizuar në: • Respektimin e të drejtave të fëmijës, mbrojtja e grupeve të margjinalizuara dhe mos lejimi i ndonjë pale të shfrytëzojë ato apo të shkelë të drejtat e tyre; • Respektimin e parimit të transparencës dhe rregullave të anti-korrupsionit dhe nepotizmit; • Respektimi i rregullave të mbrojtjes së mjedisit në përputhje me ligjet dhe konventat ndërkombëtare; • Respektimi i ligjit dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me ndalimin e pastrimit të parasë, apo ndalimit të financimit të terrorizmit	المادة 7: المبادئ العامة التي تتعامل "قطر الخيرية" مع الأطراف الأخرى إن طرفا التوقيع اتفقا على احترام المبادئ، لكن دون التقيد في: • احترام حقوق الطفل، حماية الفئات المهمشة وعدم السماح لأي طرف على استغلالهم أو انتهاك حقوقهم. • احترام مبدأ الشفافية وأنظمة مكافحة الفساد ومحاباة الأقارب. • احترام الأنظمة المتعلقة بالعناية بالبيئة وفقا للقوانين والأنظمة الدولية. • احترام القانون والأنظمة المتعلقة بحظر غسيل الأموال، أو حظر تمويل الإرهاب.
Neni 8: Zgjidhja e paqartësive Ky Memorandum rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me këtë Memorandum, duke përfshirë këtu edhe mosmarrëveshjet për sa i përket ekzistencës, vlefshmërisë, shkeljes ose përfundimit të saj do të zgjidhet në mënyrë miqësore dhe me mirëbesim me anë të negociatave dhe diskutimeve mes palëve. Mosmarrëveshjet të cilat nuk mund të zgjidhen miqësisht brenda tridhjetë (30) ditësh, do të zgjidhen nga Gjykata kompetente në Kosovë.	المادة 8: حل الاشكاليات تخضع هذه المذكرة وتفسر وفقا للقوانين المعمول بها في جمهورية كوسوفا. أي نزاع يتعلق بهذه المذكرة، بما في ذلك النزاعات المتعلقة بوجودها أو صحتها أو خرقها أو إنهائها، يتم حله وديا وبحسن نية من خلال المفاوضات والمناقشات بين الطرفين خلال 30 يوما، وفي حال عدم توصل الطرفين إلى حل ودي ينعقد الاختصاص إلى المحاكم المختصة في كوسوفا.
Neni 9: Hyrja në fuqi	المادة 9: الدخول حيز التنفيذ

Komuna e Lipjanit

قطـــر الخيرية
QATAR CHARITY
Kosovo

1. Ky memorandum hyn në fuqi momentin e nënshkrimit dhe është e përpiluar në dy (2) kopje identike, prej të cilëve secila palë mban nga një (1) kopje. 2. Anekset e mëvonshme konsiderohen si pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje dhe plotësuese të saj.	1. هذه المذكرة تدخل حيز التنفيذ بمجرد التوقيع، وهي مؤلفة من نسختين أصليتين، لكل طرف نسخة واحدة. 2. تعتبر جميع الملاحق جزء لايتجزء من هذه الاتفاقية.
Nënshkruar nga dhe për Organizatën Qatar Charity Drejtori i Organizatës Qatar Charity – zyra në Kosovë z.Esam Dabab Nënshkruar nga dhe për Komunën e Lipjanit Kryetar i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti	وقع من قبل وعن جمعية قطر الخيرية مدير مكتب قطر الخيرية – مكتب كوسوفا عصام ضباب وقع من قبل وعن بلدية ليبيان رئيس بلدية ليبيان السيد: Imri Ahmeti
Nënshkrimi / التوقيع ..... Data: 22/07/2025	..... Nënshkrimi / التوقيع التاريخ 22 / 07 / 2025

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
REPUBLIKA KOSOVO

قطر الخيرية
Qatar Charity
Kosovo Office

Komuna e Lipjanit

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: Primljeno: 22.07 2025		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-016/01-37435		

قطر الخيرية
QATAR CHARITY
Kosovo

ANEKS MARRËVESHJE PËR BASHKËEPUNIM LIDHUR ME HAPJEN E PUESEVE PËR UJË TË PIJES

" ملحق مذكرة التعاون لحفر الآبار للمياه الصالحة للشرب"

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më dt. 19.06.2012, palët nënshkruese, lidhin këtë:	بناء على أحكام القانون رقم 04/-077 L المتعلق بالعلاقات الإلزامية والمعلن في الجريدة الرسمية في جمهورية كوسوفا بتاريخ 19.06.2012، فإن الأطراف المتعاقدة، عقدا على:
Pala e pare: Organizata "**QATAR CHARITY**" me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson **z.Esam Dabab** në cilësin e drejtorit, tutje referuar si **pala e parë**, dhe:	**الطرف الأول:** جمعية قطر الخيرية، مكتب كوسوفا، العنوان في بريشتينا - ويمثلها السيد / عصام ضباب – بصفته مدير المكتب ، ويشار إليها فيما بعد بـ ("الجمعية") و/او ("الطرف الأول") .
Pala e dytë: Komuna e Lipjanit, të cilën e përfaqëson Kryetari, z. Imri Ahmeti, tutje referuar si Bashkëpunues - pala e dytë.	الطرف الثاني: بلدية لبيان ، ممثلة من قبل الرئيس السيد، **Imri Ahmeti** ويشار إليه فيما بعد باسم المتعاون - الطرف الثاني
Bashkërisht referuar si "**Palët nënshkruese**"	يشار إلى كلاهما مجتمعة باسم "**الأطراف الموقعة**"
DUKE QENË SE, palët nënshkruese, më 06.12.2023, kanë lidhur Memorandumin e bashkëpunimit për hapjen e puseve për ujë të pijes, me nr. Protokolli 01-352/07-66975 ("Memorandumi"); dhe	نظرًا لأن الأطراف الموقعة قد أبرمت في 06.12.2023 مذكرة تفاهم للتعاون بشأن حفر آبار لمياه الشرب، تحت رقم البروتوكول 01-352/07-66975 ("المذكرة"):
DUKE QENË SE, sipas Nenit 1 të Memorandumit, palët ishin dakorduar për hapjen e puseve për ujë të pijes, në vende të ndryshme publike për familjet në kushte të rënda ekonomike në territorin e Komunës së Lipjanit; Pas vizitave në terren dhe vlerësimit të rastëve që kan qenë gjate thirrjës, palët nënshkruese kanë identifikuar familje me kushte të vështira ekonomike që kanë nevojë për ujë. Duke qenë se afati i memorandumit fillestar ka përfunduar, palët bien dakord të nënshkruajnë këtë aneks, me qëllim të vazhdimit të përkrahjes për këto familje në nevojë me ujë.	ونظرًا لأن المادة 1 من المذكرة تنص على اتفاق الأطراف على حفر آبار لمياه الشرب في أماكن عامة مختلفة للعائلات ذات الظروف الاقتصادية الصعبة في أراضي بلدية ليبجان: وبعد الزيارات الميدانية وتقييم الحالات التي تم تقديمها خلال الدعوة، قامت الأطراف الموقعة بتحديد عائلات ذات ظروف اقتصادية صعبة وتحتاج إلى المياه. ونظرًا لانتهاء مدة المذكرة الأصلية، توافق الأطراف على توقيع هذا الملحق بهدف استمرار الدعم لهذه العائلات المحتاجة للمياه.
ANEKS MARRËVESHJE	**ملحق مذكرة**
Neni 1: Objekti i Anesks Marrëveshjes 1. Objekt i këtij Aneksi është zgjatja e afatit kohor të Memorandumit për një periudhë shtesë prej 8 (tetë) muajsh, duke filluar nga data e përfundimit të përcaktuar në Memorandumin baze. 2. Pjesa tjetër e pergjitheshme Memorandumit të datës 06.12.2023 mbetet e pandryshuar.	**المادة 1: موضوع ملحق مذكرة** 1. موضوع هذا الملحق هو تمديد المدة الزمنية للمذكرة لفترة إضافية قدرها ثمانية (8) أشهر، تبدأ من تاريخ الانتهاء المحدد في المذكرة الأساسية 2. تبقى باقي الأحكام العامة للمذكرة المؤرخة في 06.12.2023 دون تغيير

Komuna e Lipjanit

قطر الخيرية
QATAR CHARITY
Kosovo

Neni 2: Hyrja në fuqi 1. Kjo aneks marrëveshje është e përpiluar në gjuhën shqipe dhe arabe në kopje të mjaftueshme prej të cilave secila palë nënshkruese e disponon nga një ekzemplar identik. 2. Kjo aneks-marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët dhe do të mbetet në fuqi deri në përfundimin e projekteve, me një afat maksimal prej 8 muajsh 3. Në rast të mospërputhjes së teksteve, teksti në gjuhën shqipe do të konsiderohet tekst bazë.	المادة 2: الدخول حيز التنفيذ 1. تم تحرير هذا ملحق مذكرة باللغة الألبانية و العربية و بنسخ كافية يكون لكل طرف موقع نسخة متطابقة منها. 2. تدخل هذا ملحق مذكرة حيز التنفيذ في يوم التوقيع من قبل الأطراف الموقعة، وتنتهي مدة تنفيذ المشاريع بعد ثمانية (8) أشهر 3. في حال وجود أي تعارض او خلاف بين محتوى النصين يعتبرالنص بالغة الالبانية هو النص الاساسي الذي يرجع اليه.
Nënshkruar nga dhe për Komunën e Lipjanit Kryetar i Komunës se Lipjanit z.Imri Ahmeti Nënshkrimi:.....	وقع من قبل وعن جمعية قطر الخيرية مدير مكتب قطر الخيرية – مكتب كوسوفا عصام ضباب التوقيع : .....

REPUBLIKA E KOSOVËS · KOMUNA E LIPJANIT · REPUBLIKA KOSOVA · OPŠTINA LIPLJAN

قطر الخيرية
Qatar Charity
Kosovo Office

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/KOSOVSKA KATASTARSKA AGENCIJA
Nr./Br. 01/1580/25
Nr.i fq./Br.str.
Datë/Datum: 18 · 8 · 2025
PRISHTINË/PRIŠTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN
01 Nr.Br. 413/01-48326
Data/Datum 25.08.2025

Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency

ANEKS MEMORANDUMI I BASHKËPUNIMIT (MM)

Ndërmjet

AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS

dhe

KOMUNËS SË LIPJANIT

për

KOMPLETIMIN E SISTEMIT TË ADRESAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS

Ky aneks MM ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Memorandumit të Bashkëpunimit me numër të protokollit të AKK-së 01/1407/22 të datës 30.09.2022 dhe numër të protokollit të Komunës së Lipjanit 1-660/03-52813 të datës 30.09.2022.

Përgjegjësitë e palëve në MM mbeten të njëjta, përpos pikave të reja.

Palët janë pajtuar si më poshtë:

[Agjencia Kadastrale e Kosovës]

Tek përgjegjësitë e Agjencisë Kadastrale të Kosovës shtohet një pikë e re.

7. Agjencia Kadastrale e Kosovës zotohet se do ti mbuloj shpenzimet e pagës prej 25 % për stafin e angazhuar për ndërlidhjen e qytetarit me adresë zyrtare për periudhën 6 mujore (175 Euro bruto) për staf për një muaj, duke filluar nga data 01.09.2025.

[Komuna]

Tek përgjegjësitë e Komunës shtohet një pikë e re.

21. Komuna zotohet se do ti mbuloj shpenzimet e pagës prej 75 % për stafin e angazhuar për ndërlidhjen e qytetarit me adresë zyrtare për periudhën 6 mujore (525 Euro bruto) për staf për një muaj, duke filluar nga data 01.09.2025.

Të gjitha palët do të kenë parasysh kufizimet kohore për kompletimin e Sistemit të Adresave.

Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi me nënshkrimin nga të gjitha palët dhe është plotësisht në fuqi që nga ajo datë. Ai do të mbetet i vlefshëm deri në ekzekutimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky mirëkuptim, përveç rastit kur ai përfundon më herët nga secila palë, duke i njoftuar palët e tjera jo më pak se një muaj me shkrim. Çdo modifikim i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit do t'i nënshtrohet miratimit me shkrim të palëve.

Nënshkruar më datën 25.08.2025 në Lipjan, në tri kopje në gjuhën shqipe dhe angleze.

Për Komunën e Lipjanit

Kryetar i Komunës

z. Imri Ahmeti

Për Agjencinë Kadastrale të Kosovës

Drejtor Ekzekutiv

z. Avni Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: Primljeno: 05.09.2025		
Njësia Jedinica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-016/01-	51369	

Memorandum i Bashkëpunimit

ndërmjet:

Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK)

dhe

Komuna e Lipjanit

Duke pasur parasysh përkushtimin e përbashkët për të adresuar dhunën me bazë gjinore (DhBGj) dhe për të fuqizuar mekanizmat koordinues lokal për të siguruar mbrojtje dhe mbështetje për viktimat e DhBGj-së, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) dhe Komuna e Lipjanit lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi.

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi i ndërsjelltë në mes të RrGK-së dhe Komunës së Lipjanit për të punuar me Mekanizmin Koordinues Komunal Kundër Dhunës në Familje (MKKDhF) me qëllim të fuqizimit të tij për të siguruar mbrojtje për viktimat e dhunës me bazë gjinore.

Neni 2
Synimi

Synimi i kësaj marrëveshje është mbështetja e forcimit të MKKDhF-së në Komunën e Lipjanit . Kjo do të arrihet përmes vlerësimit të nevojave të MKKDhF-së, trajnimeve të nevojshme dhe përpilimi i strategjisë të zhvillimit të kapaciteteve, planeve të punës dhe ndihmën në planifikimet buxhetore.

Neni 3
Fushë veprimtaria

Bashkëpunimi reciprok në mes të RrGK-së dhe Komunës së Lipjanit do të përfshijë mbështetjen e ofruar nga Komuna e Lipjanit për të vlerësuar nevojat e MKKDhF-së, organizimin e trajnimeve dhe organizimi i RrGK-së për vlerësimin e nevojave të MKKDhF-së, organizimi i trajnimeve, mbështetje në përpilimin e strategjisë dhe mbështetje në krijimin e buxhetit vjetor për funksionalizim të MKKDhF-së.

Neni 4
Rrjeti i Grave të Kosovës

RrGK do t'i përmbahet obligimeve dhe përgjegjësive të përcaktuara me këtë Marrëveshje Bashkëpunimi.

RrGK do të bëjë vlerësimin e nevojave për të matur njohuritë e MKKDhF-së për rolet dhe përgjegjsitë e tyre sipas Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore; boshllëqet në kapacitetin e tyre institucional për të kryer këto role dhe përgjegjësi; njohuri për burimet që ata mund të kenë akses për të kryer me sukses rolet dhe përgjegjësitë e tyre si anëtarë të MKKDhF-së dhe preferencat për komunikim dhe koordinim me anëtarët e tjerë të MKKDhF-së.

Pas vlerësimit të nevojave, RrGK do të ofroj trajnime të specializuara për MKKDhF-në në Komunën e Lipjanit.

RrGK do të mbështes MKKDhF-në përmes një procesi ndërveprues në bashkëkrijimin e strategjive të zhvillimit të kapaciteteve, planëve të punës dhe buxheteve për punën e tyre duke përfshirë nxjerrjen nga përvoja e RrGK-së përdorimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në përcaktimin e kostos së nevojave të MKKDhF-së.

RrGK do të asistoj MKKDhF-në duke aplikuar një qasje të bazuar në të drejtat, informuese mbi traumat dhe të mbijetuarit/at në menaxhimin e rasteve të DhBGj-së në përputhje me Konventën e Stambollit; do të lehtësojë në mënyrë efikase takimet e MKKDhF-së, do t'i dokumentojë ato në mënyrë të përshtatshme dhe të ndjekë detyrat dhe përgjegjësitë e caktuara për anëtarët e ndryshëm të MKKDhF-së.

RrGK do të asistoj MKKDhF-në të zhvillojë bashkëpunim me sektorin privat për punësimin e të mbijetuarve të DhBGj-së; do të asistoj MKKDhF-në në përgatitjen e raportimit për institucionet qendrore, duke përfshirë rritjen e kapaciteteve për të futur të dhënat në Bazën Kombëtare të Menaxhimit të Rasteve të DhF.

Neni 5
Komuna e Lipjanit

Komuna e Lipjanit, në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-132 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, si dhe me RREGULLOREN (QRK) – Nr. 01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, ka për detyrë

- Të krijojë dhe funksionalizojë Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, duke siguruar përbërjen e plotë institucionale;
- Të ndajë burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për funksionimin efektiv të MKKDhF-së;
- Të ftojë takime të rregullta të Mekanizmit (së paku një herë në tremujor) dhe të përcaktojë rendin e ditës për to;
- Në raste specifike, të ftojë grupe të ngushta profesionale për trajtimin e rasteve me rrezikshmëri të lartë, në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale dhe anëtarët tjerë të MKKDhF-së;
- Të sigurojë proces të rregullt të komunikimit të brendshëm ndërmjet anëtarëve të Mekanizmit gjatë mbledhjeve;
- Koordinon punën e Mekanizmit Koordinues Lokal për hartimin e Planit të Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave, i cili miratohet nga Kuvendi i Komunës;
- Të raportojë progresin e zbatimit të planeve të veprimit dhe politikave të miratuara në nivel lokal, në përputhje me detyrimet ligjore dhe kërkesat e Koordinatorit Kombëtar.

Neni 6
Dispozitat Përfundimtare

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe do të jetë në fuqi deri sa palët nuk vendosin ndryshe.

Marrëveshja e Bashkëpunimit do të plotësohet apo ndryshohet me marrëveshje me shkrim nga të dy palët.

Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit nënshkruhet në dy ekzemplarë të njejtë, nga një ezemplar për secilën palë.

Palët nënshkruese:

Igballe Rogova
Drejtore Ekzekutive
Rrjeti i Grave të Kosovës

Data: 5 shtator 2025

Imri Ahmeti
Kryetar i Komunës
Komuna e Lipjanit

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me/ Primljeno:	08.09.2025	
Njesia Jedinica	Numri Broj	Shtojcë Dodatak
01-660/03-51648		

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NË MES

KOMUNA E LIPJANIT dhe

DEMOKRACI PLUS

Co-funded by the European Union

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Sweden Sverige

HELVETAS

Democracy Plus

Palët nënshkruese

1. Komuna e Lipjanit, me adresë, Rr "Shqipëria" Nr. 28, e përfaqësuar nga z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës

2. Demokraci Plus, në tekstin e mëposhtëm (D+), me adresë në rrugën "Bajram Kelmendi", Nr.92 Prishtinë 10000, Kosovë, e përfaqësuar nga z. Valmir Ismaili, Drejtor Ekzekutiv

3. Organizata lokale, të dhënat e tyre në tekstin e mëposhtëm (Youth Association for Human Rights – YAHR)

Neni 1

Baza ligjore

Bazuar në nenin 58 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, rregulloret e brendshme të komunës Palët zotohen të implementojnë projektin e "Auditimit Social" në kuadër të Grantit të Performancës Komunale.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij memorandumi është dakordimi për zbatimin e programit të "Auditimit Social" të projekteve të financuara nga Granti i Perfomancës Komunale për Komunën e Lipjanit. Palët janë pajtuar që me synim të rritjes së angazhimit të qytetarëve, rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në nivel lokal në implementimin e projekteve infrastrukturore dhe mbikëqyrjes qytetare, dhe promovimit të hapësirës së dialogut publik, t'i hapin rrugë themelimit të "Ekipit të Auditimit Social" në projektet ***"Muri Gabion në fshatin Gadime e Ulët (te shpella)"; "Ndërtimi i shtëpisë muze të veteraneve të UÇK-së - Krojmir"; "Rikonstruktimi i rrugës Ajet Kozhani Poturofc dhe Ribar i Madh" dhe "Rikonstruktimi i rrugës Dobrotinë-Sllovi".***

Co-funded by the European Union

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Sweden Sverige

HELVETAS

Democracy Plus

Neni 3

Obligimet e D+ dhe YAHR në Lipjan

Bazuar në metodologjinë e dakorduar, OJQ D+ në bashkëpunim me organizatën lokale YAHR (në tekstin e mëposhtëm organizatat implementuese) do të përzgjedhin ekipin multidisiplinar të Auditimit Social në Komunën e Lipjanit:

3.1. Me qëllim të rritjes së kapaciteteve, organizatat implementuese do të ofrojë një program trajnimi për organizatën lokale dhe një tjetër për qytetarët që do të jenë pjesë e ekipit të Auditimit Social;

3.2. Me qëllim të garantimit të një procesi profesional të Auditimit Social, organizatat implementuese do të fasilitojë të gjithë procesin përmes ofrimit të mentorimit profesional dhe asistencës teknike për ekipin e themeluar dhe organizatën lokale që do të jetë e angazhuar;

3.3. Organizatat implementuese do të shërbejnë si lehtësuese të komunikimit në mes komunës dhe ekipit të Auditimit Social me qëllim të koordinimit dhe dokumentimit të aktiviteteve të grupit;

3.4. Organizatat implementuese do të ofrojnë asistencë për ekipin e Auditimit Social me qëllim përgatitjen e raportit final dhe raporteve të tjera gjatë procesit për Komunën e Lipjanit;

3.5. Organizatat implementuese do të sigurohen që materialet e mbledhura nga procesi i Auditimit Social të trajtohen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4

Obligimet e komunës

Komuna e Lipjanit ka për obligim të:

4.1. Sigurojë qasje në dokumentacionet e nevojshme për të kryer procesin e "Auditimit Social";
4.2. Ofrojë mundësi që organizatat implementuese bashkë me pjesëtarët e ekipit të Auditimit Social të takojnë zyrtarët përgjegjës të përfshirë në implementimin e projektit në fjalë;
4.3. Sigurojë qasje të papenguar në hapësirat e realizimit të projektit të Auditimit Social.

Co-funded by the European Union
Schweizerische Eidgenossenschaft Confédération suisse Confederazione Svizzera Confederaziun svizra
Swiss Agency for Development and Cooperation SDC
Sweden Sverige
HELVETAS

Democracy Plus

Neni 5

Mbështetja financiare

Ky memorandum bashkëpunimi nuk ka asnjë kosto financiare për Komunën e Lipjanit. Të gjitha kostot financiare të projektit mbulohen sipas marrëveshjes në mes D+ dhe programit për Decentralizim dhe Mbështetje të Komunave (DEMOS), projekt i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, Zvicra, Suedia, zbatuar nga HELVETAS Swiss Intercooperation Kosovo.

Neni 6

Mbikëqyrja e realizimit të marrëveshjes

Organ përgjegjës për mbikëqyrjen dhe realizimin e kësaj Marrëveshje është Komuna e Lipjanit.

Neni 7

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo marrëveshje është hartuar në tri (3) kopje origjinale, dhe secila palë nënshkruese merr nga një (1) kopje.

2. Periudha e implementimit të Auditimi Social, gjatë të cilit është i nevojshëm bashkëpunimi që është subjekt i kësaj marrëveshje, zgjatë nga muaji gusht 2025 deri në dhjetor 2025.

Valmir Ismaili
Drejtor Ekzekutiv, **D+**
dt. 08.09.2025

Imri Ahmeti
Kryetar, **Komuna e Lipjanit**
dt. 08.09.2025

Bekim Krasniqi
Drejtor, **YAHR**
dt. 08.09.2025

Co-funded by the European Union

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Sweden Sverige

HELVETAS

Kompania Rajonale e Mbeturinave
Regionalno Komunalno Preduzeće za Uklanjanje Otpada
"PASTRIMI" SH.A. / d.d.
Nr. 02/04/1744 Primljeno
Dt. 29.09.2025
Prishtinë-Priština

Pranuar me:
Primljeno: 01. 10 2025

Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
	01-352/01-55934	

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KOMPANIA REGJIONALE PASTRIMI

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur ndërmjet:

1.Komuna e Lipjanit , në tekstin vijues "Komuna" të cilën e përfaqëson, Kryetari i Komunës z. Imri Ahmeti,

2. KRM "Pastrimi"SH.A.-Prishtinë, në tekstin vijues "Kompania" të cilën e përfaqëson z. Petrit Reçica, Kryeshef Ekzekutiv, si vijon:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është dhënia në shfrytëzim KRM "Pastrimit" SH.A.-Prishtinë e një kamioni për grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave, me dy dyer, me mekanizëm i cili mundëson bartjen dhe zbrazjen e kontenjerëve nga Komuna e Lipjanit, kamion i marrur me qira sipas kontratës së prokurimit Nr.613-25-8449-2-3-5/C1129 për periudhë dy mujore

Neni 2
Obligimet e Komunës

Komuna e Lipjanit me këtë Marrëveshje obligohet të i jep në shfrytëzim kamionin e cekur në nenin 1, KRM "Pastrimi"Sh.A.-Prishtinë me të drejtë të shfrytëzimit për nevojat e kompanisë për kryerjen e shërbimeve efikase për qytetarët e Komunës së Lipjanit.

Neni 3
Obligimet e Kompanisë "Pastrimi" Sh. A Prishtinë

1. KRM "Pastrimi" Sh.A.-Prishtinë obligohet të marrë në shfrytëzim kamionin e cekur në nenin 1 të kësaj Marrëveshje, për kryerjen e shërbimeve efikase për qytetarët e Komunës së Lipjanit si dhe ti mbulojë shpenzimet e naftës dhe deponimit të mbeturinave ndërsa në rast të paraqitjes së ndonjë defekti të kamionit gjatë operimit të njoftojë komunën – menaxherin e kontratës.

Neni 4
Ndryshimi dhe Përfundimi

1. Kjo Marrëveshje bashkëpunimi mund te ndryshohet vetem me shkrim.
2. Kjo Marrëveshje bashkëpunimi mund të jetë zgjidhur nga çdo palë me kushtin që të njoftojë palën tjeter me shkrim 8 (tetë) ditë përpara.

Neni 5
Hyrja në fuqi

1. Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.
2. Marrëveshja është hartuar në dy (2) kopje identike origjinale dhe secila nga palët marrin nga një (1) kopje.

Nënshkruar:

Kryetar i Komunës së Lipjanit
Z. Imri Ahmeti

Kryeshef Ekzekutiv KRM "Pastrimi"SH.A.-
Z. Petrit Reçica

2025

277/25
10.11.2025

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

VOICE OF ROMA, ASHKALI AND EGYPTIANS IN KOSOVO

Prot. Datime: Primljeno:	10.11. 2025	
Njesia	Numr Broj	Shtojca Dodatak
01-660/03	-62367	

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

ndërmjet

Organizatës "Voice of Roma, Ashkali and Egyptians -VoRAE"
dhe
Komunës së Lipjan

Ky Memorandum Mirëkuptimi (në vijim "Marrëveshja") synon krijimin e një bashkëpunimi institucional ndërmjet Komunës së Lipjan dhe organizatës "Voice of Roma, Ashkali and Egyptians – VoRAE" për të avancuar mundësitë e përfshirjes së vajzave nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në aktivitete praktike profesionale 2 (dy) mujore, pa asnjë lidhje politike dhe në përputhje të plotë me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Qëllimi

Kjo marrëveshje ka për qëllim zbatimin e programit Peer-to-Peer, i cili synon të angazhojë vajzat e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në institucione publike lokale, me qëllim ngritjen e kapaciteteve të tyre profesionale dhe fuqizimin e tyre përmes përvojës praktike në institucione dhe shkëmbimit të njohurive me profesionistë të fushave përkatëse. Programi nxit vetëbesimin, lidershipin dhe pjesëmarrjen aktive të vajzave në jetën publike. Kjo nismë kontribuon në përgatitjen e tyre për përfshirje të barabartë në vendimmarrje, arsim, punësim dhe angazhim qytetar gjatë një periudhe dy-mujore.

Parimet Themelore

1. **Pavarësi politike**: Marrëveshja nuk përfshin, nuk lidhet dhe nuk promovohet nga asnjë subjekt politik.
2. **Barazi dhe përfshirje**: Palët angazhohen të promovojnë përfshirje të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe të paanshme të vajzave.
3. **Respektimi i ligjit**: Të gjitha aktivitetet do të zhvillohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Ligjin për Zyrtarët Publik dhe parimet kushtetuese të ndarjes së funksioneve publike nga ato partiake.

- Angazhimin praktik të vajzave në departamente dhe njësi komunale përmes programit *Peer-to-Peer*;
- Ofrimin e mentorimit dhe mbështetjes profesionale nga stafi komunal;
- Promovimin e barazisë gjinore dhe përfshirjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në proceset vendimmarrëse;
- Shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike.

Roli i Palëve

Komuna e Lipjan:

a) Identifikon dhe propozon vendet e praktikës në institucionin e komunës përmes drejtorive përkatëse;

b) Siguron mbikëqyrje administrative të praktikës dhe përgatit raporte mujore mbi vijimin dhe mbarëvajtjen e praktikës, në përputhje me formatet e raportimit të përcaktuara nga organizata VoRAE.

Organizata VoRAE:

a) Përzgjedh dhe propozon kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në program;

b) Kryen pagesat mujore për secilin/ën praktikant/e pas pranimit të raporteve mujore dhe fletë-udhëzimeve të kohës në punë (timesheet), jo më vonë se data 25 e çdo muaji;

c) Monitoron në mënyrë të vazhdueshme pjesëmarrjen, performancën dhe përparimin e praktikantëve gjatë periudhës së praktikës;

d) Siguron mbështetje për zhvillimin profesional të praktikantëve dhe mirëmban komunikim të rregullt e efektiv ndërmjet palëve të përfshira.

Zbatimi dhe Monitorimi

1. Palët angazhohen të krijojnë një mekanizëm të përbashkët për koordinimin e aktiviteteve dhe monitorimin e progresit të praktikës.
2. VoRAE do të kryejë vizita monitoruese periodike gjatë periudhës tre mujore dhe do të raportojë për ecurinë e praktikanteve.

Kohëzgjatja

1. Ky Memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit 13/11/25 dhe mbetet i vlefshëm deri në përfundimin e periudhës së programit, 13/01/26 ose me mundësi rishikimi ose rinovimi me marrëveshje të dyanshme.

VOICE OF ROMA, ASHKALI AND EGYPTIANS IN KOSOVO

Dispozita Përfundimtare

1. Ky Memorandum nuk krijon marrëdhënie punësimi midis VoRAE dhe praktikanteve.
2. Palët angazhohen të zbatojnë me transparencë dhe korrektësi të gjitha detyrimet që dalin nga kjo Marrëveshje.
3. Në dëshmi të këtij mirëkuptimi, palët nënshkruajnë këtë Memorandum në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, me nga një kopje për secilën palë.

Isak Skenderi

Drejtor EKZEKUTIV

Imri Ahmeti

Kryetar i Komunës së Lipjan

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Primljeno: 05. 12 2025		
Njësia Jedinica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-660/09-66711		

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KLUBI FUTBOLLISTIK ARBËRIA

Memorandum Bashkëpunimi

Ky Memorandum Bashkëpunimi (më tutje referuar si "**Memorandum**") lidhet në mes të:

1. Komuna e Lipjanit, me seli në Komunën e Lipjanit, përfaqësuar nga z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit.

2. Klubit Futbollistik „ ARBËRIA" nga Dobraja e Madhe, me numër të regjistrit 5110725-0, përfaqësuar nga z. Ibrahim Krasniqi, përfaqësues i autorizuar i Klubit (tutje referuar si KF"Arbëria", ose "KFA"), në njërën anë,

Së bashku referuar si "Palët"

Hyrje:

Komuna e Lipjanit ka shprehur gatishmërinë për të bashkëpunuar me Klubit Futbollistik

„ ARBËRIA" nga Dobraja e Madhe në funksion të përgaditjeve fizike, si dhe për realizimin e aktiviteteve ushtrimeve dhe zhvillimin e ndeshjeve zyrtare të organizuara nga Federata e Futbollit të Kosovës.

Klubit Futbollistik „ ARBËRIA" nga Dobraja e Madhe është një organizatë joqeveritare dhe jo-fitimprurëse Klub Sportiv që nga viti 2006, e cila mbështet të rinjtë, sportistët e Dobrajës së Madhe me rrethinë në përgatitjen për të ardhmen sportive.

Në bazë të diskutimeve të mëparshme, në shprehje të vullnetit të tyre të lirë, e në pajtim me kompetencat e Palëve, Palët si më poshtë dakordohen që të lidhin këtë Memorandum sipas termeve dhe kushteve në vijim:

Neni 1

Palët dhe pëlqimi i vullnetit

1. Ky memorandum i bashkëpunimit lidhet ndërmjet Komunës së Lipjanit të përfaqësuar nga Kryetari z. Imri Ahmeti dhe Klubit Futbollistik „ ARBËRIA" nga Dobraja e Madhe përfaqësuar nga z. Ibrahim Krasniqi përfaqësues i autorizuar i Klubit.
2. Komuna e Lipjanit dhe Klubit Futbollistik „ ARBËRIA" nga Dobraja e Madhe janë pajtuar për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe përdorimin e hapësirës së Stadionit të Futbollit në Dobrajë të Madhe .

Neni 2

Qëllimi i memorandumit të bashkëpunimit

1. Me këtë memorandum i jepet përkohësisht në menaxhim Stadioni i Futbollit në Dobrajë të Madhe Klubit Futbollistik "Arbëria".

2. Ky memorandum nuk afekton të drejtat pronësore të palëve për Stadionin e Futbollit- Dobrajë e Madhe.

3. Klubit Futbollistik „ ARBËRIA" nga Dobraja e Madhe është një Klub Sportiv që vepron në Kosovë që nga viti 2006, qëllimi i të cilit është të mbështesë të rinjtë dhe sportistët e të gjitha grupeve, të cilët kanë vizion për ngritjen e cilësisë së sportit, në veçanti të Futbollit. Klubi Futbollistik „ ARBËRIA" nga Dobraja e Madhe investon drejtpërdrejtë në zhvillimin profesional të të rinjve të Dobrajes (por jo vetem) duke nxitur edukimin e të rinjve, promovimin e edukimit dhe theksimin në rritjen e aktiviteteve që synojnë edukimin sportiv si dhe zhvillimin e gjeneratave të reja në fushen e sportit e në veçanti futbollit.

4. Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është të përcaktojë modalitetet e bashkëpunimit ndërmjet palëve për menaxhimin e Stadionit në Dobrajë të madhe, i cili është ndërtuar nga Komuna e Lipjanit i menaxhuar deri më tani duke siguruar vazhdimësinë e shërbimeve dhe aktiviteteve të tij në dobi të komunitetit rinor dhe sportiv të Komunës së Lipjanit. Në këtë kuadër, palët angazhohen për të arritur objektivat e përbashkëta, duke

fuqizuar të rinjtë dhe sportistët në fushat e edukimit sportiv, të cilat **Klubit Futbollistik „ ARBËRIA" nga Dobraja e Madhe** i implementon në këtë komunë.

Neni 3
Objektivat dhe fushëveprimi i bashkëpunimit

1. Objektivat kryersore të këtij Memorandumi janë:

1.1. Të mundësohet ofrimi i trajnimeve dhe aktiviteteve që përforcojnë aktivitetin dhe përgaditjen fizike tek të rinjtë dhe sportistët.
1.2. Të sigurohet një qasje e barabartë për të gjithë sportistët që marrin pjesë në aktivitetet sportive,
1.3. Të përkrahen iniciativat e sportistëve që rezultojnë nga programet përmes mentorimit.

2. Fushëveprimi i bashkëpunimit përfshinë, por nuk kufizohet në:

2.1.Organizimin e sesioneve edukative brenda dhe jashtë hapësirës së Stadionit.
2.2.Bashkërendimin e burimeve për të përmbushur objektivat e përbashkëta,
2.3.Ndërveprimin me akterë të tjerë të komunitetit për të rritur ndikimin e iniciativave të përbashkëta.

Neni 4
Detyrimet e Komunës së Lipjanit

1. **Komuna e Lipjanit merr përsipër që:**

1.1.Të sigurojë një hapësirë të përshtatshme për funksionimin e Klubit Futbollistik „ ARBËRIA" nga Dobraja e Madhe e cila do të jetë në pronësi të Komunës së Lipjanit dhe në menaxhim të KF„Arbëria", e cila do të jetë në dispozicion për të gjitha aktivitetet rinore, sportive dhe komunitare që do të organizohen nga KF „ Arbëria" në kuadër të përmbushjeve të programeve për sportist.
1.2.Të garantojë qasje dhe bashkëpunim të plotë me institucionet dhe Klubet Sportive në territorin e Komunës së Lipjanit, me qëllim që të mundësohet implementimi i trajnimeve ndeshjeve dhe aktiviteteve për sportistë (futbollistë).

1.3.Të lehtësojë komunikimin dhe bashkëpunimin me institucionet tjera publike apo partnere lokale, që mund të jenë relevante për forcimin e efekteve të KF „ Arbëria " dhe programeve të tij;

1.4.Të jetë palë aktive në takimet e koordinimit dhe mbikëqyrjes, të cilat do të organizohen për vlerësimin e implementimit të këtij Memorandumi.

Neni 5
Detyrimet e Klubit Futbollistik „ ARBËRIA" nga Dobraja e Madhe

1. KF „ Arbëria " merr përsipër që:

   1.1.Të zhvillojë dhe menaxhojë komponentën programore të KF „ Arbëria " përfshirë planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve sportive: punëtori, trajnime, sesione informuese, fushata vetëdijësuese, evente sportive dhe të tjera.

   1.2.Të ofrojë të gjitha pajisjet dhe materialet të nevojshme për realizimin e aktiviteteve sportive.

   1.3.Të dorëzojë raporte të cilat përfshijnë përshkrimin e aktiviteteve të realizuara, pjesëmarrësit, rezultatet dhe impaktin përfundimtar, si dhe të paraqesë raport vjetor dhe **një raport përmbledhës në fund të periudhës së bashkëpunimit.**

   1.4.Të sigurojë që të gjitha aktivitetet të zbatohen në përputhje me parimet e barazisë, gjithëpërfshirjes, mbrojtjes së të dhënave dhe transparencës, duke përfshirë edhe respektimin e legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës për mbrojtjen e të miturve .

   1.5.Të mbulojë të gjitha shpenzimet komunale që lidhen me mirëmbajtjen e hapësirës, përfshirë furnizimin me energji elektrike, ngrohje, ujë, pastrim dhe mbështetje teknike në rast nevoje.

   1.6. Klubi Futbollistik "Arbëria" është përgjegjës për menaxhimin e tërsishëm të Stadionit në Dobrajë të Madhe, përkatësisht merr përgjegjësinë për të gjitha të drejtat dhe detyrimet që dalin nga ky memorandum lidhur me menaxhimin e Stadionit.

Neni 6
Modalitetet financiare dhe logjistike

1. Komuna e Lipjanit do të siguroj hapësirën (stadionin) dhe ato të përcaktuara në nenin 4 të këtij Memorandumi dhe nuk do të ketë asnjë obligim financiar për mirëmbajtje të satadionit në Dobraja e Madhe.

2. Klubit Futbollistik „ ARBËRIA" nga Dobraja e Madhe do të sigurojë fondet për zbatimin e drejtpërdrejtë të aktiviteteve, përmes burimeve të veta ose përmes mbështetjes së donatorëve.

3. Çdo përfshirje e palëve të treta (donatorë apo organizata partnere) në bashkë-menaxhimin apo bashkë-financimin e aktiviteteve duhet të koordinohet dhe të marrë pëlqimin paraprak të palës tjetër.

Neni 7
Kohëzgjatja dhe përfundimi i marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët dhe mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar, me marrëveshje të ndërsjellë.

2. Marrëveshja mund të përfundojë nëse Klubit Futbollistik „ ARBËRIA" nga Dobraja e Madhe nuk i përmbahet këtij memorandumi nga secila palë me një njoftim me shkrim të paktën një (1) muaj më përpara.

3. Në rast të mosrespektimit të kushteve të marrëveshjes nga ndonjëra palë, pala tjetër ka të drejtë të kërkojë rishikimin ose përfundimin e saj.

Neni 8
Ndryshimet dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo ndryshim në këtë marrëveshje do të bëhet vetëm me pajtimn e të dyja palëve dhe do të formalizohet me anë të një ankesi të nënshkruar nga të dy palët nënshkruese.

2. Palët do të bëjnë përpjekje për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje në mënyrë miqësore.

3. Komuna ruan të drejtën e pronësisë dhe njëkohësisht e run të drejtën e kthimit të Stadionit në menaxhim në rastin kur pala marrëse (KF Arbëria) nuk përmbush detyrimet dhe në rastin kur konstatohet nga Komuna (DKRS) keqmenaxhim i Stadionit.

Neni 9
Komunikimi dhe takimet informuese

1. Palët janë pajtuar që të caktojnë nga një person kontaktues e që përgjegjësi e tyre do të jetë realizimi i plotë i këtij Memorandumi, me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave të jetë i shpejtë, konkret dhe efikas.

2. Për KF „ Arbëria", si person kontaktues për komunikim është Ibrahim Krasniqi, përfaqësues i autorizuar i Klubit, ndërsa për Komunën e Lipjanit është Bekim Zaskoku.

3. Kur është e nevojshme, palët bashkëpunojnë në përgatitjen dhe ofrimin e takimeve informuese. Takimet ndërmjet palëve mbahen sipas nevojës dhe organizohen nga njëra palë sipas kërkesës.

Neni 10
Hyrja në fuqi

1. Ky Memorandum hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit nga të dy palët.

2. Ky Memorandum është i shkruar në gjuhën shqipe, në dy (2) kopje identike, nga një për secilën palë.

Lipjan,
Me datë: 04/12/2025

Imri Ahmeti
Kryetar i Komunës

Ibrahim Krasniqi
Përfaqësues i autorizuar

Komuna e Lipjanit

قطر الخيرية
QATAR CHARITY
Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Primljeno:	04.12.2025	
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-320/01-66482		

Memorandum Bashkëpunimi

مذكرة التعاون

Shpërndarje të granteve për zhvillim ekonomik

لتخصيص المنح للتطوير الاقتصادي

Pala e pare: Organizata "QATAR CHARITY" me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson z.Ahmad al Ashal në cilësin e drejtorit, tutje referuar si pala e parë, dhe	1. قطر الخيرية ومقرها في بريشتينا، ممثلة من قبل المدير أحمد الأشعل ، المشار اليه فيما يلي:"الممول - الطرف الأول" و
Pala e dytë: Komuna e Lipjanit, të cilën e përfaqëson Kryetari, z. Imri Ahmeti, tutje referuar si Bashkëfinancuesi - pala e dytë.	1. بلدية لبيان، ممثلة من قبل الرئيس إمري أحمدي ، المشار اليه فيما يلي: "الممول المشارك - الطرف الثاني"
Ato të dyja quhen veçmas si "Palë" dhe kolektivisht si "Palë" ose "Palë".	يشار إلى كلاهما منفصلين " طرف " ومجتمعين بـ "الطرفين" أو "الطرفان".
Neni 1: Objekti i Memorandumit 1. Objekt i këtij memorandumi është ndarja e granteve për zhvillim ekonomik në Komunën e Lipjanit, për grupet e margjinalizuara të komunës së Lipjanit. 2. Grantet që do të ndahen do të dedikohen familjeve me nevojë të cilat disponojnë potencialin për të zhvilluar këtë sektor.	**المادة 1: موضوع المذكرة** 1. إن موضوع هذه المذكرة هو تخصيص المنح للتطوير الاقتصادي للفئات المهمشة في بلدية لبيان. 2. المنح التي سيتم تخصيصها تتعلق بالقطاع المهني، للأسر المحتاجة التي لديها القدرة على تطوير هذا القطاع
Neni 2: Obligimet e palës së parë 1. Pala e parë Organizata Qatar Charity merr përsipër 100% të vlerës për projektet që kanë të bëjnë me pajisjen me vegla pune për zanate profesionale, konkretisht për: elektricistë, hidraulikë, molerë dhe mjeshtrit e qeramikave. Qatar Charity do të zbatojë projektet sipas fondeve që ka në dispozicion, dhe do ta njoftojë paraprakisht palën e dytë për qëllimin dhe synimin e projektit. Në rast se nuk ka fonde të disponueshme, Qatar Charity nuk mban asnjë përgjegjësi për zbatimin e projekteve të tjera.. 2. Përzgjedhja e kompanive për realizimin e granteve. 3. Kontraktimi me kompanitë realizuese të projekteve. 4. Obligohet Pala e parë t'ua dorëzojë projektet përfituesve të tyre.	**المادة 2: التزامات الطرف الأول** 1. الطرف الأول "جمعية قطر الخيرية " تتحمل بنسبة 100% القيمة الإجمالية للمشاريع المتعلقة بتوفير الأدوات والمعدات الخاصة بالمهن الحرفية، وتحديدًا: الكهربائيين، السباكين، الدهانين، والحرفيين المتخصصين في تركيب السيراميك. تقوم *قطر الخيرية* بتنفيذ المشاريع بحسب ما توفر لها من تمويلات حيث ستقوم بإبلاغ الطرف الثاني مسبقًا بنيّة تنفيذ المشروع والغرض منه. وفي حال عدم وجود تمويلات، فإن *قطر الخيرية* لا تتحمل أي مسؤولية عن تنفيذ مشاريع أخرى. 2. اختيار الشركات لإنجاز المنح 3. عقد الاتفاق مع الشركات المنفذة للمشاريع. 4. يلتزم الطرف الأول بتسليم المشاريع الى المستفيدين منها.
Neni 3: Obligimet e palës së dytë 1. Pala e dytë, duhet të sigurojë mjetin transportues për realizimin e vizitave dhe kontaktimit me aplikuesit gjatë vizitës. 2. Pala e dytë, ka për obligim dërgimin e listës së aplikuesve për grante të printuar si dhe në formatin Excel tek pala e parë Listës duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente për secilin rast të propozuar, si: • Kopja e letërnjoftimit; • Certifikatën nga Gjykata Themelore përkatëse, qe dëshmon se ndaj aplikuesit nuk është duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale; • Certifikatën e Bashkësisë Familjare; dhe	**المادة 3: التزامات الطرف الثاني** 1. يلزم الطرف الثاني، أن يوفر وسائل المواصلات للقيام بالزيارات واللقاء مع مقدمي الطلب خلال الزيارة. 2. يلزم الطرف الثاني بإرسال قائمة مقدمي الطلب للمشاريع الممنوحة مطبوعة وكذلك على الـ "أكسل" الى الطرف الأول. يلحق بالقائمة الأوراق التالية لكل حالة مقترحة، مثل: • نسخة عن الهوية الشخصية • شهادة من قبل المحكمة الابتدائية التي تشهد بأن القائم بالطلب غير مطلوب في أي قضية جنائية • شهادة العائلة (القيد الأسري)

V.B

• Konfirmimin e te ardhurave (pasqyra bankare për periudhën kohore 6 muaj të fundit dhe/ose dokument zyrtar nga ana e institucioneve të vendit i cili vërteton se personi në fjalë është i pa-punë). • World Check • Licencat e kërkuara nga agjencitë qeveritare në Kosovë (nëse ka) 3. Pala e dytë është e detyruar të lëshojë licenca për projektet e zbatuara për përfituesit nëse ligji e kërkon marrjen e tyre. Të gjitha këto obligime duhet të përfundojnë më së largu 5 ditë pune që nga data e mbylljes së afatit për aplikim.	• بيان الدخل الشهري (حساب البنك لمدة 6 اشهر الأخيرة / أو الأوراق الرسمية من قبل المؤسسات المحلية التي تؤكد بأن الشخص المعين معطل عن العمل). • البحث الاحترازي • التراخيص اللازمة من الجهات الحكومية في كوسوفا (ان وجدت) 3. يلتزم الطرف الثاني باستخراج التراخيص للمشاريع المنفذة للمستفيدين في حال الزم القانون استخراجها. جميع هذه الالتزامات يجب أن تنتهي في اقصى حد بعد 5 أيام عمل من تاريخ اغلاق توقيت تقديم الطلب.
Neni 4: Obligimet e ndërsjella 1. Procedurat dhe kontaktet zyrtare deri në realizimin e projektit janë plotësuese të këtij memorandumi. Procedurat janë si në vijim: • Caktimi i personave kontaktues nga te dy palet, dhe të autorizuar për zhvillimin e procedurave të nevojshme me kompanitë apo palët perfituese; • Vizitat e të propozuarve prej të dyja palëve (përfaqësuesi i Organizatës dhe përfaqësuesit e Komunës); • Përzgjedhja e përfituesve kryhet nga komisioni i vlerësimit, i përbërë nga zyrtarë të Qatar Charity si dhe pjesë e tij do të jenë edhe përfaqësues të Komunës së Lipjanit, në pajtim me Rregulloren e Qatar Charity me të cilën përcaktohen 1)Kushtet e rënda ekonomike; 2) Mundësia e realizimit të grantit; dhe 3) Përfituesi i grantit të mos jetë duke u hetuar/i dënuar për vepër penale.	**المادة 4: التزامات الطرفين** 1. الإجراءات والتواصل الرسمي حتى موعد تنفيذ المشروع تعتبر من مكملات هذه المذكرة. الإجراءات تكون كالتالي: • تعيين الأشخاص الممثلين عن الطرفين للتواصل مع الشركات المنفذة والأطراف المستفيدة وتعيين المفوضين لتطوير الإجراءات اللازم • زيارة المرشحين من قبل الطرفان (ممثل الجمعية وممثل البلدية) • اختيار الفائزين بالمنح يتم من قبل لجنة التقييم، التي تتكون من مسؤولين من "قطر الخيرية" وكذلك ضمن هذه اللجنة سوف يكون ممثل من بلدية ليبيان ، وفقا لنظام قطر الخيرية التي يتم من خلالها تحديد شروط الظروف الاقتصادية الصعبة، • إمكانية تنفيذ المشاريع. • ألا يكون المستفيد للمنحة قيد التحقيق أو محكوم عليه في فعل جنائي.
Neni 5: Afati i përmbushjes Palët nënshkruese pajtohen që pranimi teknik të realizohet prej të dy palëve nënshkruese dhe finalizimi i projektit do të bëhet më së largu deri nje vite nga data e nënshkrimit te kësaj marrëveshje	**المادة 5 : مدة الإنجاز** إن طرفا التوقيع اتفقا على أن القبول الفني سوف يتم من قبل الطرفان الموقعان، وانتهاء هذه المذكرة سوف يتحقق في تاريخ أقصاه سنة من تاريخ التوقيع على المذكرة.
Neni 6: Të drejtat e ndërsjella Të dy palët mbajnë të drejtën e inspektimit-vizitës pa paralajmërim të përfituesit, fotografimin apo zhvillimin e intervistës me përfituesin, me qëllim që të binden për arritjen e qëllimit të projektit.	**المادة 6: الحقوق المتبادلة** يحق للطرفان التدقيق والزيارة دون اعلان مسبق للمستفيد وكذلك التصوير أو اجراء مقابلة مع المستفيد بقصد التأكد بأن المشروع قد تحقق حسب المتطلبات.

V.13

Neni 7: *Parimet e përgjithshme mbi të cilat funksionon Qatar Charity me palë të treta* Palët nënshkruese pajtohen për respektimin e parimeve, por pa u kufizuar në: • Respektimin e të drejtave të fëmijës, mbrojtja e grupeve të margjinalizuara dhe mos lejimi i ndonjë pale të shfrytëzojë ato apo të shkelë të drejtat e tyre; • Respektimin e parimit të transparencës dhe rregullave të anti-korrupsionit dhe nepotizmit; • Respektimi i rregullave të mbrojtjes së mjedisit në përputhje me ligjet dhe konventat ndërkombëtare; • Respektimi i ligjit dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me ndalimin e pastrimit të parasë, apo ndalimit të financimit të terrorizmit	المادة 7المبادئ العامة التي تتعامل "قطر الخيرية" مع الأطراف الأخرى إن طرفا التوقيع اتفقا على احترام المبادئ، لكن دون التقيد في: • احترام حقوق الطفل، حماية الفئات المهمشة وعدم السماح لأي طرف على استغلالهم أو انتهاك حقوقهم. • احترام مبدأ الشفافية وأنظمة مكافحة الفساد ومحاباة الأقارب. • احترام الأنظمة المتعلقة بالعناية بالبيئة وفقا للقوانين والأنظمة الدولية. • احترام القانون والأنظمة المتعلقة بحظر غسيل الأموال، أو حظر تمويل الإرهاب.
Neni 8: Zgjidhja e paqartësive 1. Ky Memorandum rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me këtë Memorandum, duke përfshirë këtu edhe mosmarrëveshjet për sa i përket ekzistencës, vlefshmërisë, shkeljes ose përfundimit të saj do të zgjidhet në mënyrë miqësore dhe me mirëbesim me anë të negociatave dhe diskutimeve mes palëve. Mosmarrëveshjet të cilat nuk mund të zgjidhen miqësisht brenda tridhjetë (30) ditësh, do të zgjidhen nga Gjykata kompetente në Kosovë.	المادة 8: حل الاشكاليات 1. تخضع هذه المذكرة وتفسر وفقًا للقوانين المعمول بها في جمهورية كوسوفا. أي نزاع يتعلق بهذه المذكرة، بما في ذلك النزاعات المتعلقة بوجودها أو صحتها أو خرقها أو إنهائها، يتم حله وديًا وبحسن نية من خلال المفاوضات والمناقشات بين الطرفين خلال 30 يوما وفي حال عدم توصل الطرفين الى حل ودي ينعقد الاختصاص الى المحاكم المختصة في كوسوفا
Neni 9: Hyrja në fuqi 1. Ky memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe është e përpiluar në dy (2) kopje identike, prej të cilëve secila palë mban nga një (1) kopje. 2. Anekset e mëvonshme konsiderohen si pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje dhe plotësuese të saj.	المادة 9: الدخول حيز التنفيذ 1. هذه المذكرة تدخل حيز التنفيذ بمجرد التوقيع وهي مؤلفة من نسختين أصليتين، لكل طرف نسخة واحدة. 2. تعتبر جميع الملاحق جزء لايتجزء من هذه الاتفاقية.
Nënshkruar nga dhe për Organizatën Qatar Charity Drejtori i Organizatës **Qatar Charity – zyra në Kosovë** z. Ahmad Al-Ashal **Nënshkruar nga dhe për Komunën e Lipjanit** Kryetar i Komunës së Lipjanit z.Imri Ahmeti	**وقع من قبل وعن جمعية قطر الخيرية** **مدير مكتب قطر الخيرية – مكتب كوسوفا** **السيد: أحمد الأشعل** **وقع من قبل وعن بلدية لبيان** **رئيس بلدية ليبيان** **السيد: إمري أحمدي**

V.B

Komuna e Lipjanit

قطـــر الخيرية
QATAR CHARITY
Kosovo

Nënshkrimi / التوقيع	..... Nënshkrimi / التوقيع
Data: 02/12/2025	التاريخ: 02/12/2025

REPUBLIKA E KOSOVËS · KOMUNA E LIPJANIT · REPUBLIKA KOSOVO · OPŠTINA LIPJAN

قطر الخيرية
Qatar Charity
Kosovo Office

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: 21.02 2025
Primljeno:

Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-320/01-8402		

MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM – (MpB) 03/25 Data: 04/02/2025

në mes të

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës, me regjistrim Nr: 5200122-6 – përfaqësuar nga z. Zenel Bunjaku, Drejtor, në tekstin e mëtejmë i referuar si "IADK"

dhe

Komunës së Lipjanit, përfaqësuar nga z. Imri Ahmeti Kryetar i komunës, në tekstin e mëtejmë referuar si "Komuna e Lipjanit"

I. Lënda e MpB

"IADK"-ja dhe "Komuna e Lipjanit" pajtohen të rregullojnë një bashkëpunim të afërt me qëllim të ruajtjes së vazhdimësisë së projekteve bujqësore të realizuara nga "IADK"-ja në Komunën e Lipjanit.
Kjo MpB ka qëllimin të përshkruajë bashkëpunimin në mes të "IADK"-së dhe "Komunës së Lipjanit" gjatë vitit 2025, bazuar në zbatimin e projektit **"Fuqizimi i grave, burrave dhe të rinjve që jetojnë në zonat rurale me sfida ekonomike, të krijojnë mjete jetese të qëndrueshme nëpërmjet aktiviteteve bujqësore dhe të përpunimit të ushqimit"** financuar nga FRIEDA dhe zbatuar nga IADK, ndërsa projekti do të ketë shtrirje në Komunën e Vushtrrisë, Lipjanit, Shtimes dhe Mitrovicës.

Palët e lartë cekura pajtohen që MpB-ja të përmbajë këto obligime dhe përgjegjësi:

II. Obligimet e IADK-së në zbatimin e projektit

- IADK do të organizojë një sesion informues përmes të cilit pjesëmarrësit do të njoftohen lidhur me qëllimin e projektit, aktivitetet e projektit, si dhe mënyrën se si mund të përfshihen në projekt;
- IADK në bashkëpunim me përfaqësuesit nga Komuna e Lipjanit do të bëjë përzgjedhjen e përfituesëve/pjesëmarrësve të granteve dhe njësisë përpunuese;
- IADK do të furnizojë me të mira të nevojshme përfituesit/pjesëmarrësit e projektit;
- IADK do të monitorojë dhe mbikëqyrë aktivitetin e "Përfituesve/Pjesëmarrësve";
- IADK do të organizojë këshilla direkte për përfituesit/pjesëmarrësit e grantit dhe njësisë përpunuese, për të përgatitur dhe menaxhuar sa më mirë punët rreth aktiviteteve të tyre bujqësore;

- IADK do të organizojë vizitë studimore 1-ditore në Kosovë, për të gjithë kandidatët që kanë përfituar grante;
- IADK-ja do të punojnë ngushtë me Drejtorinë për Bujqësi dhe Pylltari të Komunës së Lipjanit në monitorimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të përfituesve/pjesëmarrësve;
- IADK-ja do të organizojë panairin për prezantimin e produkteve të përfituesve/pjesëmarrësve, me qëllim të promovimit të aktivitetit të tyre bujqësor;
- Përkrahja e tetë (8) të rinjëve më të suksesshëm të cilët plotësojnë kriteret e selektimit. Paketa e granteve është e hapur, prandaj të rinjë do të aplikojnë me idetë e tyre në vlerë mesatare deri në 2,000 € në të mira (jo në para);
- Përkrahja e tetë (8) të rinjëve me shërbime këshillimore, trajnime profesionale për përfituesit/pjesëmarrësit e granteve.
- IADK do të organizoj trajnim tre (3) ditor për ndryshimet klimatike për përfituesit/pjesëmarrësit e projektit të granteve;
- IADK do të organizoi njëzet (20) ditë trajnime në përpunimin e pemëve, perimeve ose produkteve të qumështit për 15 gra të cilat do të përzgjedhen në bazë të kritereve të përcaktuara në projekt (të njëjtat do të përcjellin edhe sesione të trajnimeve që do të organizojë IADK përmes projektit FRIEDA). Trajnimet janë të akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve në nivelin III dhe ofrojnë 6 kredi. Certifikatat që lëshohen pas përfundimit të trajnimit janë të vlefshme dhe të njohura ndërkombëtarisht.
- IADK do të organizoj trajnim tre (3) ditor për 20 gratë që do të ndjekin trajnimet profesionale (15) dhe (5 të tjera) në të drejtat pronësore;
- Përkrahja me një (1) njësi për përpunimin e pemëve, perimeve ose qumështit në vlerë mesatare deri në 3,500 € për kandidaten më të suksesshme e cila plotëson kriteret e selektimit;
- Përkrahja e katrëmbëdhjetë (14) kandidateve (nga Komuna e Lipjanit) që kanë ndjekur trajnimet profesionale do të mbështeten me pajisje të vogla në vlerë 150 €;
- IADK do të ri-mbështetë 9 përfitues/pjesëmarrës të projektit të CFD/FRIEDA-së nga vitet e kaluara në Komunën e Lipjanit me një vlerë prej 150€ nëse ende janë të përfshirë në sektorin përkatës të bujqësisë;
- IADK do të organizoj trajnim tre (3) ditor për 15 gratë e komunës së Lipjanit në përdorimin e kompjuterit dhe mediave sociale;
- IADK do të organizoj panair me përfituesit/pjesëmarrësit e projektit në komunën e Lipjanit;
- IADK do të organizoj event B2B për të krijuar mundësi rrjetizimi për përfituesit/pjesëmarrësit e projektit;
- Grupi GIGVA se bashku me IADK do të organizoj takime mujore dhe aktivitete të ndryshme me gratë nga komunat: Lipjan, Shtime, Vushtrri dhe Mitrovicë. Aktivitetet që përfshijnë grupin GIGVA janë: Panaire, 8 Marsi (Dita e Gruas), Dita Rurale e Gruas, 16 ditë aktivizëm kundër dhunës me bazë gjinore, trajnime profesionale, trajnime për përdorimin e kompjuterit dhe mediave sociale, aktivitet për vetëdijsimin e kancerit të gjirit, takime të rregullta mujore, takime me institucione dhe përfaqësues të ndryshëm të organizatave, B2B etj.

III. Obligimet e "Komunës së Lipjanit" në përkrahjen e zbatimit të projektit

- "Komuna e Lipjanit" dhe "IADK"-ja pajtohen që të përkrahin njëra-tjetrën në zbatimin e projektit në interes të "Komunës së Lipjanit" dhe "IADK"-së të cilat do të zbatohen në "Komunën e Lipjanit";
- "Komuna e Lipjanit" do të përkrahë "IADK"-në në bashkëfinancimin e projektit;
- "Komuna e Lipjanit" do të bashkëfinancojë projektin te përfituesit/pjesëmarrësit e granteve (të rinjët, njësin përpunuese, pakot mbështetëse të grave që kanë ndjekur trajnimet profesionale dhe ri-mbështetja e përfituesve/pjesëmarrësve) me 20 % të investimit, (shih tabelen 1);
- "Komuna e Lipjanit" së bashku me "IADK" do të organizojë sesionet informuese, duke informuar shoqatat, fermerët, të rinjët të regjistruara në databazën e komunës;
- "Komuna e Lipjanit" do t'i ndihmojë "IADK"-së në organizimin e grupeve për trajnimet në sektorin e bujqësisë dhe trajnimeve profesionale;
- "Komuna e Lipjanit" do të ndihmojë në procesin e përzgjedhjes së përfituesve/pjesëmarrësve të granteve dhe trajnimeve profesionale;
- "Komuna e Lipjanit" mund të monitorojë dhe mbikëqyrë aktivitetet e "Përfituesve/Pjesëmarrësve" edhe pas përfundimit të projektit;
- "Komuna e Lipjanit" do të asistojë IADK-në në organizimin e panairit duke mundësuar lejimin e hapësirës publike, nëse panairi organizohet në Komunën e Lipjanit.
- "Komuna e Lipjanit" do të përkrahë përfituesit/pjesëmarrësit e projektit në vitet tjera pas përfundimit të projektit me fonde vetanake sa herë që do të ketë mundësi për shkak të gjendjes dhe situatës ekonomike në të cilën gjenden.

Tab. 1: Kostoja e bashkëfinancimit për grante përkrahëse për përfituesit e Komunës së Lipjanit, viti 2025								
Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	Njësia	Nr. i përfituesëve	Investimi €/përfitues	Totali €	Pjesëmarrja e partnerëve		
						IADK dhe Donatorët	Komuna Lipjan	Përfituesit
1	Përkrahje e të rinjëve në sektorin e bujqësisë	Përfitues/ pjesëmarrës	8	2,000.00	16,000.00	11,200.00	3,200.00	1,600.00
2	Ngritja e Njesisë përpunuese e pemëve dhe perimeve	Pjesëmarrëse	1	3,500.00	3,500.00	2,450.00	700.00	350.00
3	Grante të vogla në sektorin e përpunimit (gratë që ndjekin trajnime profesionale)	Pjesëmarrëse	14	150.00	2,100.00	1,680.00	420.00	-
4	Shpenzimet e transportit dhe ushqimit për pjesëmarret ne trajnime profesionale	Pjesëmarrëse	15	200.00	3,000.00	2,400.00	600.00	-
5	Shpenzimet e ekspertit për realizimin e trajnimeve profesionale	Ekspert	1	2,070.00	2,070.00	1,656.00	414.00	-
6	Ri-mbështetja me grante të vogla për përfituesit/pjesëmarrësit egzistues	Përfitues/ pjesëmarrës	9	150.00	1,350.00	1,080.00	270.00	-
	Total direkte				***28,020.00***	***20,466.00***	***5,604.00***	***1,950.00***
7	Shpenzimet e ekspertëve (stafit) operacionale: këshilla direkte , trajnime, komunikime, matriale edukuese, raportimet dhe monitorimet sipas kontrates me përfitues				8,406.00	6,724.80	1,681.20	-
	Buxheti total				***36,426.00***	***27,190.80***	***7,285.20***	***1,950.00***
						IADK	Komuna	Fermeri
						75%	20%	5%
						Investimi total në Komunë		***36,426.00***

Shënim: *Në pikën 1 nga tabela e mësipërme, përparësi do t'u jepet të rinjëve për përkrahje me grante në sektorin e hortikulturës (pemë, perime), blegtorisë dhe bletarisë.*

IV. Mënyra e pagesës së bashkëfinancimit nga Komuna e Lipjanit

- "Komuna e Lipjanit" do t'i bëjë pagesën IADK-së për bashkëfinancim gjatë vitit 2025, pas zbatimit të projekteve dhe dorëzimit të raportit final për mbështetjen e lartë cekur, listën e përfituesve/pjesëmarrësve dhe kërkesës për pagesë, nga ana e IADK-së;
- Pagesa do të bëhet në TEB Bankë në depozitim në **Nr.xhir:2027-000021-7128-84**, në emër të IADK-së;
- Varësisht nga numri i përfituseve/pjesëmarrësve dhe vlera e investimit në Komunën e Lipjanit, do të bëhet edhe bashkëfinancimi (me vlerën 20% nga investimi total nga Komuna e Lipjanit). Bashkëfinancimi për rritjen apo zvogëlimin e numrit të përfituesve/pjesëmarrësve do të bëhen në mënyrë proporcionale;

- Përzgjedhja e përfituesve/pjesëmarrësve do të bëhet nga komisioni i përbashkët i IADK-së dhe Komunës së Lipjanit, poashtu kontratat me përfituesit/pjesëmarrësit e projektit do të nënshkruhen nga tri palët (IADK, Komuna dhe përfituesi/pjesëmarrësi);

V Përgjegjësi të tjera

- "IADK" do të njoftoj në mënyrë të rregullt dhe do të raportoj në fund të projektit tek "Komuna e Lipjanit" për rezultatet e arritura nga aktivitetet e realizuara në kuadër të MpB;
- "IADK" do të njoftoj me kohë "Komunën e Lipjanit" për mundësinë e vazhdimit të MpB pas vitit 2025;

VI Personat Kontaktues

"IADK"-ja dhe "Komuna e Lipjanit" do të emërojnë nga një përfaqësues që të rregullojnë kontaktet më të lehta dhe të drejtpërdrejta në mes dy partnerëve. Këta persona do të përfshiheshin drejt për së drejti në implementimin e qetë dhe kohor të kësaj MpB. "IADK" do të përfaqësohet nga Znj. Djellza Zejnullahu ndërsa "Komuna e Lipjanit" do të përfaqësohet nga Shefqet Amrllahu.

VII Hyrja në fuqi dhe ndërprerja

Kjo MpB vlen nga muaji 04.02.2025 deri më 31.12.2025, dhe hyn në fuqi nga data e nënshkrimit nga të dy palët.
Për modifikimin e kësaj MpB palët duhet të vendosin para skadimit të afatit.
Në rast të mosmarrëveshjes/pakënaqësisë nga ndonjëra palë, MpB mund të ndërpritet para afatit të paraparë duke dhënë një njoftim me shkrim 1- muaj më parë.

VIII Mospajtimet

Të dy palët në çdo kohë do të respektojnë dhe nderojnë kodin e sjelljes të partnerit të tyre, me kujdes të veçantë në pozicionet e paraqitura më lartë.

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK)

.....

Zenel Bunjaku
Drejtor Ekzekutiv

Vushtrri _____2025

Komuna e Lipjanit

.....

Imri Ahmeti
Kryetari i Komunës

Lipjan _____2025

Ref No:	9303/2025/15
FIMS PO No:	860968

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN
01 Nr.Br. 413/01-45761
Data/Datum 15.08.2025

COUNCIL OF EUROPE

CONSEIL DE L'EUROPE

GRANT AGREEMENT
BETWEEN THE COUNCIL OF EUROPE AND MUNICIPALITY OF LIPJAN/LIPLJAN

The Council of Europe, which has its Headquarters at Avenue de l'Europe, F-67075 Strasbourg, France, represented by Mary Ann Hennessey, Head of Office, acting on behalf of the Secretary General (hereinafter referred to as "the Council of Europe");
on the one hand, and
Municipality of Lipjan/Lipljan, Street Shqiperia, No. 28, 12000 represented by Diamant Bytyqi, Deputy Mayor (hereinafter referred to as "the Grantee");
on the other hand,

have agreed as follows:

ARTICLE 1 - SUBJECT

1. The subject of this Agreement is the funding, for a maximum of **3,980 Euro** (Three Thousand Nine Hundred and Eighty Euros), by the Council of Europe as payment for the expenses to be met for implementation of ***Citizen Screen-Transperancy and Participation*** (hereinafter referred to as "the Action") as described in APPENDIX I to the present Agreement.
2. The Grantee or the Grantees will be awarded the funding on the terms and conditions set out in this Agreement and its Appendices, which form an integral part of the present Agreement.
3. This Agreement shall enter into force on the date when the second of the two Parties signs it. The implementation period of the Action shall begin on **25 August 2025** and shall end on **30 November 2025**.
4. The Grantee or the Grantees shall contribute to the Action either by way of its own resources or by contribution from third parties. Co-financing may take the form of financial or human resources, in-kind contributions or income generated by the Action. The form of this contribution is to be detailed in APPENDIX II to the present Agreement.

ARTICLE 2 - DIVISION OF THE GRANTEES ROLES AND RESPONSIBILITIES

1. The Grantees have full responsibility for implementing the action and complying with the Agreement.
2. The Grantees are jointly and severally liable for the implementation of the action. If a Grantee fails to implement its part of the action, the other Grantees become responsible for implementing this part (without being entitled to any additional funding to do so), unless the Council expressly relieves them of this obligation.
3. In the case of a single Grantee applying, all obligations and responsibilities outlined in this Article shall vest in the Grantee. All references to "Lead Grantee" and "Grantees" shall therefore apply equally to the Grantee applying.
4. The internal roles and responsibilities of the Grantees are divided as follows:

   4.1. The Grantees must designate a coordinator hereinafter referred to as "the Lead Grantee".

   4.2. Each Grantee shall:

a) undertake to implement the Action, as described in APPENDICES I and II, in accordance with the terms and conditions of the current Agreement;

b) be responsible for complying with any legal obligations incumbent on it;

c) undertake to comply with the applicable principles, rules and values of the Council, including – but not limited to – those laid down in the Policy on Respect and Dignity in the Council of Europe, Speak-up Policy and the Code of Conduct;

d) inform the Lead Grantee immediately of any change likely to affect or delay the implementation of the Action, change in legal status or technical, organisational or ownership situation, circumstances affecting the award of the grant or compliance with the requirements of the grant;

e) use this funding exclusively for the subject as stated in Article 1;

f) make no profit through the Council of Europe funding;

g) respond adequately and promptly to any reasonable request for information made by the Council of Europe or the Lead Grantee concerning the implementation of the action or the verification of costs;

h) submit to the Lead Grantee in good time:

- any other documents or information required by the Council under the Grant Agreement, unless the Grant Agreement requires the Grantees to submit this information directly;
  - any information requested by the Lead Grantee in order to verify proper implementation of the action and compliance with the other obligations under the grant;
- individual financial statement(s) for itself and, if required, certificates on the financial statement(s);
- all data required to draw up the report(s) (see Article 2.4.3. f) and g)).

i) provide — during implementation of the action or afterwards — any information requested in order to verify eligibility of the costs, proper implementation of the action and compliance with the other obligations under the Agreement.

j) give the other Grantees access to any pre-existing industrial and intellectual property rights needed for the implementation of the action and to comply with the obligations under the Grant Agreement (Article 2.6.).

k) where the documents specified in Article 2.4.3. f) and g) are not received by the Council of Europe by the due date(s), relinquish the right to the payment of the balance referred to in Article 3.1;

l) keep the accounts of the Action, for a minimum period of 10 (ten) years from the date of transmission of the narrative reports and final financial report under Article 2.4.3. f) and g), for any further verification of the proper use of the grant that the European Union, the European Court of Auditors, the Council of Europe, its External Auditors or their appointed representative may effect;

m) when acting under this Agreement, observe any applicable laws and to ensure that the European Union and the Council of Europe are not held liable in respect of third party (including State authorities') claims in this connection.

n) take appropriate measures to prevent irregularities, fraud, corruption or any other illegal activity in the management of the Action. All suspected and actual cases of irregularity, fraud and corruption related to this Agreement as well as measures related thereto taken by the Grantees must be reported to the Council of Europe without delay.

4.3. The Lead Grantee shall:

a) monitor that the action is implemented timely and properly, in accordance with the terms of the Grant Agreement;

b) act as the intermediary for all communications between the Grantees and the Council (in particular, providing the Council with the information described in Article 2.4.2. f), g) and h) immediately), unless the Grant Agreement specifies otherwise;

c) inform the Council of Europe immediately of any change likely to affect or delay the implementation of the Action of which it is aware;

d) request and review any documents or information required by the Council and verify their completeness and correctness before passing them on to the Council;

e) before the start of the implementation of the action, submit this list of pre-existing rights (Article 2.4.2. i)) to the Council;

f) transmit to the Council of Europe narrative progress reports and one final narrative report[1] on the use made of the grant on the following dates:

Report	Reporting period	Submission by
Final Narrative Report	25 August - 30 November 2025	10 December 2025

Narrative progress reports and the final narrative report shall be prepared using the model available in Appendix IV to this Agreement.

g) transmit to the Council of Europe financial progress reports and one final financial repor report[2] on the following dates:

Report	Reporting period	Submission by
Final Financial Report	25 August - 30 November 2025	10 December 2025

Financial progress reports and the final financial report shall be:

- prepared using the model available in Appendix III to this Agreement;
- certified by a responsible financial officer of the Grantees, accompanied by appropriate original supporting documents[3] (and a summary translation of those invoices not drawn up in English or French). If, under domestic law, the original documents must be retained by the Grantees, certified copies must be submitted with the final financial report;
- accompanied by a copy of the credit advice slip or any other document, provided by the Grantees' bank, to certify receipt of the payments made for the Action;
- accompanied by a certified copy, provided by the Grantees' bank, indicating the exchange rate applied on the date(s) of conversion of the sum received into the local currency if the Agreement was concluded in Euros, but the costs are incurred in another currency;
- accompanied by the procurement documents referred to in Article 11, if applicable and upon request by the Council of Europe.

h) Ensure that all payments are made to the other Grantees without unjustified delay. The Lead Grantee may not subcontract the above-mentioned tasks.

5. Payments shall be made by the Council to the Lead Grantee. Payments to the Lead Grantee shall discharge the Council from its payment obligation. When relevant, the Lead grantee shall ensure that each installment

[1] All reports should, unless otherwise agreed between the parties, be submitted in one of the official languages of the Council of Europe (English or French).

[2] All reports should, unless otherwise agreed between the parties, be submitted in one of the official languages of the Council of Europe (English or French).

